

PROJEKTI: “ZHVILLIMI I GAZETARISË HULUMTUESE EKOLOGJIKE”

Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian

Analiza e gjendjes



ANALIZA E GJENDJES

PROJEKTI:
“ZHVILLIMI I GAZETARISË HULUMTUESE EKOLOGJIKE”

SHKUP, 2016



PËRGATITËN

BOTUES:

QENDRA PËR DEMOKRACI EKOLOGJIKE FLOROZON SHKUP

PËRGATITI:

ENVIRO RESURSI SH.P.K. SHKUP

PROJEKTI:

ZHVILLIM I GAZETARISË HULUMTUESE EKOLOGJIKE

DIZAJNI GRAFIK DHE SHTYPSHKRONJA:

GRAFIK MAK PRINT

BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL:

LUBOMIR PETKOVSKI, INXHINIER I DIPLOMUAR PËR MJEDISIN JETËSOR

EKIPI I PROJEKTI:

KIRIL RISTOVSKI, MENAXHER I PROJEKTIT

NESHAT AZEMOVSKI, SPECIALIST I PROJEKTIT

IVANA TRAJÇEV, ASISTENTE E PROJEKTIT DHE PERSON PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

PËRKTHEU:

FATON ISMAILI, PËRKTHYES I PAVARUR


TIRAZHI: 100 KOPJE

SHKUP, MAJ, 2016

Ky botim është prodhuar me përkrahjen e Bashkimit European. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e FLOROZON SUMNAL dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit European ose KCSF-së

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	5
1. HYRJE	6
2. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL DHE MJEDISI JETËSOR	8
2.1 STATUSI I IMPLEMENTIMIT TË RREGULLATIVËS LIGJORE PËR MJEDISIN JETËSOR	8
2.1.1 Pasqyrë e Raporteve të KE-së për progresin e Maqedonisë në aspektin e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike	8
2.2 FUNKSIONI I INSPEKSIONIT SHTETËROR PËR MJEDIS JETËSOR	16
2.2.1 Organizimi dhe funksionimi i IShMJ-së	16
2.2.2 Probleme dhe sfida për punën e IShMJ-së	17
2.2.3 Aktivitetet të realizuara të IShMJ-së	20
3. INTEGRIMI I GRUPEVE TË LËNDUESHME NË SISTEMIN PËR MBROJTJE TË MJEDISIT JETËSOR DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE	22
3.1 ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I NDRYSHIMEVE KLIMATIKE	22
3.2 LËNDUESHMËRIA NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE	24
3.2.1 Lëndueshmëria socio-ekonomike dhe ndryshimet klimatike	24
3.2.2 Efekte mbi shëndetin	29
4. KORNIZA LIGJORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	32
4.1 PRIORITETE PËR MIRATIM TË LEGJISLACIONIT TË BE-SË PËR MJEDISIN JETËSOR	33
5. GJENDJA DHE BAZA PËR FINANCIM TË AKTIVITETEVE NË SFERËN E MBROJTJES SË MJEDISIT JETËSOR	40
5.1 BAZA PËR FINANCIM TË AKTIVITETEVE NË SFERËN E MBROJTJES SË MJEDISIT JETËSOR	40
5.2 KOMPENSIME DHE TË ARDHURA NGA KOMPENSIMET	40
5.2.1 Baza për përcaktim të shumës së kompensimit	41
5.3 PROGRAM PËR INVESTIM NË MJEDISIN JETËSOR	47
5.3.1 Analiza e programit për investim në mjedisin jetësor gjatë 10 viteve të kaluara	50
5.4 DONACIONE NGA DONATORË TË HUAJ PËR PROJEKTE PËR MJEDISIN JETËSOR	67
5.5 SHPENZIME PËR MBROJTJE TË MJEDISIT JETËSOR	68
6. QASJE DERI TE INFORMACIONET PËR MJEDISIN JETËSOR, MEDIET E SHTYPURA DHE ELEKTRONIKE DHE MJEDISI JETËSOR	72
6.1 QASJA DERI TE INFORMACIONET PËR MJEDISIN JETËSOR	72
6.2 MEDIET, LAJMET (ARTIKUJ) DHE MBROJTJA E MJEDISIT JETËSOR	78
6.2.1 Lajme (artikuj) të publikuara në medie që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe analizë e temave dhe sferave të mjedisit jetësor në artikujt e publikuar	79
7. EDUKIMI EKOLOGJIK	86
7.1. INTEGRIMI I MJEDISIT JETËSOR NË SISTEMIN ARSIMOR NË MAQEDONI	86
8. AKTIVITETE TË ORGANIZATAVE JOQEVERITARE DHE CIVILE PËR MJEDISIN JETËSOR	88
8.1. ORGANIZATA JOQEVERITARE DHE CIVILE PËR MJEDISIN JETËSOR	88
9. KONKLUZIONE	90
10. ANEKSI 1	94
11. ANEKSI 2	100
12. ANEKSI 3	110



PARATHËNIE

Qendra për demokraci ekologjike “Florozon” nga Shkipi dhe Shoqata për zhvillim të komunitetit Rom “SUMNAL” e realizuan projektin “Zhvillimi i gazetarisë hulumtuese ekologjike”.

Projekti u mbështet finaciarisht nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë nëpërmjet skemës për grante “Instrumenti për mbështetje të shoqërisë civile, Aksioni 2014 për të ndërtuar kapacitetet e orgnizatave civile dhe liri të medieve -Europe Aid/136-992/DD/ACT/MK”.

Qëllimi kryesor I projektit është të përforcohet bashkëpunimi ndërmjet organizatave civile dhe mediet për zhvillim të gazetarisë hulumtuese ekologjike nëpërmjet inkorporimit të veglave novative për gazetari civile, rrjetëzim, shkëmbim të informacioneve me relevance dhe krijim të kushteve për mbështetje financiare.

Rezultatet që priten nga realizimi i projektit janë:

1. Kapacitete të përforcuara të organizatave civile dhe gazetarëve profesionalë për të aplikuar gazetari hulumtuesae ekologjike dhe për të përcjellë informacionet relevante që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor derit të opinion i gjerë publik;
2. Partneritet të themeluar ndërmjet organizatave civile dhe mediet;
3. Qasje të përmirësuar deri te informacionet relevante nga sfera e mjedisit jetësor duke përfshirë metoda efektive për gazetari hulumtuese civile.

Aktivitetet kryesore të projektit janë drejtuar kah përforcimi i kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm të cilët drejtëpërdrejt gjegjësisht direct janë të prekur nga gazetaria hulumtuese ekologjike posaçërisht mediet dhe organizatat civile, me qëllim që të rritet forca e tyre për përfaqësim nëpërmjet krijimit të rrjeteve dhe themelimit të partneriteteve dhe aktiviteteve të drjetuara kah opinioni i gjerë publik.

Analiza e gjendjes jep pasqyrë të nivelit të zhvillimit të legjislacionit kombëtar për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe nëpërmjet saj e pasqyron pozitën reale të vendit në relacion me eurointegrimet. Përveç kësaj në dokument bëhet një vështrim i investimeve në nivel kombëtar në mjedisin jetësor gjatë viteve të kaluara, ndërsa njëkohësisht e paraqet gjendjen me përfaqësimin e informacioneve për mjedisin jetësor në mediet, ndikimi i menaxhimit të dobët me grupet e marginalizuara dhe aktivitetet gjegjësisht pjesëmarrja e organizatave civile në mbrojtjen e mjedisit jetësor. Ky dokument do të shërbejë për krijuar qasje strategjike ndaj trajtimit të problematikës përkatëse e cila shpresoj si rezultat përfundimtar do të krijojë një realitet dhe cilësi të re të jetesës në shoqinë moderne maqedonase.

*Shkup,
Maj 2016
Kiril Ristovski
Menaxher i Projektit*

1. HYRJE

Për shumë individë mbrojtja e mjedisit jetësor është rruga më e shkurtër e rajonit tonë për në Bashkimin Evropian. Është e qartë se Bashkimi Evropian nuk do të tolerojë mjedis jetësor të papastër në afërsi të saj. Pikërisht për këtë informimi mediatik për mjedisin ka rëndësi të madhe, si edhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe theksimi i rëndësisë për mbrojtjen e mjedisit jetësor, e gjithsesi duke e pasur parasysh se mjedisi jetësor si një degë inter-disiplinore nuk njihet kufij, bashkëpunim ndërshtetëror është me rëndësi të madhe.

Proceset me pjesëmarrje të gjerë dhe konsultim me palët e interesuara si private edhe ato publike, mediet e shtypura, elektronike dhe digjitale dhe publiku i interesuar, paraqesin elementet shumë të rëndësishëm për zhvillim të bazave të mira dhe të shëndosha dhe krijim të politikave për mjedisin jetësor.

Vetëdija për problemet me mjedisin jetësor dhe njohja e problematikës paraqesin faktorë esenciale, me të cilët sigurohet pjesëmarrje e publikut më të gjerë si dhe e subjekteve të veçanta, në proceset e tilla dhe se të gjithë janë të barabartë në relacion me organet publike. Transparenca gjatë vendimmarrjes dhe më vonë gjatë implementimit paraqesin element tjetër të domosdoshëm në realizimin e ciklit të pjesëmarrjes, duke e marrë parasysh se, në atë mënyrë, sigurohet përgjegjësi gjatë vendimmarrjes, implementimit dhe zbatimit të rregullave.

Konventa e Aarhusit, 1998¹ luan rol të rëndësishëm në sigurimin e bazës për mekanizma më të mirë të institucionalizuar për shkëmbim informatash ndërmjet atyre që marrin vendime dhe publikut të përgjithshëm, ndërmjet anëtarëve të publikut të gjerë e publikut të gjerë dhe partnerë e subjekte të tjera të interesuara. Sidoqoftë, implementimi i plotë i Konventës së Aarhusit nënkupton edhe nivel të caktuar të vetëdijes ekologjike dhe rritje të njohurive për mjedisin jetësor në shoqëri në përgjithësi.

Gjithashtu, me rëndësi jetikë është përfshirja e qytetarëve dhe sektorit joqeveritar në identifikimin e problemeve dhe realizimin e aktiviteteve për zgjidhje të problemeve, si dhe në gjatë vendimmarrjes për vendosje të masave të caktuara për mbrojtje të mjedisit jetësor në nivel lokal.

Komunikatat për opinionin publik, informim aktiv për probleme të caktuara ekologjike nga ana e qeverisjes lokale, debatet publike rreth çështjeve të caktuara, pjesëmarrja e sektorit joqeveritar në punën e këshillave dhe trupave tjerë në nivel lokal, si dhe raportimi rreth çështjeve aktuale në sferën e mjedisit jetësor, paraqesin qasje të mirë deri te informacionet për mjedisin jetësor.

Element të rëndësishëm në transferimin e informacioneve për mjedisin jetësor, si dhe mundësi që këto informacione të jenë në dispozicion të publikut, janë edhe mediet e shtypura, elektroni dhe digjitale.

Gazetaria hulumtuese (investigative) ekologjike në Maqedoni ende është në fazën e zhvillimit dhe inkurajimi i shkëmbimit transparent të informacioneve me organet të cilat posedojnë informacione për mjedisin jetësor është i domosdoshëm.

Bashkëpunimi me sektorin joqeveritar, mediet të cilat raportojnë për gjendjen e mjedisit jetësor dhe në përgjithësi publiku i interesuar është imperativ në avancimin e mjedisit jetësor.

¹ Ligji për ratifikim ("Gazeta Zyrtare e RM-së" 44/99)

Në këtë Raport është realizuar analiza e:

- Organizimit institucional – statusi i implementimit të rregullativës ligjore për mjedisin jetësor, aktivitete kryesore të Inspektoratit shtetëror për mjedisin jetësor;
- Integrimi i grupeve të lëndueshme në sistemin për mbrojtje të mjedisit jetësor, si dhe ndikimi i ndryshimeve klimatike mbi grupet e lëndueshme;
- Burimet, bazë për financim të aktiviteteve në sferën e mbrojtjes së mjedisit jetësor;
- Qasja deri te informacionet për mjedisin jetësor, aktivitetet e Qendrës Informative Maqedonase për mjedisin jetësor, raportime në medie të shtypura dhe elektronike, artikuj për mjedisin jetësor;
- Edukimi ekologjik dhe integrimi i tij në sistemin arsimor, si vegël e rëndësishme për zhvillim të vetëdijes për mbrojtje të mjedisit jetësor;
- Aktivitete të organizatave joqeveritare dhe civile për mjedisin jetësor;

Aktivitetet e OJQ-ve (OC) të formuara për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe mbrojtjen e grupeve të lëndueshme realizohen me qëllim që të jepen rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm të gazetarisë hulumtuese ekologjike në Maqedoni.

2. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL DHE MJEDISI JETËSOR

2.1 Statusi i implementimit të rregullativës ligjore për mjedisin jetësor

Siç dihet, në vitin 2005 Komisioni Evropian filloi me publikimin e të ashtuquajturve Raporte për progresin për të prezantuar rrugën e reformave për secilin shtet që ishte kandidat ose kandidat potencial për shtet-anëtar. Në këto raporte reformat qofshin të përfunduara ose të porealizuara kombinohen, në secilin kapitull të së drejtës së BE-së duke bërë përmbledhje të gjitha aktiviteteve në vitin paraprak si dhe duke dhënë rekomandim për hapat e ardhshëm. Progresi i Maqedonisë në sferën e mjedisit jetësor në këto raporte është dhënë në kapitull të veçantë.²

Çështjet e sektorit për mjedisin jetësor nuk janë lartë në agjendën e qeverisë maqedonase për shkak të problemeve të shumta të tjera të cilat marrin edhe kohë edhe financa, si dhe reformat në administratën publike dhe reformat ekonomike e në gjyqësi, reformat në polici, të drejtat e njeriut, të drejtat e komuniteteve joshumicë etj. Të cilat zakonisht kanë prioritet në relacion me mjedisin jetësor.

Duhet theksuar se në disa sfera është arritur progres i caktuar, siç janë marrja (adoptimi) i legjislacionit të BE-së në legjislacionin nacional, posaçërisht në sferat e menaxhimit me mbeturina, kimikate, mbrojtja civile, por duhet të bëhen më tepër përpjekje kryesisht në përforcimin e kapaciteteve administrative për menaxhim me cilësinë e ajrit, ujit dhe ndryshimet klimatike.

Maqedonia duhet ta përcjellë tendencën e Bashkimit Evropian në lidhje me promovimin e një aksioni të fuqishëm klimatik, rritje të qëndrueshme dhe mbrojtje të mjedisit jetësor. Legjislacioni i BE-së përmban dispozita për ballafaqim me ndryshimet klimatike, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin me mbeturinat, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale, kimikatet, zhurmën dhe mbrojtjen civile.

Në këtë Kapitull është dhënë një përmbledhje e shkurtër e progresit në sektorin mjedisi jetësor gjatë 5 viteve të fundit sipas sferave të veçanta, gjegjësisht ajo që është bërë deri tani, në cilat sfera progresi është i ngadalshëm ose është përkeqësuar, cilat sfera kanë potencial për progres dhe çka e pret në të ardhmen zhvillimin e mbrojtjes së mjedisit jetësor në vend.

2.1.1 Pasqyrë e Raporteve të BE-së për progresin e Maqedonisë në aspektin e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike

Në përgjithësi, përgatitjet në sferën e MJ dhe në ndryshimet klimatike shënojnë progres konstant të moderuar.

Gjatë përgatitjes së raporteve të cilat BE-ja i vlerëson si të rëndësishme gjatë vlerësimit të reformave edhe atë ka disa sfera të sektorit mjedisi jetësor që merren parasysh edhe atë:

- Legjislacioni horizontal;
- Cilësia e ajrit;
- Menaxhimi me mbeturina;
- Cilësia e ujit;

² **Kapitulli 27** i së drejtës së BE-së - mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike, kapitull që deri në vitin 2012 quhej vetëm Mjedisi jetësor,

- Mbrojtja e natyrës;
- Kontrolli i ndotjes industriale dhe menaxhimi me rreziqe;
- Kimikatet;
- Zhurma;
- Mbrojtja civile;
- Ndryshimet klimatike;
- Kapaciteti administrativ.

Legjislacioni horizontal

Progresi më i balancuar është vërejtur në miratimin e legjislacionit të nevojshëm. Megjithatë, edhe në procesin e sjelljes së legjislacionit ka mangësi të cilat paraqiten pothuaj çdo vit. Në vitin 2010 u ratifikua Marrëveshja Multilaterale ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore për zbatim të Konventës për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor në kontekstin ndërkufitar³ dhe Protokollin për Regjistër të ndotësve dhe transmetimi (bartja) e materieve ndotëse⁴. U miratua legjislacioni për vlerësim strategjik të ndikimit mbi mjedisin jetësor (VSMJ-së) dhe për vlerësim të ndikimit mbi MJ-në (VSMJ-së) si dhe ligji për ratifikim të protokollit për Vlerësim strategjik të mjedisit jetësor.

Në vitin 2013 u formua trupi koordinues për bashkëpunim dhe dialog me shoqërinë civile. Qasja deri te informacionet dhe konsultime publike që kanë të bëjnë me realizimin e direktivave për VNMJ-në dhe SVMJ-në duhet të përmirësohen. Konsultimi dhe koordinimi publik me shoqërinë civile duhet të përmirësohen.

Në vitin 2014, u finalizua Monitorimi i IX i progresit (MP) në sferën e mjedisit jetësor dhe ndryshimet klimatike me të cilin vlerësohet shkalla e përafrimit të legjislacionit nacional të Republikës së Maqedonisë drejt legjislacionit të Bashkimit Evropian, si dhe shkalla e implementimit të këtij legjislacioni. Monitorimi i progresit u zhvillua në kuadër Rrjetit Rajonal për aderim në sferën e mjedisit jetësor dhe klimës (EKARAN) në bashkëpunim me Komisionin Evropian–Drejtoria e përgjithshme për mjedisin jetësor. U miratua “Ligji për ndryshim dhe plotësim të Kodit Penal” me të cilin u transponua Direktiva 2008/99/KE i BE-së për kriminalitet në mjedisin jetësor (“Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 27/2014). U miratua “Ligji për infrastrukturë nacionale të të dhënave hapësinore”, me të cilin u transponua Direktiva INSPIRE 2007/2/KE (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 387/2014). U bënë ndryshime dhe plotësime të Ligjit për mjedisin jetësor (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 42/2014) të cilat kanë të bëjnë me licencën dhe trajtimin e mjeteve për ftohje dhe/ose produkte që përmbajnë mjete për ftohje, me çka u siguroa implementim më i mirë i Protokollit të Montrealit. Në maj të vitit 2014 Inspektorati shtetëror për mjedisin jetësor, si organ në përbërje të Ministrisë për mjedisin jetësor dhe planifikim hapësinor, fitoi statusin e personit fizik. Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi Programin për investim në mjedisin jetësor për vitin 2014 (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 7/2014). Në kuadër të projektit “Menaxhimi i aderimit në BE”, i mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike në Shkup, u bë vlerësim i hollësishëm i progresit në 9 nënsektorët të kapitullit 27 – Mjedisi jetësor, si dhe u bë analizë e mangësive në implementimin e legjislacionit në këtë kapitull. Në dhjetor filloi projekti “Drejtësi po, menjëherë” ndërmjet MMJPH-së dhe OJQ-së Florozon, i mbështetur financiarisht nga Ambasada Norvegjeze në Beograd. Projekti ka për qëllim përforcimin e kapaciteteve administrative dhe vendosje e mirëmbajtje të Regjistrit të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve. Gjatë vitit 2014

³ Ligji për ratifikim (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.157/10)

⁴ Ligji për ratifikim (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 135/10)

intensivisht janë realizuar procedura kundërvajtëse si dhe procedura për ndërmjetësim

Gjatë vitit 2014, u realizuan një sërë aktivitete për ngritjen e vetëdijes me anë të shënimit të ditëve nga kalendari ekologjik, promovimeve, punëtorive, takimeve konsultative dhe transmetimit të emisioneve me tema ekologjike.

Cilësia e ajrit

Është vërejtur progres i caktuar në sferën e cilësisë së ajrit, ndërsa harmonizimi me acqui communautaire dhe sjellja e legjislacionit për implementim ende vazhdon.

Është arritur progres i caktuar në zhvillimin e përcjelljes së cilësisë së ajrit, si dhe në raportimin dhe shkëmbimin e informacioneve për cilësinë e ajrit. Pjesa më e madhe e sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit është vënë funksion.

Është arritur progres vetëm i kufizuar në realizimin e planit nacional për mbrojtje të cilësisë së ajrit. Janë regjistruar nivele të ndotjes së ajrit (PM10) dukshëm mbi nivelet e BE-së. Mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare është pengesë për funksionimin dhe mirëmbajtjen e Rrjetit Shtetëror për monitorim të cilësisë së ajrit. Vendi u bë anëtar i plotfuqishëm i Protokollit të Geteborgut⁵.

Në shkurt të vitit 2014 u miratua Ligji për kontroll të emisioneve të përzjerjeve organike të paqëndrueshme (që avullohen) gjatë përdorimit të benzenëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/2014) në të cilin në u transponuan dispozitat e masave 31994L0063 i 32009L0126 të BE-së. Gjithashtu u sollën akte nënligjore që dalin nga Ligji i lartpërmendur. U sollën aktet nënligjore në përputhje me Ligjin për cilësi të ajrit ambiental. U miratua Programi i punës së Sistemit Shtetëror për përcjellje të cilësisë së ajrit ambiental për vitin 2015, i cili drejtohet nga MMJPH-ja. U përgatit inventari KORINER me të dhëna për vitin 2012 dhe i njëjti u dërgua deri te Konventa për transmetim ndërkufitar të aerondotjes dhe deri te Agjencia Evropiane për mjedis jetësor.

Menaxhimi me mbeturinat

Në sferën e menaxhimit i sollën: Ligji për menaxhim me bateri dhe akumulatorë dhe bateri e akumulatorë të hedhur në mbeturina, Ligji për menaxhim me pajisjen elektrike dhe elektronike dhe pajisja elektrike e elektronike e hedhur si mbeturina, si dhe ligje të caktuara për implementim në sferën e planifikimit dhe menaxhimit me paketimin e mbeturinave. Investimi në këtë sferë është larg nivelit të jetë i mjaftueshëm dhe duhet të zmadhohet. Në këtë sferë është përmirësuar edhe kapaciteti administrativ, por investimet janë larg nivelit të jenë të mjaftueshëm dhe duhet të zmadhohet, me theks të posaçëm në selektimin dhe riciklimin e mbeturinave. Është vendosur pilot-sistem për grumbullim të të dhënave, regjistrim dhe raportim.

Ka filluar implementimi i sistemit të integruar për menaxhim me mbeturina. Në shtator të vitit 2014 u miratuan planet rajonale për menaxhim në rajonin Lindor dhe Verilindor, të shoqëruar me procedura për vlerësim strategjik mbi mjedisin jetësor të këtyre dokumenteve me plane, i financuar me anë të masës 3.2 dhe 3 të IPA projektit "Përgatitje e planeve rajonale për menaxhim me mbeturina dhe vlerësim strategjik i mjedisit jetësor për rajonin Lindor dhe Verilindor". U mbindërtua dhe u plotësua baza e të dhënave në Kadastrën e krijuesve të mbeturinave. U vu në funksion softuer për

⁵ Protokoll drejt Konventës për ndotje të ajrit me ndikim të gjerë në brezin ndërkufitar nga viti 1970 për zvogëlim të acidifikimit, eutrfikimit dhe ozonin përdhës (Geteborg, nëntor 1999) {Ligji për ratifikim ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 135/10)}

lëshim të lejeve për menaxhim me mbeturina. U përgatit Studim fizibiliteti për trajtim të mbeturinave të rrezikshme në kuadër të projektit “Përforcimi i kapaciteteve të Ministrisë për mjedisin jetësor dhe planifikim hapësinor për kontroll të integruar të ndotjes dhe menaxhimi me mbeturina të rrezikshme”, i financuar nga Qeveria Norvegjeze.

Implementimi i legjislacionit për rrjedhje të mbeturinave të veçanta ende po ngec.

Cilësia e ujit

Në vitin 2011 u miratua dhe legjislacioni i caktuar për harmonizim me direktivën për ujërat e zeza dhe direktiva kornizë për ujëra, procesi i transponimit në këtë sferë nuk është shumë i avancuar dhe është i ngadalshëm, që rezulton nga mungesa e koordinimit ndërmjet organeve kompetente në sektorin për ujërat që e pengon implementimin e legjislacionit. Në vitin 2013 u miratua Strategjia nacionale për ujërat, bashkë me ndryshimet e legjislacionit për implementim.

U ndërmorën hapa për përgatitjen e propozim-planeve për menaxhim me pellgjet e lumenjve dhe mbrojtja e ripërtëritja e resurseve ujore. Programi për menaxhim me ujërat për vitin 2013 parasheh të bëhen alokime financiare të kufizuara për investime infrastrukturore.

U miratua Programi për ujëra për vitin 2014 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 8/14). Në dhjetor të vitit 2014 përfundoi projekti “Zhvillimi i sistemit tarifor nacional për furnizim me ujë, kullim dhe trajtim të ujërave” i financuar prej IPA. Në kuadër të këtij projekti u miratua metodologjia për përcaktim të çmimit të ujit me Plan aksionar për implementimin e të njëjtit.

Nuk i kushtohet vëmendje mangësive të rëndësishme në sistemin për përcjellje të ujërave. Ngec planifikimi i përgatitjes së investimeve për infrastrukturën, ndërsa financimi është shumë i ulët dhe s’ka progres në implementimin e parimit “ndotësi paguan”, nuk është themeluar sistem përkatës për përcaktim të çmimit të ujit që e vështirëson funksionimin e stacioneve (impianteve) për trajtim të ujërave. Janë themeluar struktura për menaxhim me pellgjet e lumenjve, por të njëjtat nuk janë ende plotësisht funksionale. Përgatitjet e investimeve infrastrukturore ngecin ndërsa financimi është i ulët në relacion me nevojat e sektorit.

Mbrojtja e natyrës

Në sferën e mbrojtjes së natyrës, ndryshimet në legjislacionin për implementim solli deri zmadhimi i harmonizimit të kufizuar me *acquis*, ka vonesë në transponimin e të drejtës së BE-së për vendbanimet (habitatet) e florës dhe faunës së egër.

Është arritur progres i mirë me futjen në përdorim të sistemit nacional për informim të biodiversitetit. Në vitin 2014 vazhduan aktivitetet për shpallje të zonave të mbrojtura. MMJPH-ja në bashkëpunim me ekipin e ekspertëve e përgatiti Raportin e pestë nacional drejt Konventës për diversitetit biologjik.

Bashkëpunimi ndërkufitar u përmirësua në rajonin e Ohrit dhe Prespës për rezervatin e biosferës ndërkufitare. Strategjia Nacionale për mbrojtje të natyrës duhet të përfundojë.

Nuk është arritur progres në sferën e identifikimit të vendeve të ardhshme të Natura 2000. Janë zhvilluar dhe duhet të implementohet plane për menaxhim me zonat e mbrojtura. Janë bërë përpjekje të caktuara për përmirësim të financimit të implementimit të planeve për menaxhim, por masat të cilat janë në fuqi janë ende të pamjaftueshme. Lidhur me ndërtimin e dy hidrocentraleve të mëdha, Llukovo Pole dhe Boshkov Most, ngel shqetësimi për ndikimin potencialisht të dëmshëm mbi

mjedisin jetësor. Investimet në hidrocentrale duhet të jenë në përputhje me legjislacionin përkatës të BE-së për mjedisin jetësor, duke e respektuar vlerësimin për ndikimin mbi mjedisin jetësor, legjislacionin për ujëra dhe obligimet për mbrojtje të natyrës, posaçërisht për zonat e mbrojtura nacionale dhe zonat me vlerë të lartë natyrore, sipërfaqe potencialisht të mbrojtura me rrjet në zona për mbrojtje të natyrës Natura 2000.

Palët e interesuara ende nuk janë të përfshira mjaftueshëm, si dhe nuk implementohen gjithmonë në mënyrë të përshtatshme kërkesat për konsultim me palët e interesuara, gjegjësisht rezultatet nuk reflektohen gjithmonë plotësisht në vendimet.

Kontrolli i ndotjes industriale dhe menaxhimi me rreziqe

Progresi në këtë sferë është shumë i vogël, harmonizimi i plotë paraqet sfida të rëndësishme për vendin. Procesi i lëshimit të lejeve ISKZH ngec në masë të madhe. Kërkesat për konsultime të publikut lidhur me sistemin e lëshimit të lejeve për ISKZ nuk implementohet gjithmonë siç duhet. Transponimi i implementimit të Direktivës Saveso II po shënon progres.

Dukshëm duhet të përforcohet kapaciteti administrativ, posaçërisht në aktivitetet për lëshim të lejeve ISKZ, kontrollin dhe kryerjen e inspektimeve.

Kimikate

Përgatitjet në këtë sferë kanë progres të moderuar. Është ratifikuar Konventa për import/eksport të kimikateve të rrezikshme (Konventa e Roterdamit 1998)⁶, është miratuar Ligji i ri për kimikatet me qëllim që të bëhet transponimi i Rregullativës për regjistrim, vlerësim, autorizim dhe kufizim të kimikateve. Byroja për medikamentet dhe kimikate ka publikuar listë të kufizimeve dhe ndalesave për përdorim të kimikateve. Është miratuar Raport për gjendjen me kimikatet dhe Plani nacional për zvogëlim dhe eliminim të ndotësve të vazhdueshëm organikë. Është përmirësuar kapaciteti administrativ. Është arritur progres i caktuar në harmonizimin me Direktivën për biocide.

Zhurma

Përgatitjet në këtë sferë janë në fazë të hershme. Është kompletuar transponimi i direktivës për zhurmën. Kapaciteti administrativ është i pamjaftueshëm edhe sa i përket kuadrin edhe pajisjes. Zhvillimi dhe implementimi i hartave strategjike të zhurmës po ngecin, ashtu sikurse po ngec edhe përgatitja e hartave dhe planeve aksionare.

Mbrojtja civile

Lidhur me mbrojtjen civile, është arritur progres me nënshkrimin e memorandumit për mirëkuptim për pranim të vendit në instrumentin financiar për mbrojtje civile të BE-së dhe mekanizmi për mbrojtjen civile të BE-së. Progres i mirë është arritur në formë të aderimit drejt mekanizmit për mbrojtje civile të BE-së dhe pjesëmarrje në IPA – projektin për bashkëpunim në sferën e mbrojtjes civile.

U miratua strategjia nacionale për mbrojtje dhe shpëtim 2014-2018, bashkë me planin aksionar për përcaktim të lidhjes me Sistemin e përbashkët të komunikimit dhe informativ të BE-së për situata të jashtëzakonshme. Ka vazhduar bashkëpunimi trepalësh me institucionet nga Shqipëria dhe

⁶ Ligji për ratifikim ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 83/10)

Kosova në sferën e situatave të krizës dhe të jashtëzakonshme. Vendi është ende nuk është lidhur me Sistemin e përbashkët për komunikim emergjent të Mekanizmit për mbrojtje civile. Menaxhimi dhe ulja e rreziqeve nga katastrofa duhet të trajtohen si çështje prioritare, posaçërisht lidhur me përmbytjet (vërshimet) e vitit 2015.

Ndryshimet klimatike

Lidhur me ndryshimet klimatike, është shënuar progres i caktuar në zhvillimin e politikës së përgjithshme, por implementimi i legjislacionit ende nuk është efikas. Nevojiten hapa konkretë për implementim të acqui-së së BE-së për klimë, posaçërisht në skemën e tregtimit me emisionet në BE. Mbrojtja mjedisit jetësor dhe kërkesat për ndryshime klimatike ende nuk janë të integruara mjaftueshëm në krijimin e politikave dhe implementimin e të njëjtave në sfera tjera.

Komunikata e tretë nacionale u dërgua deri te Konventa kornizë e Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike. Ka progres në zhvillimin e planit nacional për përshtatje: treguesit për lëndueshmëri (vulnerabilitet) nga ndryshimet klimatike janë planifikuar për tetë sektorë, ndërsa dhjetë organe lokale i kanë përgatitur vlerësimet e tyre socio-ekonomike për lëndueshmërinë e popullatës dhe kanë themeluar sistem për paralajmërim të hershëm nga përmbytjet. Ligji për mjedis jetësor u ndryshua me qëllim që të sigurohet sistem për grumbullim dhe menaxhim me të dhëna i cili përdoret për përgatitje të inventarit nacional të emetimit të gazrave nga serrat. U miratua legjislacioni për informim të konsumatorëve për konsum të karburanteve dhe emisionet e CO₂ për automjetet e reja.

Vendi e paraqiti Raportin e parë dyvjeçar të azhurnuar drejt Konventës kornizë të KB-ve ndryshimet klimatike dhe e paraqiti kontributin e vet nacional indikativ dhe e miratoi si kontribut drejt marrëveshjes së pritur klimatike Marrëveshja Paris 2015.

U përgatit udhërrëfyese për arritje të qëllimeve afatgjata për veprim klimatik, por vendi duhet të vazhdojë t'i kushtojë vëmendje adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike.

Vendi filloi program pesëvjeçar për zhvillim të ekonomisë së gjelbër, por masat, përgjegjësitë, korniza kohore ende nuk janë definuar. Vendi është pjesëmarrës aktiv në veprimtarinë klimatike sipas Rrjetit ekologjik rajonal për aderim.

Në janar të vitit 2014 Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi Planin e tretë nacional për ndryshime klimatike. Veç kësaj u përgatitën:

- Inventar i gazrave të serrave për vitet 2011 dhe 2012 dhe inventarët e reviduar për periudhën 1990-2009 sipas metodologjisë së re të panelit ndërqeveritar për ndryshime klimatike për sektorët energjia, proceset industriale dhe bujqësia;
- Studim për potencialin për zbutje të ndryshimeve klimatike në sektorët ndërtesa, transport dhe furnizim me energji;
- Korniza konceptuale për monitorim nacional, raportim dhe verifikim të aksioneve për zbutje të ndryshimeve klimatike;
- Raport për çështje klimatike dhe aspekte gjinore;
- U definuan sektorët me potencial për rritje të emisioneve të ulëta të karbonit.

Filloi procesi i inkorporimit të masave për zbutje në strategji të caktuara nacionale. Vazhdoi programimi i pilot projekteve për implementim të mekanizmit për zhvillim të pastër në kuadër të Protokollit Kjoto ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 49/2004). Është bërë përpjekje e caktuar në sferën e mbështjellësit të ozonit dhe gazrave të fluorit. U zhvillua plan nacional për eliminim të HCFC-ve, në nëntor të vitit 2011, por nevojiten përpjekje të konsiderueshme për përforsim të kapaciteteve të

vendit për përcjellje, raportim dhe verifikim.

Nevojitet të zhvillohet strategji gjithëpërfshirëse për klimën. Aspektet klimatike gjithnjë e më shumë po integrohen në politikën energjetike, megjithatë nevojiten përpjekje të konsiderueshme për integrim të plotë të ndryshimeve klimatike në politika dhe strategji tjera sektoriale. Ndonëse më parë e ka mbështetur Marrëveshjen e Kopenhagës, vendi ende nuk ka ndërmarrë obligime për zvogëlim të emisioneve deri në vitin 2020. Vendi duhet të mendojë për të ndërmarrë obligime për të zvogëluar emisionet në ajër që janë në nivel të BE-së dhe vendeve-anëtare me qëllim që, deri në vitin 2015 të arrihet marrëveshja për klimën që do të fillonte të implementohet prej vitit 2020.

Vendi i ka bërë hapat e parë për identifikim të instalacioneve të stacionuara; janë përcaktuar 40 instalacione me qëllim që të përdoren në sistemin e ardhshëm të tregimit me emisionet.

Vendi, gjithashtu, ftohet të fillojë ta reflektojë kornizën e vet klimatike dhe energjetike për vitin 2030 në përputhje me Librin e gjelbër të Komisionit Evropian “Korniza 2030 për politikën në sferën e klimës dhe energjetikës”.

Harmonizimi i legjislacionit nacional me rregullativën për mekanizmin për përcjellje duhet të jetë prioritet. Janë inkorporuar masa për ngritjen e vetëdijes dhe të përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara, por të njëjtat duhet të forcohen edhe më tej. Grupi punues ndër-institucional për ndryshimet klimatike duhet të përforcohet dukshëm për të pasur mundësi t'i përgjigjet nevojës për veprim më efikas lidhur me çështjet klimatike në mënyrë të qëndrueshme, e jo vetëm në bazë të secilit projekt veçmas. Janë bërë përpjekje të papërfillshme për përforsimin e kapacitetit administrativ për implementim dhe realizim të legjislacionit, që në masë të madhe ngel i pamjaftueshëm, si në nivel nacional ashtu edhe në atë lokal. Koordinimi ndërmjet trupave përkatës edhe më tej është joefektiv. Palët e interesuara janë ende të inkuadruara pamjaftueshëm në procesin e vendimmarrjes. Sistemi për përcjellje të mjedisit jetësor dhe informim nuk është i përshtatshëm. Investimet në këtë sektor edhe më tutje janë në nivel të ulët në relacion me nevojat aktuale.

Kapaciteti administrativ

Në vitin 2011 është vërejtur përmirësim i kapacitetit administrativ për implementim të kërkesave për vlerësim të ndikimeve mbi mjedisin jetësor (VNMJ) dhe vlerësim strategjik të mjedisit jetësor (VSMJ), por dispozitat për konsultim të publikut ende nuk implementohen në mënyrë të përshtatshme. Kapaciteti administrativ për cilësi të ajrit, menaxhim me mbeturinat, mbrojtje të natyrës në nivel qendror dhe lokal ende është i pamjaftueshëm. Kapaciteti administrativ në sferën e kimikateve si dhe për ndotjen industriale dhe menaxhimi me rreziqe duhet të përforcohet, posaçërisht në aktivitetet kontrolluese. Sa i përket zhurmës, mungojnë edhe personeli edhe pajisjet. Koordinimi ndërmjet organeve administrative përgjegjëse për mjedisin jetësor ende nuk është efikas. Kërkesat për mbrojtje të mjedisit jetësor ende nuk janë integruar mjaft mirë në krijimin e politikave dhe implementimin në sfera tjera. Parimi masa të kujdesit, veprime parandaluese dhe ndotësi paguan aplikohet vetëm pjesërisht.

Kapaciteti administrativ, si dhe resurset teknike e financiare duhet të forcohen dukshëm me qëllim që të harmonizohen dhe të implementohet të gjitha kërkesat nga politika dhe legjislacioni i BE-së për ndryshimet klimatike.

Përfshirja e të gjitha palëve të interesuara në vendimmarrje është përmirësuar, por ende pamjaftueshëm. Sistemi për informim dhe monitorim të mjedisit jetësor duhet të zhvillohet edhe

më tej. Investimi në këto sektorë edhe më tutje është në nivel jashtëzakonisht të ulët krahasuar me nevojat, Shfrytëzimi i plotë i financimit nga burimet e jashtme kërkon përforsim të kapaciteteve dhe vendosje të sektorit në plan të parë.

Në bazë të analizës së realizuar për statusin e implementimit të legjislacionit për mjedisin jetësor, si dhe Kapitullin 27 të Raporteve të KE-së për progresin e Maqedonisë në aspektin e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike (2011-2015) mund të sillen këto konkluzione:

- Është arritur progres i kufizuar në sferën e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike. Në përgjithësi, përgatitjet në sferën e mjedisit jetësor kanë progres të moderuar, ndërsa përgatitjet në sferën e ndryshimeve klimatike edhe më tutje janë në fazën fillestare;
- Nevojiten planifikim strategjik dhe përpjekje të konsiderueshme për të siguruar që legjislacioni nacional të harmonizohet me acqui-në si dhe ai legjislacion të implementohet;
- Është arritur progres plotësues në harmonizimin e legjislacionit nacional me acqui të BE-së për mjedisin jetësor, posaçërisht në legjislacionin horizontal, menaxhimi me mbeturinat dhe cilësinë e ajrit;
- Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për implementim të legjislacionit, posaçërisht në sferat e menaxhimit me ujërat, kontrolli i ndotjes industriale, mbrojtja e natyrës dhe ndryshimeve klimatike;
- Nivelet e ndotjes së ajrit ngelin të larta, paraqesin rrezik serioz për shëndetin dhe duhet të zgjidhen urgjentisht;
- Me rëndësi maksimale është përforsimi i kapacitetit administrativ, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Investimi duhet të zmadhohet dukshëm, posaçërisht në sektorët për mbeturina dhe për ujë;
- Nevojitet bashkëpunim më i madh me shoqërinë civile dhe palët e interesuara si dhe avancim të përfshirjes së publikut, OC-të për MJ, OJQ-të në procesin e marrjes së vendimeve në përputhje me kërkesat e Konventës së Aarhusit;
- Parimi “ndotësi paguan” duhet të implementohet plotësisht;
- Sistemi për përcjellje të mjedisit jetësor dhe për informim është i papërshtatshëm;
- Kërkesat për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe aksioni klimatik ende nuk janë integruar mirë në sfera tjera të krijimit të politikave dhe implementimit të tyre;
- Duhet të përgatitet politikë dhe strategji gjithëpërfshirëse për aksion klimatik, e harmonizuar me Kornizën 2030 të BE-së;

Konkluzionet nga Strategjia për zgjerim e BE-së lidhur me mjedisin jetësor janë:

- Përgatitje e sistemit statistikor cilësor, gjegjësisht statistikë e mjedisit jetësor i cili do të përfshijë mbeturinat, ujin, mbrojtjen e mjedisit jetësor, sisteme ekonomike në mjedisin jetësor, emisione në ajër etj.;
- Lidhur me ndryshimet klimatike, vendet aspirantë për anëtarësi do të duhet të realizojnë reforma të rëndësishme në përputhje me kornizën BE2030 për politikën klimatike dhe energjetike dhe të përmbushin obligimet e tyre ndërnacionale për klimën.

2.2 Funkzioni i Inspektoratit Shtetëror për mjedisin jetësor

2.2.1 Organizimi dhe funksionimi i IShMJ

Inspektorati Shtetëror për Mjedisin Jetësor (IShMJ) realizon reforma për modernizim dhe përforsim të kapaciteteve të inspektoratit, nëpërmjet rritjes së përgjegjësisë gjatë aksioneve dhe efikasitet në hapat e ndërmarrë, si dhe përmirësim të kontakteve me publikun. IShMJ-a kryen kontrole inspektimi mbi zbatimin e masave tekniko-teknologjike për mbrojtje të ajrit, ujërave, florës, faunës dhe degradim e ndotje, mbrojtje të gjeo dhe biodiversitetit, posaçërisht pasurinë natyrore (Parqet Nacionale, monumentet natyrore, pyjet parqe, rezervatet ornitologjike dhe zonat tjera të mbrojtura me ligj), mbrojtja e mbështjellësit të ozonit, mbrojtja nga zhurma e dëmshme në mjedisin jetësor dhe mbrojtja nga rrezatimet jo-jonizuese në zonat e mbrojtura, parandalimi i incidenteve ekologjike.

Sipas Ligjit për organizim dhe funksionim të organeve të administratës shtetërore IShMJ-a është organ në kuadër të MMJPH-së, ndërsa në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mjedisin jetësor ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 187/13), Neni 194 paragrafi (7), IShMJ-a ka cilësi të personit juridik, me gjiro llogari buxhetore të veten, si shfrytëzues buxhetor i linjës së parë. Sipas Buxheti të RM-së për vitin 2016 për punën e IShMJ-së janë paraparë 15 531 000 denarë ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 209/15).

Në kuadër të IShMJ-së janë Sektorët në vijim:

- Sektori për inspektim në mjedisin jetësor dhe natyrë;
- Sektori për inspektim të ekonomizimit me ujërat;
- Sektori për koordinim të punës së inspektoratit.

Me Ligjin për mjedisin jetësor rregullohen parimet, kompetencat, organizimi i IShMJ-së, si dhe procedura e kontrollit inspektues. Funksionimi i Inspektoratit përveç me Ligjin për mjedisin jetësor është definuar dhe rregulluar edhe me Ligjin për kontrole inspektuese, Ligjin për ujërat (inspektorë për menaxhim të ujërave), si dhe afër 30 ligje tjera dhe disa qindra akte nënligjore.

Sipas rregulloreve aktuale kontrolli inspektues në sferën e mjedisit jetësor është rregulluar në nivel qendror dhe lokal. Në nivel qendror kontrolli inspektues realizohet nga Inspektorati Shtetëror për mjedisin jetësor nëpërmjet inspektorëve për mjedisin jetësor, inspektorët shtetërorë për natyrën dhe inspektorët për menaxhim të ujërave. Në nivel lokal, kontrolli inspektues realizohet nga inspektorë të autorizuar.

Sipas mënyrës së rregullimit të kontrollit inspektues ekziston planifikim vjetor i kontrollit inspektues me anë të përgatitjes së Programit për kontroll inspektues nga Inspektorati Shtetëror për mjedisin jetësor. Përcjellja e implementimit të programit në nivel qendror realizohet në përputhje me Ligjin për kontroll inspektues.

Aktiviteti kryesor i IShMJ-së është të realizojë **kontrolle, hetime dhe revizione të lokaliteteve**. Ato janë tre lloj aktiviteteve:

- Parandaluese (në procesin e miratimit të ISKZ-ve të ashtuquajturat leje ekologjike, autorizime, vlera përkufizuese të emisioneve);
- Ndëshkuese (imponim të gjobave, de-komisionim (pezullim) të operacioneve ose aktiviteteve);
- Remediative (imponim të aktiviteteve rehabilituese për eliminim të mangësive dhe shkaktarëve të tyre).

Në foton në vijim (Foto 1)⁷ është paraqitur cikli i inspektimit në mjedisin jetësor.




Foto 1 Cikli i inspektimeve në mjedisin jetësor

2.2.2 Probleme dhe sfida për funksionimin e IShMJ-së

Në vitin 2001 Parlamenti i Evropës e miratoi Rekomandimin për sigurim të kritereve minimale për inspektim në mjedisin jetësor (RKMIM). Qëllimi i RKMIM-it është të përforcohet harmonizimi dhe të kontribuohet në implementimin sa më konsekuent të Ligjit për mjedisin jetësor të Bashkësisë në të gjitha vendet-anëtare të BE-së. RKMIM-i përcakton drejtime për inspektim mjedisit jetësor të instalacioneve (reparteve), ndërmarrjeve dhe institucioneve emisionet e të cilave në ajër, shkarkimet në ujë ose aktivitete për shtyrje ose ripërtëritje janë lëndë e kërkesave për autorizim, leje ose licencim në përputhje me ligjin e Bashkësisë (“instalacione të kontrolluara”). Të gjitha organet për inspektim në vendet-anëtare të BE-së duhet t’i aplikojnë këto udhëzime. Ato kujdesen ndër tjerash edhe për kriteret minimale për vendosje dhe vlerësim të planeve për inspektionet në mjedisin jetësor.

Sipas RKMIM-it të gjitha aktivitetet e inspektionit duhet të planifikohen paraprakisht, që donë të thotë se duhet të kenë plane për inspektim të cilat e mbulojnë tërë territorin e secilit shtet dhe të të gjitha instalacioneve që kontrollohen. Planet duhet të bëhen në bazë të: (i) të respektimit të kërkesave ligjore të BE-së, (ii) regjistrimit të instalacioneve që kontrollohen (iii) vlerësimit të përgjithshëm të çështjeve nga sfera e mjedisit jetësor, dhe (iv) vlerësimit të përgjithshëm të gjendjes me harmonizimit të instalacioneve të kontrolluara.

⁷ Burim: Doracaku për planifikim, kontroll inspektues dhe implementim të legjislacionit të BE-së në mjedisin jetësor, Tetor 2015

Planet për inspektim duhet të jenë në dispozicion për publikun, në përputhje me konventën e Aarhusit dhe Direktivën 2003/4/ KE për mundësi të publikut të ketë qasje deri te informacionet për mjedisin jetësor.

Lidhur me planifikimin e kontrollit inspektues në nivel lokal, gjithashtu ekziston obligim për përgatitje të Programit për kontrole inspektuese në nivel lokal. Por përcjellja e programit nuk bëhet në përputhje me Ligjin për kontroll inspektues.

Në bazë të asaj që u theksua më parë mund të vërehet se ekziston dallim ndërmjet obligimeve të inspektorëve në nivel qendror dhe atyre në nivel lokal e ky dallim del nga Ligji për kontroll inspektues gjegjësisht nga obligimet të cilat janë parashikuara në Ligjin për kontrole inspektuese për inspektorët shtetërorë e që nuk vlejné për inspektorët lokalë.

Sipas kësaj që u theksua mund të konkludohet se nuk ekziston koordinim në planifikimin e kontrollit inspektues në sferën e mjedisit jetësor ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal.

Veç kësaj, planifikimi nuk bëhet në bazë të kriterëve të themeluara, gjegjësisht nuk ekziston planifikim i balancuar i kontrollit inspektues në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë. Gjithashtu nuk ekziston as sistem i balancuar i përcjelljes së implementimit të kontrollit inspektues në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Implementimi i këtillë i kontrollit inspektues në nivel qendror dhe lokal, si dhe mungesa e mekanizmit me të cilin do të përcillet implementimi i kontrollit inspektues në nivel qendror dhe lokal e vë në dyshim efikasitetin e të njëjtit dhe rezultatet e tij. Realizimi i kontrollit inspektues në këtë mënyrë nuk jep pasqyrë reale për implementimit dhe respektimin e rregulloreve në sferën e mjedisit jetësor nga ana e subjekteve të kontrollit të cilët e kanë për detyrë t'i respektojnë të njëjtat. Mungesa e të dhënave për përmbushje të kushteve, të përcaktuara në rregulloret për mjedisin jetësor nga subjektet e kontrollit, ndikon edhe në krijimin e mëtejshëm të krijimit të politikave në sferën e mjedisit jetësor në përputhje me nevojat. Mungesa e krejt asaj që u theksua më parë ndikon mbi cilësinë e mjedisit jetësor për shkak së në atë mënyrë mungojné edhe masat dhe aktivitetet e nevojshme të cilat duhet të ndërmerren për përmirësimin e tij.

Në nivel të BE-së inspekcioni për mjedisin jetësor është rregulluar me Rekomandimin e Parlamentit Evropian dhe Këshillit prej 4 prilli 2001 për sigurim të kriterëve minimale për inspektim të mjedisit jetësor në Vendet anëtare. Sipas këtij rekomandimi kontrolli inspektues është rregulluar vetëm pjesërisht më kërkesat të cilat dalin nga ky rekomandim. Lidhur me organizimin e inspekcionit në mjedisin jetësor nga BE-ja në direktiva të caktuara në sferën e mjedisit jetësor, konkretisht në nenin 24 të Direktivës për emisione industriale 2010/75/EU si dhe në nenin 20 nga Direktiva SEVESO III është rregulluar mënyra e kryerjes së kontrollit inspektues në mjedisin jetësor dhe Rregullativa 2013/2006 për transport të dërgesave të mbeturinave. Me këtë për vendet anëtare të BE-së imponohet obligimi që detyrimisht t'i respektojnë obligimet që kanë të bëjnë me inspektimin në mjedisin jetësor.

Arsye kryesore për shkak të të cilave kontrolli inspektues nuk i plotëson kërkesat që dalin nga e drejta e BE-së janë me sa vijon:

- Planifikimet e inspekcioneve në mjedisin jetësor nuk bëhen në bazë të planifikimit shumëvjeçar që do të jetë në përputhje me dokumentet strategjike në sferën e mjedisit jetësor, gjegjësisht i njëjti nuk e përcjell realizimin e prioriteteve dhe qëllimeve të definuara me dokumentet e planeve në sferën e mjedisit jetësor;

- Mungon planifikim shumëvjeçar për inspektim në mjedisin jetësor me të cilin do të përfshihet i tërë territori i Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht planifikimi do të bëhet në nivel qendror dhe lokal dhe i njëjti do t'i merr parasysh të gjithë subjektet për kontrollit të cilët me punën e tyre ndikojnë mbi mjedisin jetësor;
- Mungojnë kriteret për vlerësim të rrezikut të cilin subjektet e kanë mbi mjedisin jetësor;
- Kriteret e definuara në kuadër të Ligjit për kontroll financiar për planifikim dhe vlerësim të punës së inspektorëve dhe inspektorateve, nuk janë në përputhje me praktikën më të mira të BE-së;
- Për shkak të numrit të madh të aktiviteteve që kanë ndikim të rëndësishëm mbi mjedisin jetësor, e që janë nën kompetencën e inspektorëve të autorizuar lokalë për mjedisin jetësor, nuk ekziston mekanizëm për bashkëpunim dhe kontroll me inspektorët e autorizuar dhe në përputhje me këtë edhe ndërmarrje të masave në rast të mungesës së rezultateve;
- Statusi dhe rregullat e ndryshme të cilat aplikohen për inspektorët shtetërorë dhe inspektorët e autorizuar lokalë për mjedisin jetësor lidhur me planifikimin e kontrollit inspektues si dhe përcjellja e të njëjtit;
- Inspektorati Shtetëror për mjedisin jetësor është shumë i kufizuar për të vepruar në rast se inspektorët lokalë nuk i kryejnë detyrat për të cilat janë përgjegjës;
- Mungesë e trajnimit të vazhdueshëm dhe aftësimin profesional të inspektorëve për mjedisin jetësor.

Për tejkalim të problemeve aktuale në bazë të EU rregullativës në sferën e mbrojtjes së mjedisit jetësor është edhe përgatitja e Ligjit për inspektim në mjedisin jetësor me qëllim që të vendoset sistem efikas i inspektimit në mjedisin jetësor në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë me të cilin do të mundësohet rritje e implementimit të legjisllacionit për mjedisin jetësor nga subjektet që kontrollohen dhe plotësim të standardeve për mjedisin jetësor me të cilin do të ndikohet në avancimin e mjedisit jetësor.

Problem kryesor për të cilin u ndërmorën aktivitete për përgatitje të ligjit të ri për inspekcion në mjedisin jetësor është nevoja për të vendosur sistem të planifikimit të inspekcionit në mjedisin jetësor në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, i cili do të bazohet në kriteret për vlerësim të rrezikut të cilin subjektet që kontrollohen e kanë mbi mjedisin jetësor

Vendosja e sistemit do të bazohet në:

- hulumtim (analizë) i ndikimit të përgjithshëm të rëndësishëm të cilin subjektet, që kontrollohen, e kanë mbi mjedisin jetësor;
- planifikim shumëvjeçar i inspektimit në mjedisin jetësor në të cilin do të përfshihen edhe qeveria qendrore edhe ajo lokale në bazë të vlerësimit sistematik të rrezikut të cilin subjektet e kontrollohen e kanë mbi mjedisin jetësor;
- rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit në nivel qendror dhe atë lokal në inspektimin e mjedisit jetësor dhe
- përforsim të kapaciteteve administrative me anë të planifikimit të vazhdueshëm të nevojave për trajnim dhe aftësim profesional.

Në janar të vitit 2016 u përgatit Propozim Ligji për inspektim në mjedisin jetësor.

2.2.3 Aktivitetet e realizuara të IShMJ-së

Sipas Raportit vjetër për kontrolle inspektuese të kryera dhe implementim të masave për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe ujërat për vitin 2014, IShMJ-a i ka realizuar këto aktivitete:

- Janë ndërmarrë veprime në 3091 lëndë (janë përgatitur gjithsej 3091 Procesverbale me të cilat janë konstatuar situata të caktuara gjatë kryerjes së kontrollit të drejtpërdrejt në vendin e ngjarjes);
- në procedurë inspektuese janë sjellë 39 vendime prej të cilave me 366 vendime janë urdhëresa si dhe 28 vendime me të cilat ndalohen aktivitete të caktuara të subjekteve të inspektuara;
- janë parashtruar 72 kërkesa për të nisur procedurë kundërvajtëse;
- janë miratuar gjithsej 141 njoftime/kërkesa deri te subjekte të ndryshme juridike dhe persona fizikë;
- janë përgatitur 5614 konkluzione për ndërprerje të procedurës për shkak të pagesës së kompensimit.

Në përputhje me më tepër ligje, procedurat në vitin 2014 (Foto 2) janë me sa vijon:

- Ligji për menaxhim me mbeturinat – 1 096 kontrolle;
- Ligji për mjedisin jetësor 1 102 kontrolle;
- Ligji për menaxhim me paketim dhe me mbeturina nga paketimi – 864 kontrolle;
- Ligji për ujërat – 154 kontrolle;
- Ligji për mbrojtje të natyrës – 165 kontrolle;
- Ligji për cilësi të ajrit ambiental – 13 kontrolle;
- Ligji për mbrojtje nga zhurma – 35 kontrolle;
- Tjera – 4 kontrolle.





Foto 2 Përshkrimi i aktiviteteve inspektuese gjatë vitit 2014



3. INTEGRIMI I GRUPEVE TË LËNDUESHME NË SISTEMIN PËR MBROJTJE TË MJEDISIT JETËSOR DHE NDRYSHIME KLIMATIKE

Grupe të lëndueshme janë të gjithë njerëzit që pësojnë pasoja të mëdha dhe afatgjata mbi shëndetin dhe mirëqenien sociale si rezultat i ndotjes së mjedisit jetësor, diskriminim në baza të ndryshme nga ana e institucioneve të sistemit për shkak të mosndërmarrjes së masave përkatëse parandaluese dhe zbatim të rregullores ligjore dhe njerëz të rrezikuar të ekspozuar në kërcënim periodik ose të vazhdueshëm të pabarazive të këqija sociale, ekonomike dhe kulturore që kanë të bëjnë me cilësinë e jetës urbane dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Rreziqe që shkaktojnë kërcënim periodik ose të vazhdueshëm janë:

- Kushte substandarde të jetës;
- Ekspozim në shkallë të lartë të ndotjes së ajrit;
- Njerëz të rrezikuar nga vërshimet si rezultat i ndryshimeve klimatike;
- Njerëz me sëmundje profesionale si rezultat i mjedisit të keq të punës dhe cilësisë së ulët të mjedisit jetësor;
- Pamundësia për të pasur qasje te uji i pastër për pije dhe sanitacion;
- Ekspozim në tokë të ndotur dhe kontaminuar;
- Prezencë e deponive të egra në rrethinën më të afërt të banimit;
- Ekspozim në rrezatime jonizuese;
- Ekspozim në zhurmë;
- Njerëz të cilët nuk kanë qasje te informatat në lidhje me mjedisin jetësor, mënyrën e vendimmarrjes dhe qasjes në drejtësi;
- Rreziqe tjera të kërcënimit periodik dhe të vazhdueshëm ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies së njerëzve.

Për nevojat e këtij Raporti, kurse në përputhje me kërkesat e programit të projektit është dhënë vështrim për lëndueshmërinë socio-ekonomike dhe rreziqet klimatike, dhe ndikimin mbi shëndetin nga ndryshimet klimatike mbi personat e rasteve të lëndueshme sociale si kategoria më e brishtë e popullatës.

Në Shtojcën nr. 1 është dhënë listë e organizatave që punojnë me grupe të lëndueshme.

3.1 Struktura institucionale e ndryshimeve klimatike

Republika e Maqedonisë është palë e Konventës Kornizë të KB-ve për ndryshime klimatike (UNFCCC), si shtet që nuk bie nën Aneksin I dhe palë e Protokollit të Kjotos, pa obligim për të kuantifikuar kufizimin dhe reduktimin e emisioneve (QELRC). Megjithatë, shteti i është qasur Marrëveshjes së Kopenhagës dhe ka dërguar listë të aktiviteteve për zbutje (pa reduktime të kuantifikuara të emisioneve) në bazë të këtyre aktiviteteve.

Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor (MMJPH) është organ më i rëndësishëm qeveritar përgjegjës për zhvillim të politikave që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike.

MMJPH-ja është caktuar si Trup Qendror Nacional për UNFCCC dhe Organ i Caktuar Nacional

(DNA) për implementimin e Protokollit të Kjotos, andaj për këtë arsye themi se ky është edhe organ kryesor qeveritar për koordinim të implementimit të dispozitave të Konventës dhe Protokollit. Ministritë tjera të cilat kanë përgjegjësi në lidhje me ndryshimet klimatike janë: Ministria për bujqësi, pylltari dhe ekonomi të ujërave, Ministria e ekonomisë, Ministria për transport dhe lidhje dhe Ministria e financave. Shumica e këtyre ministrive kanë caktuar Trupa qendror për ndryshime klimatike të cilët janë përgjegjës për integrim të ndryshimeve klimatike në politikat, strategjitë dhe programet përkatëse. Përveç kësaj, Ministria e shëndetësisë ka formuar Komitet Nacional për ndryshime klimatike dhe shëndet më vitin 2009, që funksionon si trup përgjegjës për mbikëqyrje dhe miratim të vendimeve në këtë sferë.

Në janar të vitit 2000 është themeluar **Zyre e Projektit për ndryshime klimatike** në MMJPH. Gjithashtu, Qeveria themeloi **Komitet Nacional për ndryshime klimatike** që përbëhet prej përfaqësuesve të të gjitha palëve të interesuara relevante: organeve qeveritare, qarqeve akademike, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Komiteti nacional për ndryshime klimatike është platformë në të cilën marrin pjesë shumë palë të interesuara, qëllimi i të cilave është të sigurohet mbështetje në nivel të lartë dhe të jep udhëzime për politikat globale për ndryshime klimatike në vend. Përveç kësaj, është themeluar edhe **Këshilli Nacional për zhvillim të qëndrueshëm** nën patronazh e Zëvendës Kryetarit të Qeverisë kompetent për çështje ekonomike.

Në nivel të legjislationit, çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike janë inkorporuar në Ligjin për mjedis jetësor, duke përfshirë edhe dispozitat për përgatitje të inventarëve për emisione të gazrave të serrave, si dhe plan aksionar për masa dhe aktivitete për reduktim të emisioneve të rritura të gazrave të serrave dhe zbutje të ndryshimeve klimatike.

Ligji për mjedis jetësor përcakton se duhet miratuar Plan nacional për ndryshime klimatike me qëllim që të stabilizohen koncentrimet e gazrave të serrave në nivel që do të kishte parandaluar çfarëdo lloj ndikimi të rrezikshëm antropologjik mbi sistemin klimatik në kornizë të caktuar kohore, mjaftueshëm që t'iu mundësohet ekosistemeve natyreshëm të adaptohen në ndryshimet klimatike, në përputhje me parimin për bashkëpunim ndërnacional dhe qëllimet e zhvillimit nacional, social dhe ekonomik. Në korrik të vitit 2013 janë miratuar ndryshimet në Ligjin për mjedis jetësor, me ç'rast është shtuar nën i ri (188) për sistemin nacional të inventarëve për emisione të gazrave të serrave. Ky nen parasheh themelimin të sistemit nacional të inventarëve të emisioneve të gazrave të serrave që duhet të sigurojë bazë të të dhënave me informata relevante për përgatitje të inventarëve të gazrave të serrave si dhe përcjellje të implementimit të marrëveshjeve lidhur me ndryshimet klimatike. Sistemi përfshin grumbullim, përpunim, vlerësim dhe kontroll të cilësisë dhe menaxhim me sigurinë, si dhe magazinim, përdorim dhe distribuim dhe prezantim të të dhënave dhe informatave që janë fituar prej subjekteve që menaxhojnë me të dhëna për emisione antropologjike prej burimeve të gazrave të serrave në atmosferë.

Gjithashtu duhet të theksohet se në kontekst të procesit për aderim në BE, Republika e Maqedonisë ka nisur procesin për harmonizim të qasjes së shtetit me obligimet e BE-së ndaj UNFCCC dhe pjesët e *acquis communautaire* të BE-së që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike.

3.2 Lëndueshmëria ndaj ndryshimeve klimatike

Në raportin e vitit 2009 “Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në Evropë dhe Azinë Qendrore”⁸ janë përgatitur një sërë indeksesh me të cilat vlerësohet ekspozimi, ndjeshmëria dhe kapaciteti për përshtatje të disa shteteve të caktuara lidhur me ndryshimet klimatike. Lëndueshmëria e Republikës së Maqedonisë në bazë të këtij indeksi, është klasifikuar si “mesatare” në krahasim me shtetet tjera në rajon. Krahas kësaj, në këtë raport Republika e Maqedonisë është identifikuar në mesin e pesë shteteve të rajonit të cilat me siguri do t'i ndjejnë rritjet në ngjarjeve ekstreme klimatike deri kah fundi i shekullit 21.

Analiza e ndikimeve, lëndueshmërisë dhe kapacitetit për adaptim në Planin e Tretë Nacional për ndryshime klimatike, më vitin 2013 është bërë për tetë sektorë (bujqësi dhe blegtori diversiteti biologjik, pylltari, shëndetësi, turizëm, trashëgimi kulturore, burimet e ujit dhe zhvillim socio-ekonomik), me theks të veçantë në rajonin juglindor i cili edhe në dy raportet paraprake nacionale ka qenë i identifikuar si posaçërisht i lëndueshëm ndaj ndryshimeve klimatike.

3.2.1 Lëndueshmëria socio-ekonomike dhe ndryshimet klimatike

Procesi i ndryshimeve klimatike tanimë ka filluar dhe duhet të bëhen përpjekje për vlerësim të lëndueshmërisë së popullatës në R. e Maqedonisë për të bërë intervenimet dhe përshtatjet e nevojshme.

Ndryshimet klimatike ndikojnë mbi të gjithë, por jo të gjithë janë njëloj të lëndueshëm ndaj tyre për shkak se faktorët si pozita gjeografike, sistemi shëndetësor, moshë, klasa sociale dhe sistemet për mbështetje e përcaktojnë ndikim e ndryshimeve klimatike mbi njerëzit.

Lëndueshmëria e popullatës lidhur me ndryshimet klimatike rritet kur është nën ndikimin e faktorëve të caktuar socio-ekonomikë.

Për të identifikuar lëndueshmërinë sociale dhe për të përcaktuar indeksin e lëndueshmërisë sociale të popullatës janë marrë parasysh treguesit socio-ekonomikë⁹ në vijim.

⁸ Banka Botërore, qershor, 2009

⁹ Lëndueshmëria Sicio-ekonomike e popullatës nga rreziku u katastrofave dhe ndryshimet klimatike, 2013

Tabela 6 Tregues për përcaktim të indeksit të lëndueshmërisë sociale të popullatës

Karakteristikat socio-ekonomike	Variabilja	Efeki i lëndueshmërisë sociale
Përkatësia etnike ¹⁰	% popullatës rome ¹¹ ;	e Zmadhon
Mosha	% nën gjashtë vjeç % më të moshuar se 65 vjeç	e Zmadhon e Zmadhon
Bazë sipas së cilës ekonomia familjare e shfrytëzon banesën në të cilën jeton	% pronarë	e Zvogëlon
Profesioni	% e profesionit që më së shumti pëson ndikim nga ndryshimet klimatike ¹²	e Zmadhon
Ekonomi familjare me më tepër anëtarë	% Ekonomi familjare që përbëhen prej dy ose më tepër familje	e Zmadhon
Shkrim-leximi	% e analfabetëve në numrin e përgjithshëm të popullatës në 9+	e Zmadhon
Arsimi	% shkollim i kryer më i ulët se shkollimi i lartë	e Zmadhon
Rritje e popullatës	Shkalla mesatare e rritjes së popullatës Rritje e shpejtë e popullatës	e Zmadhon
Qasje deri te shërbimet shëndetësore	Mjekë në 1000 banorë	e Zmadhon
Popullata me nevoja të posaçme	% popullatë me pengesa në zhvillim % popullata me pengesa në zhvillim të vendosur në institucione	e Zmadhon e Zmadhon
Popullata që kërkon trajtim të posaçëm në rast të katastrofës	Turistë në 1000 banorë	e Zmadhon
Varësia sociale	% shfrytëzues të ndihmës sociale	e Zmadhon

Të dhënat për përcaktim të treguesve socio-ekonomikë merren nga Enti Statistikor shtetëror nga regjistrimi i fundit i popullatës, ekonomive familjare dhe banesat, regjistrimi bë bujqësi, vlerësime të popullatës në bazë të gjinisë dhe moshës, të dhëna për institucionet shëndetësore dhe mjekësore, si dhe të dhëna për shfrytëzues të ndihmës sociale financiare dhe për persona me nevoja të posaçme, të dhëna për punësim, të dhëna statistikore për të ardhurat dhe shpenzimet e ekonomive familjare, varfëria.

Problemi më i madh gjatë vlerësimit të lëndueshmërisë të niveleve territoriale të ndryshme është dispozicioni i të dhënave të besueshme dhe të sakta për përlogaritje të treguesve të zgjedhur si dhe mundësia e qasjes deri te të dhënat ekzistuese.

Si rezultat i ndikimit të faktorëve dhe kushteve klimatike të pranishme të cilat janë karakteristike për Republikën e Maqedonisë, si dhe të ndryshimeve klimatike e tendencave të cilat ndodhin në nivel global, regional dhe lokal, Republika e Maqedonisë në gjashtë vitet e fundit ka qenë shpesh e

¹⁰ Shënim: Përkatësia etnike është dimension subjektiv, në bazë të deklaramit të lirë

¹¹ Në Republikën e Maqedonisë komuniteti etnik rom është identifikuar si i lëndueshëm prandaj edhe është përfshirë në përlogarotjet e indeksit të lëndueshmërisë sociale.

¹² Persona me profesione të caktuara mund të jenë më të lëndueshëm se të tjerët nga ndryshimet klimatike si për shembull: - Bujqit të cilët në kushte të ndryshimeve klimatike mund të ngelin pa pronë bujqësore, pa punë dhe pa të ardhura. Në anën tjetër duke marrë parasysh se bujqit punojnë nën qiell të hapur janë më shumë të ekspozuar ndaj rrezikut për shëndetin nga valët e të nxehtit dhe fenomeneve tjera që shkaktohen nga ndryshimet klimatike. Ekspozim të tillë ka edhe në rastine punëtorëve në ndërtimtari dhe te disa profesione shërbimi nën qiell të hapur.

ekspozuar në fatkeqësi natyrore të karakterit meteorologjik, siç janë:

- kushte klimatike ekstreme në periudhën e verës, që shprehen me temperatura të larta, thatësi dhe hidro-potencial të zvogëluar;
- kushte klimatike ekstreme në periudhën e dimrit që shprehen me temperatura të theksuara të ulëta, ngrica, reshje bore etj.;
- zjarre në natyrë dhe zjarre në pyje me intensitet të madh;
- të reshura intensive dhe të rrëmbyeshme të shiut dhe breshëri të cilat shkaktojnë dëme në bujqësi, përmytje, rrëshqitje të tokës dhe dëmtime të infrastrukturës;
- tërmete për shkak të parakushteve gjeo-tektonike (rajon me trysni sizmike), dhe me pasoja katastrofale (Valandovë, Gjevgjeli);
- rrëshqitje të dheut, erozion dhe çrregullime tjera tektonike etj. (Milkovski Lj. 2013).

Katastrofat e tilla natyrore kanë ndikim negativ mbi njerëzit ose mjedisin jetësor. Katastrofat natyrore varësisht nga intensiteti dhe forca mund të kenë ndikim negativ mbi shëndetin dhe gjendjen ekonomike të popullatës: çrregullim të shëndetit, shfaqje të sëmundjeve të caktuara, trauma psikologjike pas fatkeqësisë, humbje ekonomike, evakuim të detyrueshëm nga vendi i banimit dhe humbje të pronës, ndërsa gjatë disa katastrofve natyrore shkaktohen edhe vdekje e lëndime. Lëndueshmëria e popullatës lokale lidhur me fatkeqësi të caktuara natyrore dhe katastrofa natyrore rritet nën ndikimin e faktorëve të caktuar socio-ekonomikë.

Grupe të lëndueshme sociale janë grupe të popullatës që gjenden në situatë të jetës për shkak të së cilës tek ata ekziston mundësia të goditen nga probleme të ndryshme sociale, psikologjike, shëndetësore, ekonomike dhe probleme tjera, ndërsa problemet e tilla mund të lënë pasoja më të rënda tek ata për dallim nga pjesa tjetër e popullatës. Situata e tyre jetësore është faktor i rrezikut i cili nuk është domosdoshmërisht shkaktar i drejtpërdrejt, por në kombinim me faktorë tjerë i zmadhon mundësitë për paraqitje të problemit.

Në bazë të faktorëve të veçantë të rrezikut (mosha, gjinia, ekzistenca e ndonjë sëmundjeje, përdorimi i ilaçeve, mbipesha e trupit, dehidratimi, aftësia e zvogëluar për aklimatizim dhe shtatzënia), faktorët e rrezikut të mjedisit jetësor (kushtet e banimit, kapaciteti për ftohje të brendshme, efekti urban i “ishullit të ngrohur”, aerondotja, kushtet në mjedisin e punës dhe vendi i punës) dhe faktorët e rrezikut social- (vetmia, pamundësia për të shfrytëzuar sisteme informative dhe shërbime tjera të ndihmës mjekësore emergjente) sipas analizave të bëra ma anë të hulumtimeve, literaturës në dispozicion dhe udhëzimeve të përfshira në doracakun e OBSH-së “Plane aksionare shëndetësore për nxehtësi” sipas PLANIT AKSIONAR për parandalim të pasojave nga vala e nxehtësisë mbi popullatën në Republikën e Maqedonisë në R. e Maqedonisë janë identifikuar si grupe të lëndueshme të popullatës edhe persona statusi socio-ekonomik i të cilëve i bën të lëndueshëm. Persona statusi socio-ekonomik i bën më të lëndueshëm të cilët për shkak të faktorëve të caktuar socialë (profesioni, izolimi social etj.) janë të lëndueshëm ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Në këtë grup përfshihen personat e pastrehë të cilët jetojnë në substandarde, fëmijë në rrugë, persona të zhvendosur brenda shtetit etj.

Maqedonia ka shkallë të lartë të papunësisë dhe varfërisë që kontribuon të ketë pasiguri të mëdha. Personat e papunë, të cilët janë të varfër, nuk janë të përfshirë mjaftueshëm dhe ato kanë qasje të kufizuar deri te mallrat dhe shërbimet ose kjo qasje është plotësisht e ndërprerë ashtu që kjo ka ndikim negativ mbi standardin e tyre jetësor. Në rrugën për të gjetur strategji përkatëse për t'u ballafaquar me problemet e popullatës së varfër, është nisur një proces në nivel Nacional dhe atë individual, ndonëse ky qëllim është i vështirë për ta arritur.

Numri më i madh i personave pa punë janë persona me nivel të ulët arsimor dhe pa kualifikime, grupet e lëndueshme etnike (siç janë Romët, 78,5%), shkalla e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës është më e ulët, e posaçërisht më pak janë të përfaqësuara grupet etnike dhe gratë turke dhe shqiptare.

Programet më së shpeshti janë të drejtuara në regjistrimin e personave pa punë, të cilët kanë kryer shkollën fillore dhe të cilët janë në moshë më të re. Promovimi i vetëpunësimit e ka për qëllim të mbështet popullata e varfër në mjediset rurale dhe urbane, me programe të shumta për vetëpunësim që janë nxitur nga Qevria ose të mbështetur nga Donatorë ndërnacionalë në kuadër të aktiviteteve të projekteve. Programet ofrojnë kurse për trajnim dhe rikualifikim, subvencionim të punësimit me theks të veçantë në personat invalidë, përforcimi ekonomik i grave viktime të dhunës në familje, si dhe programe për mbështetje të Romëve..

Vlen të përmendet se në Ligjin për paketim të mbeturinave si dhe mbeturinat e paketimeve është paraparë të ketë Grumbullues individual i mbeturinave si person fizik i cili rregullt grumbullon dhe shet mbeturina të parrezikshme ndonjë person juridik ose fizik i cili posedon leje për të kryer veprimtarinë e magazinimit, trajtimit dhe/ose përpunimit të mbeturinave dhe për gjëra që janë evidentuar par atë person juridik ose fizik.

Sipas **Nenit 24** Trajtim individual të pavarur të mbeturinave nga paketimi i të njëjtit parashihet që Prodhuesit obligimet ligjore mundën t'i realizojnë në mënyrë të pavarur nëse kanë siguruar leje për trajtim të mbeturinave nga paketimi dhe janë të regjistruar në evidencën e organit profesional i cili siguron trajtim të mbeturinave nga paketimi që e krijon.

Në bazë të lejes që e marrë, organi profesional, lëshon vërtetim se prodhuesi është i regjistruar në evidencën e prodhuesve si subjekt i cili siguron trajtim në mënyrë të pavarur të mbeturinave që i krijon nga paketimet.

Përpunuesi i pavarur i mbeturinave nga paketimi e ka për obligim të sigurojë: grumbullim të rregullt të mbeturinave të cilën ai vet e krijon nga paketimi, të grumbullojë rregullisht mbeturinat nga paketimi prej konsumatorëve të fundit dhe t'i përdorë sërish, të bëjë përpunim ose mënjanim të sasisë së mbeturinës së grumbulluar dhe nga mbeturinat e paketimit.

Përpunuesi i pavarur me mbeturina nga paketimet është i obliguar në mënyrë adekuate t'i përmbush obligimet dhe të dërgojë raporte. Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor e refuzon kërkesën për lëshim të licencës nga paragrafi, parashtruesi ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Komisionin Shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.

Në bazë të këtyre dispozitave si dhe në përputhje me Ligjin për mbrojtje sociale, numër i madh i aktiviteteve të Organizatave civile janë ndërmarrë me qëllim të regjistrimit të grumbulluesve informal të mbeturinave, edukimit të tyre, ndihmës teknike etj.

Grantet janë mekanizmi më i shpeshtë për përkrahjen e sektorit civil, përkrahje të ideve novative dhe promovim të shërbimeve novative. Ato nuk janë mekanizma efektiv për përkrahjen e shërbimeve aktuale, duke pasur parasysh se bazohen në projekte dhe se janë të kufizuara në aspekt kohor. Në anën tjetër, grantet zakonisht janë më të lehta për administrim krahasuar me mekanizmat tjerë financiar, siç janë marrëveshjet ose pagesat nga ana e personave të tretë. Për këtë arsye, në vendet të cilat nuk janë ende të gatshme të instalojnë skemë të komplikuar të financimit në dërgesën e shërbimeve sociale nga ana e aktorëve jo-shtetëror, grantet për organizatat civile mund të jenë zgjidhje e mirë në tejkalimin e hendekut ndërmjet nevojave ekzistuese dhe kapaciteteve të shërbimeve ekzistuese.

Statusi socio-ekonomik ndikon në aftësinë e individëve dhe bashkësisë t'i absorbojë humbjet nga rreziqet. Në përgjithësi, personat me të ardhura të ulëta dhe ata që jetojnë në varfëri janë më të lëndueshëm ndaj katastrofave natyrore krahasuar me të pasurit edhe atë në mënyra të ndryshme dhe për shkaqe të ndryshme. Njerëzit e varfër kanë më pak para të shpenzojnë në masa parandaluese, për rezerva urgjente dhe në përpjekjet për rinovim. Ata zakonisht jetojnë në kushte më të këqija banimi, nuk e sigurojnë pronën e tyre dhe ngjashëm, ndërkaq nëse pësojnë dëme nga katastrofat natyrore, për shkak të të arhurave të ulëta nuk mund t'i sanojnë pasojat. Në rast se nevojitet evakuim i shpejtë, personat të cilët s'kanë automjete personale kanë më pak mundësi të evakuhohen. Më tutje ka gjasa shumë më të mëdha që personat me të ardhura të ulëta të pësojnë stres emocional dhe ndikime tjera psikike pas ndonjë katastrofe për shkak të humbjeve ekonomike për shkak të faktit se vështirë mund të kompensojnë atë që e kanë humbur. Në pjesën e karakteristikave socio-ekonomike është përfshirë përkatësia etnike si faktor që mund të zmadhojë lëndueshmërinë sociale. Në të gjitha shoqëritë ka komunitete të caktuara të racave, etnike, religjioze ose komunitete të llojit tjetër të cilat kanë standard mesatarisht më të ulët të jetës se të tjerët.

Mosha është marrë parasysh si një prej faktorëve që mund të rrisin lëndueshmërinë sociale duke u nisur nga fakti se në kushte të katastrofave, fëmijët dhe më të moshuarit pa përkrahje të jashtme nuk mund të reagojnë ndaj katastrofës. Çrregullimet që mund të shfaqen pas fatkeqësisë mund të kenë ndikime të konsiderueshme psikike dhe fizike te fëmijët. Duke pasur parasysh lartësitë e pensioneve, por edhe nëse merret në përgjithësi ekziston mundësi më e madhe që personat e moshuar mos t'i kenë parakushtet fizike dhe ekonomike për t'iu përgjigjur në mënyrë efikase ndaj katastrofës. Poashtu edhe fëmijët deri në moshën 6 vjeçare dhe më të rriturit janë më të ndjeshëm në aspektin shëndetësor janë më të paraprirë për të pësuar probleme shëndetësore, personat e moshuar rikuperohen më vështirë. Personat e moshuar janë më të vështirë për evakuim jo vetëm për shkak të vështirësive fizike, por edhe për faktin se kur ka katastrofa nuk duan të evakuhohen nga shtëpitë e tyre.

Ekonomitë shtëpiake me numër të madh anëtarësh ose familje që përbëhen prej vetëm një prind me fëmijë shpesh herë kanë mjete të kufizuara financiare dhe nëse goditen nga fatkeqësitë natyrore më vështirë mund të ballafaqohen me pasojat. Në pozitë të njëjtë janë edhe personat të cilët pranojnë ndihmë sociale. Në fund, si faktorë të cilët e zmadhojnë lëndueshmërinë sociale përfshihen edhe personat me nevoja të veçanta të cilët jetojnë në familjet e tyre, si dhe personat me nevoja të veçanta të cilët jetojnë në institucione speciale ose spitale duke pasur parasysh se atyre u nevojitet kujdes i veçantë, sigurim i vazhdueshëm me ilaçe dhe ngjashëm, kurse në kushte të evakuimit për ta nevojitet edhe ndihmë e veçantë. Në popullatën për të cilën nevojitet vëmendje janë përfshirë edhe turistët. E para se ata e rrisin numrin e elementeve të ekspozuara, ndërsa në anën tjetër, ata nuk e njohin vendin në të cilin kanë ardhur, as që e dinë ku të drejtohen në kushte të fatkeqësisë natyrore.

Në Maqedoni vlerësimi i lëndueshmërisë sociale nëpër komuna është përgatitur vetëm për rajonin juglindor për shkak se në Raportin e Parë Nacional dhe në Planin e Dytë Nacional për ndryshime klimatike (MMJPH), ky rajon është veçuar si veçanërisht i lëndueshëm ndaj ndryshimeve klimatike.

Duhet të kihet parasysh se kuantifikimi i këtyre grupeve të identifikuara si të lëndueshme në aspektin shoqëror është shumë i rëndësishëm, por gjithashtu është e rëndësishme edhe mënyra se si çdo faktor ose ndryshore (variabël) ndikojnë ose si të gjithë faktorët ndikojnë njëri mbi tjetrin dhe krijojnë grupe të lëndueshme shoqërore. Grupet e lëndueshme që janë përmendur mund të konsiderohen si

grupe të cilat në mënyrë plotësuese do të jenë të ngarkuara nga rreziqet dhe fatkeqësitë natyrore për shkak të statusit socio-ekonomik, moshës, gjinisë, kushteve të jetës dhe rrethanave të punës ose në familje.

Grupet e lëndueshme të numëruara duhet të perceptohen më shumë si grupe të cilat peshën nga rreziqet dhe katastrofat natyrore do të ngarkohet në peshën sociale që tani ekziston te këto grupe të lëndueshme (për shkak të statusit socio-ekonomik, moshës, gjinisë, kushteve të jetës dhe punës dhe rrethanave familjare) dhe ndikimi tyre i ndërsjellë do të kontribuonte në rritjen e shkallës së lëndueshmërisë.

Indekset e lëndueshmërisë duhet të konsiderohen si të përafërta dhe mund të jenë tregues i nevojës për hulumtime të mëtutjeshme cilësore nga ana e institucioneve kompetente për të përfituar informata më konkrete për lëndueshmërinë socio-ekonomike të hapësirave për të cilat vlejnjë. Vetë indekset (ose indekset me informata të plotësuara) mund të shërbejnë edhe si udhëzues për zhvillim të politikës për reduktim të lëndueshmërisë sociale në rajon dhe të shërbejnë si mjet për matje të progresit drejt atij qëllimi specifik.

3.2.2 Efekte mbi shëndetin

Dëshmitë e reja për pasojat nga ndryshimet klimatike mbi shëndetin e njerëzve tregojnë se ndryshimet klimatike kanë ndikuar në ndryshimin e distribuimit të vektorëve nëpërmjet të cilëve barten disa sëmundje ngjitëse dhe se kanë ndryshuar distribuimin sezonal të disa llojeve të polenit alergjik. Gjithashtu, është rritur numri i rasteve fatale të shkaktuara si pasojë e ndikimeve ekstreme kohore dhe valëve të temperaturave të larta. Problem paraqet edhe ndotja e ajrit, intensiteti i zmadhuar i rrezatimit UV si dhe rritja e pritjes së numrit të njerëzve të cilët do të pësojnë me vdekje ose do të pësojnë me sëmundje dhe lëndime prej vërshimeve, zjarret, rrëshqitjeve të tokës dhe thatësive.

Si grup më i lëndueshëm i njerëzve nga ndikimi klimatik është shtesa më e varfër e popullatës. Zhvillimi ekonomik paraqet komponent të rëndësishëm të përshtatjes, mirëpo rëndësi thelbësore ka mënyra se si do të realizohet rritja ekonomike, shpërndarja e përfitimeve nga ajo rritje, si dhe faktorët që më në mënyrën më të drejtpërdrejtë ndikojnë mbi shëndetin e njerëzve, siç është arsimi, mbrojtja shëndetësore dhe infrastruktura e shëndetësisë publike.

Ndryshimet klimatike janë në lidhje të ndërlidhur me shëndetin. Temperatura ka ndikim të drejtpërdrejt në sëmundjet dhe gjendjet që mund të kenë fundin fatal. Ngjarjet ekstreme të motit, si dhe efektet e ndotjes së ajrit në formë të distribuimit të sporeve dhe mykut, poashtu, kanë ndikim mbi shëndetin e njeriut. Ndikimet tjera i përcjellin rrugët e tërthorta siç janë ato që ndikojnë në distribuimin e sëmundjeve që ndërlidhen me ujin për pije, ushqimin ose për sëmundjet që barten nëpërmjet vektorëve dhe zoonozave, ose gjendje shëndetësore që paraqiten për shkak të mungesës së ushqimit dhe ujit, ose rrezikim të shëndetit dhe jetës nga ngjarjet e vërshimeve, zjarreve dhe fatkeqësive tjera, si rezultat i ndryshimeve klimatike. Në disa dekadat e ardhshme, si pasojë e ndryshimeve klimatike pritet që, në disa nga muajt më të ftohtë të vitit, rënie për disa përqind të mortalitetit të përgjithshëm mesatar në shtet (janar për 4%, tetor për 4%, nëntor për 2%), kurse në pjesën e muajve më të

ngrohtë të vitit pritet rritje prej 4-11% (më së shumti në muajt prill, maj, qershor dhe atë në mesatare për 10% më shumë në raport me periudhën 1996-2000). Në anën tjetër, si pasojë e ndryshimeve klimatike, ndikime të drejtpërdrejta shëndetësore të shkaktuara nga valët e temperaturave të larta mund të jenë problem i madh, veçanërisht në kontekst të rritjes së urbanizimit. Më tepër se 60% e popullatës jeton në qytetet. Sipas skenarëve të paraparë të mortalitetit në vend edhe në Shkup për periudhën pas vitit 2035, shkalla e parashikuar e mortalitetit me ndryshime në temperaturën mesatare mujore prej vetëm 1°C, në krahasim me periudhën 1996-2000, konsiderueshëm do të ndikojë në ndryshimin e shpërndarjes së vdekshmërisë së përgjithshme e paraqitur si mesatare mujore. Kjo rritje e shkallës mujore të vdekshmërisë në vend do të jetë më e lartë në muajt prill, maj, qershor (4-11%), kurse në mesatare 10% në raport me periudhën prill, maj, qershor 1995-2004. Personat me sëmundje kronike, veçanërisht të natyrës kardiovaskulare dhe respiratore, kanë rrezik më të lartë të rritjes së mortalitetit gjatë temperaturave të larta. Posaçërisht është shpeshtuar dukuria e vërshimeve. Pesë vërshime serioze janë regjistruar në periudhën 2003-2009, që kanë shkaktuar dëmtime të shtëpive, rrugëve dhe urave, si dhe të sipërfaqeve bujqësore dhe sistemeve për furnizim me ujë, që tërthorazi mund të krijojë dukurinë e intensitetit të zmadhuar dhe frekuencës së sëmundjeve që barten nëpërmjet ujit dhe ushqimit të ndotur. Këto ndryshime tërthorazi mund të ndikojnë në reduktimin e burimeve të ushqimit dhe ujit për pije, humbjes së vendbanimeve, si dhe zhdukjen e disa specieve të bimëve dhe kafshëve. Efektet klimatike indirekte të prodhimit të ushqimit, furnizimit me ujë dhe epidemive të sëmundjeve që barten nëpërmjet vektorëve mund të përfshijnë edhe ndikimin e ndryshimeve klimatike në shëndetin e njeriut.

Parashikohet që ekspozimi në ndryshimet klimatike të cilat janë të rëndësishme për shëndetin e njeriut do të shpie në:

- Rritje të të ushqyerit të pamjaftueshëm dhe çrregullime të ngjashme, duke përfshirë edhe çrregullime që ndërlidhen me rritjen dhe zhvillimi fëmijor;
- Rritje të numrit të njerëzve të cilët do të pësojnë me vdekje ose do të sëmuren dhe lëndohen nga temperaturat e larta, vërshimet, stuhitë, zjarret dhe thatësitat;
- Ndryshim i vëllimit të vektorëve nëpërmjet të cilëve barten sëmundje të caktuara ngjitëse;
- Rritje të morbiditetit kardio-respirator dhe mortalitetit që ndërlidhen me ozonin e troposferës;
- Efekte të caktuara pozitive për shëndetin (numër më i ulët i vdekjeve të shkaktuara nga i ftohti), edhe pse pritet që ato efekte të jenë shumë më të pakta se sa efektet negative si pasojë e temperaturave në rritje anembanë botës veçanërisht në shtetet në zhvillim.

Bashkësitë e varfra, pa mbrojtje dhe përkrahje të mirë të mbrojtjes shëndetësore nga sektori social janë më të ekspozuara ndaj efekteve të pavolitshme mbi shëndetin që ndodhin për shkak të klimës dhe ndryshimeve tjera në mjedisin jetësor. Vlerësimi i rreziqeve shëndetësore ende nuk është mjaft efikas për shkak se informatat ekzistuese për ndryshimet klimatike në nivel rajonal dhe nacional dhe për ekspozimin e njerëzve nuk janë të përshtatshme, si dhe kompleksiteti i ndërveprimeve gjatë ekspozimit multimedial dhe të shumëfishtë të më shumë rreziqeve që veprojnë bashkërisht. Vlerësimi i rreziqeve për shëndetin e njerëzve nga ndryshimet klimatike në mënyrë plotësuese ndërlidhet për shkak të ekzistimit të grupeve të lëndueshme të njerëzve, siç janë fëmijët, njerëzit me sëmundje kronike, personat e moshuar, femrat shtatzëne, predispozitat gjenetike, cilësia

e dobët e të ushqyerit, kushtet e këqija socio-ekonomike për jetë etj. Lokacioni dhe madhësia e atyre grupeve zakonisht është vështirë të përcaktohet. Identifikimi i qartë i këtyre grupeve dhe shkalla e nevojshme e mbrojtjes shëndetësore shtesë për të njëjtat, do të bëhet aktivitet prioritar në politikat e dy sektorëve ekzistues – Ministria e shëndetësisë dhe Ministrisë për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor.

Në përputhje me Strategjinë për përshtatje të sektorit shëndetësor ndaj ndryshimeve klimatike në Republikën e Maqedonisë me Plan aksionar 2011-2015, më vitin 2011 dhe në bazë të analizës së gjendjes së shkaktuar nga ndryshimet klimatike në Republikën e Maqedonisë përkufizohen sferat prioritare të veprimit si në vijim:

1. Rritja e vetëdijes te njerëzit për ndryshimet klimatike dhe ndikimi i tyre mbi shëndetin në Republikën e Maqedonisë;

2. Identifikim, regjistrim dhe përcjellje të rreziqeve që ndërlidhen me ndryshimet klimatike dhe ndikimi i tyre mbi shëndetin e njerëzve;

3. Avancim i sistemit shëndetësor në promovimin, parandalimin dhe reagimin me kohë për ballafaqim me rreziqet për shëndetin e njerëzve nga ndryshimet klimatike;

Një prej mënyrave për përshtatje dhe reduktim të nivelit të lëndueshmërisë nga ndryshimet klimatike në sektorin klimatik është fuqizimi i institucioneve publike; ndërtim të sistemeve shëndetësore të cilat do të funksionojnë në nivel të duhur, qëndrimi korrekt i njerëzve dhe sigurim të mbrojtjes universale primare shëndetësore; sigurim të arsimit përkatës, krijim të kërkesës për shërbime më të mira dhe më të arritshme, si dhe kuadër përkatës për përmbushjen e nevojave. Infrastruktura e sistemit shëndetësor duhet të jetë fleksibile ndaj dukurive ekstreme dhe nevojiten trajnime përkatëse të punonjësve shëndetësor që këta t'i kuptojnë kërcënimet nga ndryshimet klimatike. Nevojitet përshtatje me qëllim që të zvogëlohet lëndueshmëria nga ndryshimet klimatike që tanimë është realitet dhe përshtatje plotësuese që do t'iu përgjigjet rreziqeve për shëndetin që janë paraparë për dekadat e ardhshme. Nevojitet avancim i kapaciteteve të përshtatje në gjithë sektorët dhe të gjitha nivelet

4. KORNIZA JURIDIKE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Edhe pse përparimi në sektorin e mjedisit jetësor është mjaft i ngadalshëm, Maqedonia ka miratuar disa ligje gjatë viteve me të cilat rregullohen sfera të ndryshme siç janë mjedisi jetësor, mbrojtja e tij, menaxhimi me mbeturina, cilësia e ajrit, ujërave, zhurma dhe tjera. Maqedonia, gjithashtu, ka miratuar disa strategji dhe plane aksionare lidhur me disa tema të rëndësishme siç janë menaxhimi me mbeturinat, zhvillimi i qëndrueshëm, investimet në mjedisin jetësor etj.

Rregullore ligjore, strategji dhe plane aksionare në të cilat shqyrtohen çështjet nga sfera e mjedisit jetësor janë:

- Ligji për mjedis jetësor ("G. Zyrtare e RM-së" nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 44/15, 129/15 dhe 192/15);
- Ligji për cilësi të ajrit ambiental ("G. Zyrtare e RM-së" nr. 67/04, 92/07, 35/10, 47/11, 163/13 dhe 100/12);
- Ligji për mbrojtjen e natyrës ("G. Zyrtare e RM-së" nr. 67/04, 14/06, 84/07, 35/10, 47/11, 148/11, 59/12, 13/13 dhe 163/13);
- Ligji për mbrojtje nga zhurma në mjedisin jetësor ("G. Zyrtare e RM-së" nr. 79/07 dhe 163/13);
- Ligji për menaxhim me mbeturinat ("G. Zyrtare e RM-së" nr. 68/04, 71/04, 107/07, 102/08, 134/08, 09/11, 123/12, 147/13 dhe 163/13);
- Ligji për bateri dhe akumulatorë dhe bateri dhe akumulatorë mbeturina ("G. Zyrtare e RM-së" nr. 140/10, 47/11, 148/11, 39/12 dhe 163/13);
- Ligji për menaxhim me paketim dhe mbeturinat nga paketimet ("G. Zyrtare e RM-së" nr. 161/09, 17/11, 47/11, 136/11, 6/12 dhe 163/13);
- Ligji për menaxhim me pajisje elektrike dhe elektronike ("G. Zyrtare e RM-së" nr. 6/12 dhe 163/13);
- Ligji për ujërat ("G. Zyrtare e RM-së" nr. 87/08, 6/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 23/13 dhe 163/12);
- Ligji për kimikatet ("G. Zyrtare e RM-së" nr. 113/07);
- Raporti i Tretë Nacional ndaj Konventës Kornizë të KB-ve për ndryshime klimatike, 2014;
- Strategjia Nationale për menaxhim me mbeturina (2008-2020);
- Plani nacional për menaxhim me mbeturina (2009-2015);
- Strategji Nationale për zhvillim të qëndrueshëm (2009-2030);
- Plan nacional për mbrojtje të ajrit ambiental (2013-2018);
- Strategji për zhvillim të energjetikës në Republikën e Maqedonisë (2998-2020) me vizion deri më vitin 2030;
- Plan i Dytë Nacional Ekologjik i Republikës së Maqedonisë;
- Strategji Nationale për ujëra (2011-2041);
- Strategji për monitorim në mjedisin jetësor, 2004;
- Strategji për ngritje të vetëdijes së publikut për mjedisin jetësor;
- Strategji për komunikim në mjedisin jetësor;
- Strategji Nationale për përafrim në mjedisin jetësor;
- Strategji Nationale për mekanizmin për zhvillim të pastër për periudhën e parë të obligimeve 2008-2012 sipas Protokollit të Kjotos;
- Strategji për menaxhim me të dhëna për mjedisin jetësor;
- Strategji Nationale për investime në mjedisin jetësor;

4.1 Prioritete për miratim të legjislacionit të BE-së për mjedis jetësor

Në përputhje me Programin Nacional për miratim të legjislacionit të Bashkimit Evropian, në vitin 2014 janë përkufizuar prioritete afatshkurta dhe afatmesme për mediet dhe sferat në mjedisin jetësor.

Prioritete afatshkurta:

- Përgatitje e Strategjisë Nationale për mjedis jetësor dhe ndryshime klimatike, qëllimi i të cilës është të propozohen aktivitete për fuqizimin e kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal për zbatim të legjislacionit nga sfera e mjedisit jetësor, harmonizim me kërkesat e legjislacionit të BE-së si dhe avancim të zbatimit të legjislacionit në mjedisin jetësor;
- Miratim të Planit Nacional për ballafaqim me shkretëzimin dhe zbutjen e efekteve nga thatësitat;
- Përgatitje e Planit për mbikëqyrje administrative të punës së njësive të vetëqeverisjes lokale dhe realizimin e të njëjtit;
- Përgatitje e akteve nënligjore në pjesën e sistemit nacional për inventarizim të gazrave të serrave, si dhe përgatitje të skenarëve për zbutjen e ndryshimeve klimatike;
- Fillim të projektit “Fuqizim të kapaciteteve në nivel lokal për zbatim të legjislacionit nga sfera e mjedisit jetësor”;
- Azhurnim dhe plotësim të Statistikave për mjedis jetësor për vitin 2015;
- Në suazat e projektit “Të di tani në këtë moment” formim të grupit punues për Regjistër të shkarkimit dhe bartjes së ndotësve (RLEN), në të cilin do të përfshihen përfaqësues të sektorit të OJQ-ve dhe industrisë;
- Realizim të sferatave për ngritje të vetëdijes publike në mjedisin jetësor, si dhe stimulim të studimeve, programeve dhe projekteve arsimore, hulumtuese e zhvillimore për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor dhe natyrës;
- Miratim të dispozitave nacionale, me të cilat do të transponohet masa e BE-së 32013R0525 dhe atë:
 - Listë e subjekteve që posedojnë të dhëna për emisione antropogjenike të gazrave të serrave në atmosferë, nëpër burime dhe ujërave nëntokësore;
 - Urdhëresë për formën, përmbajtjen, mënyrën e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të inventarizimit të gazrave të serrave;
- Hulumtim për informimin e publikut për ndryshimet klimatike;
- Përgatitje e ndryshimeve dhe plotësimeve të akteve nënligjore ekzistuese:
 - Rregullore për ndryshime dhe plotësime të Rregullores për metodologjinë, mënyrat, procedurat, metodat dhe mjetet për matje të emisioneve nga burimet stacionare në përputhje me CEN dhe ISO standardet;
 - Rregullore për ndryshime dhe plotësime të Rregullores për metodologjinë inventarizim dhe përcaktim të niveleve të substancave ndotëse në atmosferën në tonelata për nivel vjetor për të gjitha llojet e veprimtarive si dhe të dhëna të tjera për përcaktimin e programit për monitorim të ajrit në Evropë (EMEP) në përputhje me Konventën dhe Protokollin ndaj Konventës për ndotje larg-përfshirëse tejkufitare të ajrit nga viti 1979 për financim afatgjatë të Programit për

bashkëpunim për monitorim dhe vlerësim të emisionit larg-përfshirës të substancave ndotëse në ajër në Evropë (EMEP);

- Përgatitje të Programit për punë të Sistemit Automatik Monitorues Shtetëror për cilësi të ajrit ambiental për vitin 2015. Në këtë periudhë do të sigurohet fuqizim i kapaciteteve të organeve të cilat zbatojnë mbikëqyrje të ajrit nëpërmjet punësimit të kuadrit të ri dhe realizimit të trajnimeve. Planifikohet të sigurohen parakushte për fillim të akreditimit të Laboratorit për kalibrim, përkatësisht të merren gazra standarde referente dhe të bëhet kalibrim i pajisjes së caktuar në laborator të akredituar jashtë shtetit;
- Përgatitje e Planit aksionar afatshkurtër për mbrojtje të ajrit ambiental për Qytetin e Shkupit dhe fillim të përgatitjes së Planit për cilësi të ajrit për Qytetin e Shkupit. Përgatitja e këtyre dokumenteve të planifikimit parashikohet në suazat e projektit të binjakëzuar për ajër në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit;
- Fillimi i realizimit të Projektit të binjakëzimit (tuning) “Fuqizim i mëtutjeshëm i kapaciteteve për implementim efektiv të legjislacionit nga sfera e cilësisë së ajrit”. Në suazat e projektit do të fillojë edhe revizioni i “Programit Nacional për reduktim gradual të emisioneve deri më vitin 2020”, si dhe përgatitje e “Vlerësimit të cilësisë së ajrit për Republikën e Maqedonisë për periudhën 2010-2014;
- Në suazat e sferatave të rregullta të cilat i realizon MMJPH, do të përfshihen edhe aktivitete të cilat do të jenë të përqendruara në vetëdijësimin e publikut për avancimin e cilësisë së ajrit ambiental, nëpërmjet përgatitjes së broshurave dhe materialeve promovuese për cilësi të ajrit;
- Përgatitje të Rregullores për llojet e mbeturinave, kushteve për eksport, import dhe transit të mbeturinave, llojeve të ndryshme të mbeturinave, metodave të mbikëqyrjes mbi eksportin, importin dhe transitin e mbeturinave, si dhe formën e përmbajtja e formularit të lejes për eksport, import dhe transit të mbeturinave me të cilat do të transponohet BE masa 32006R1013;
- Revizion të Strategjisë për menaxhim me mbeturina 2008-2020;
- Përgatitje të dokumenteve të nevojshme për themelim të sistemit të integruar dhe financiar automatik të vetë-qëndrueshëm për menaxhim me mbeturina në rajonin Lindor dhe atë Verilindor, rajonin e Vardarit, Pellagonisë, Shkupit dhe rajonin Jugperëndimor”, në suazat e IPA komponentit 3 – Masa 3.2 nga Programi Operativ për zhvillim rajonal (POZhR) 2007-2009;
- Themelim të sistemit për menaxhim me mbeturina mjekësore në nivel qendror për realizimin e të cilit kompetentë janë Ministria për mjedis jetësor e planifikim hapësinor dhe Ministria e shëndetësisë;
- Miratim të “Ligjit për ratifikim të Konventës për mbrojtje dhe shfrytëzim të ujërave tejkufitare dhe liqeneve ndërkombëtare”, si dhe do të vazhdojë miratimi i akteve nënligjore që rezultojnë nga “Ligjit për ujërat” me çka do të sigurohet harmonizim i mëtutjeshëm me aktet përkatëse juridike të BE-së në sferën e ujërave;
- Do të vazhdojë zbatimi i Projektit “Fuqizim i kapaciteteve institucionale për përafrim dhe zbatim të legjislacionit në sferën e menaxhimit me ujërat” – IPA 2009 Komponenti 1. Me këtë projekt do të themelohet regjistër për zona të mbrojtura për pellgun e lumit Drini i Zi. Vazhdim i aktiviteteve të parapara për përpunimin e Planit për menaxhim me pellgun e Lumit Vardar, Plan për menaxhim me pellgun e lumit Strumica. Do të themelohet trup rajonal për përcaktimin e çmimit të ujit në Republikën e Maqedonisë, nëpërmjet miratimit të ligjit të veçantë;

- Realizim i projektit Zhvillim i Studimit Nacional për menaxhim me ujëra, të financuar nga IPA nëpërmjet Komponentit 3. Me këtë projekt do të përgatiten plane specifike për zbatim të direktivave për trajtim të ujërave të zeza dhe për ujin për pije, do të zhvillohet plan për menaxhim me llum, si dhe do të përkufizohen aglomeratet dhe zonat e ndjeshme për ujëra të zeza urbane;
- Realizim i analizës dhe vlerësimit të gjendjes me diversitetin biologjik në RM;
- Përgatitje e Strategjisë Nationale të re për llojshmëri biologjike me Plan Aksionar;
- Realizim i trajnimeve për ngritje të vetëdijes publike për rëndësinë e rritit ekologjik Natura 2000 dhe për zbatim të masave të BE-së nga sfera e mbrojtjes së natyrës;
- Në suazat e projektit të binjakëzimit nga IPA Komponenti 1 për TAIB2011 fillim të aktiviteteve për miratim të “Ligjit për kontroll të emisioneve nga industria” që do të transponojë Direktivën e re të BE-së për ndotje industriale, gjegjësisht do të përgatitet analizë e dallimeve për shkallën e harmonizimit me legjislacionin nacional;
- Revidim të Dokumenteve Nationale Referente (udhëzime) për NDT për naftë dhe gaz mineral, për farkëtarë dhe shkretore, për menaxhim me mbeturina dhe mbeturina nga xehet dhe për impiante të mëdha të djegies. Në sferën e parandalimit dhe kontrollit të avarive ka prani të substancave të rrezikshme, miratim të ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për substancat e rrezikshme, vlerat kufitare (pragjet) për prezencë të substancave të rrezikshme dhe kritereve ose cilësive sipas të cilave substanca klasifikohet si rrezikshme, me çka do të harmonizohet rregullorja ekzistuese e Aneksit I me CECECI III Direktiva 32012L0018;
- Në pjesën e fatkeqësive industriale baza ekzistuese e të dhënave do të përshtatet me kërkesat për Regjistër të sistemeve në të cilat janë të pranishme substanca të rrezikshme në përputhje me Nenin 152 të Ligjit për mjedis jetësor;
- Në sferën e menaxhimit me substancat që varfërojnë shtresën e ozonit, miratim të akteve nënligjore në vijim të cilat harmonizohen me masën e BE-së 32009R1005:
 - Rregullore për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e parashtrimit të raportit vjetor për llojet dhe sasinë e substancave të grumbulluara, ripërtëritura dhe të ricikluara, si dhe me produkte që përmbajnë substanca të cilat e varfërojnë mbështjellësin e ozonit;
 - Rregullore për formën, përmbajtjen e certifikatës për trajnim të mbaruar për punë me substanca që varfërojnë mbështjellësin e ozonit dhe/ose me prodhime që përmbajnë substanca të cilat varfërojnë mbështjellësin e ozonit;
 - Ndryshim dhe plotësim të Rregullores për mënyrën e grumbullimit, ripërtëritjes dhe riciklimit të substancave që e varfërojnë mbështjellësin e ozonit;
- Për qëllimet e këmbimit të të dhënave dhe menaxhim të integruar me kimikate në Byronë për barëra do të themelohet Regjistri Integral për kimikate të lëshuara në qarkullim. Sistemi i informimit i të gjitha palëve të interesuara në pjesën e menaxhimit me kimikatet nëpërmjet mbajtjes së ngjarjeve edukative do të vazhdojë të zbatohet si mënyrë e domosdoshme dhe e qëndrueshme e këmbimit të informatave;
- Miratim i aktit nënligjor për llojet më të afërta të burimeve të veçanta të zhurmës, si dhe kushtet për mbrojtje nga zhurma që shkaktohet nga komunikacioni rrugor, hekurudhor, ajror dhe ujor, me të cilat do të bëhet transponim i këtyre masave të BE-së: 31984L0372, 31989L0629 dhe 31998L0020. Me miratimin e kësaj rregulloreje do të rregullohet kontrollimi i zhurmës që buron nga komunikacioni rrugor, hekurudhor dhe ujor dhe do të përcaktohen standardet për mbrojtje

nga zhurma në mjedisin jetësor që shkaktohet nga këto burime të zhurmës;

- Përpunim i Doracakut për përgatitje të hartave strategjike për zhurmë që do të lehtësojë procesin e përgatitjes së këtyre hartave strategjike;
- Blerje e pajisjes që ka të bëjë me blerjen e instrumenteve për matje të zhurmës në mjedisin jetësor me të cilat do të mundësohet vendosje e monitorimit të zhurmës, si dhe integrim të të dhënave për përgatitje të hartës strategjike për zhurmë.

Prioritete afatmesme:


- Përgatitje e Ligjit për inspekcion në mjedisin jetësor dhe Ligjit për ndryshime klimatike;
- Përpunim të strategjisë afatgjatë dhe “Ligjit për aksion klimatik” në periudhën 2016-2018;
- Përgatitje e zgjidhjes softuerike për informim për emisionet e gazrave të serrave nga industria që do të mbështetet edhe juridikisht me akt nënligjor në të cilin do të inkorporohen dispozita të rregullores për mekanizmin për përcjellje që rezultojnë nga “Ligji për mjedis jetësor” në pjesën e saktësisht shtesë të dispozitës për Sistemin Nacional për inventarizim të emisioneve të gazrave të serrave;
- Përpunim i Statistikave për mjedis jetësor dhe Indikatorë për mjedis jetësor për vitin 2016.;
- Përgatitje e Programit për vetëdijësim publik;
- Mbindërtim dhe azhurnim të Regjistrit të themeluar për shkarkim dhe emision të ndotësve dhe internet portalit të RLEN;
- Realizim të projekteve të NjVL-ve për ndërtim të objekteve infrastrukturore në sferën e mbeturinave dhe ujërave, si dhe në sfera të tjera të financuara nëpërmjet programeve vjetore për investim në mjedisin jetësor, nëpërmjet buxhetit të MMJPH-së dhe MTL-së, si dhe nëpërmjet fondeve të BE-së e mjeteve tjera bilaterale dhe multilaterale;
- Mbindërtim të Rrjetit Shtetëror për përcjellje të medieve dhe sferave në mjedisin jetësor;
- Përgatitje të propozimeve për përpunim të Raportit të Dytë të azhurnuar dyvjeçar për ndryshime klimatike;
- Vlerësim të nevojave për teknologji për ballafaqim më të lehtë me ndryshimet klimatike dhe Planit të Katërt Nacional për ndryshime klimatike që janë obligime në përputhje me kërkesat e Konventës Kornizë për ndryshime klimatike të Kombeve të Bashkuara (UNFCCC);
- Miratim të Rregullores për ndryshime dhe plotësime të Rregullores për vlera kufitare për nivele të lejuara të emisioneve dhe llojeve të substancave ndotëse në gazrat dhe avujt e shkarkuara që emitojnë burimet stacionare në ajër;
- Në përputhje me dokumentet e miratuara të planifikimit në sferën e ajrit (Plan Nacional për mbrojtje të ajrit ambiental, Program Nacional për reduktim të emisioneve në ajër dhe planet për cilësi të ajrit janë përgatitur nga NjVL-të), do të sigurohet fuqizim institucional i DMJ-së me qëllim të përcjelljes së implementimit të njëjtave;
- Përgatitja e katër planeve rajonale për menaxhim me mbeturina për rajonin e Vardarit, Pellagonisë, Shkupit dhe atij Jugperëndimor dhe realizim i vlerësimit strategjik të të njëjtave;
- Realizim të punëtorive për fuqizim të kapaciteteve të Inspektoratit Shtetëror për mjedis jetësor, inspektorët e autorizuar për mjedis jetësor dhe inspektorati shtetëror i tregut në pjesën e mbikëqyrjes së ligjeve të veçanta për menaxhim me mbeturina. Poashtu, do të realizohen

punëtori për sektorët e interesuar në pjesën e obligimeve ligjore që rezultojnë nga Ligji për menaxhim me mbeturina nga pajisje elektrike dhe elektronike dhe Ligjit për menaxhim me bateri dhe akumulatorë dhe mbeturina nga bateritë dhe akumulatorët;

- Përpunim të Planeve për menaxhim me pellgun e lumit Vardar, Plan për menaxhim me pellgun e lumit Drini i Zi dhe Plan për menaxhim me pellgun e lumit Strumica;
- Në suazat e Projektit “Asistencë teknike për përgatitje të Studimit Nacional për ujëra” do të përkufizohen aglomerate dhe zona të ndjeshme ndaj ujërave të zeza urbane;
- Kah mesi i vitit 2017 pritet të përfundohet me ndërtimin e pikave të pastrimit për qytetet Strumicë, Radovish dhe Kërçovë, si dhe zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit për Berovë dhe Kumanovë, në suazat e IPA Komponentit 3.;
- Përpunim të dokumentacionit teknik për ndërtim të stacioneve për trajtim dhe pastrim të ujit dhe zgjerim të rrjetit të kanalizimit për qytetet Kavadarci, Manastir, Tetovë, Gostivar, Dibër, Shtip dhe Veles;
- Rrumbullakim i projektit “Fuqizim i kapaciteteve institucionale për përafrim dhe zbatim të regjistrit për zona të mbrojtura për pellgun e lumit Vardar dhe do të përpilohet propozim-program për përcjellje të ujërave të pellgut të Lumit Vardar;
- Miratim të ndryshimeve dhe plotësimeve të “Ligjit për mbrojtje të natyrës”, me qëllim të harmonizimit me direktivat e BE-së për habitate dhe zogj;
- Përcaktim të Rrjetit Nacional Ekologjik në përbërjen e të cilës përfshihen zonat e rëndësishme ekologjike, sistemi i korridoreve ekologjike, sistemi i zonave të mbrojtura dhe zona të propozuara për mbrojtje dhe zonat me vlerë ekologjike për BE – Natura 2000 me ç’rast do të transponohen masat e BE-së 32009L0147, 31992L0043 dhe 31997D0266;
- Përgatitje të akteve nënligjore me të cilat do të përcaktohen llojet e vendbanimeve, duke përfshirë llojin dhe shkallën e rrezikimit dhe rëndësisë së tyre, si dhe mënyrën e shënimit të tyre, mënyrës së përgatitjes, mirëmbajtjes dhe shënimit të llojeve të vendbanimeve në hartë, mënyrën e përcaktimit të shkallës së kërcënimit, mënyrës së vlerësimit të gjendjes dhe kërcënimi për llojet e vendbanimeve, si dhe lloje të vendbanimeve për ruajtjen e të cilave medoemos duhet të përcaktohen zona të veçanta për ruajtje dhe masat për ruajtje e llojeve të habitateve në gjendje të volitshme;
- Përgatitje të Listës së Kuqe për së paku një grup traksonomik;
- Realizim i trajnimeve për vetëdijesim publik për rëndësinë e Rrjetit Evropian Ekologjik Natura 2000 dhe për zbatimin e BE-masave nga sfera e mbrojtjes së natyrës;
- Në suazat e (tuining) projektit për binjakëzim nga IPA komponenti 1 për TAIB 2011 miratim të Ligjit për kontroll të emisioneve nga industria që do ta transponojë këtë direktivë të re;
- Në sferën e parandalimit dhe kontrollit të avarive me prezencë të substancave të rrezikshme miratim të Rregullores për kriteret më të afërta në bazë të të cilave përcaktohet në cilat raste konsiderohet se një fatkeqësi është avari me çka do të transponohen dispozita të CEBECO II Direktiva (31996L0082 dhe 32003L0105). Do të vazhdojë përpunimi dhe revidimi i dokumenteve (udhëzimeve) nacionale referente për NDT në licencat e integruara ekologjike të A-kategorisë për çdo sektor industrial në veçanti;
- Në këtë periudhë do të vazhdojë transponimi i masave të BE-së në legjisllacionin nacional në pjesën e kimikateve me ç’rast është planifikuar të miratohet akt nënligjor me të cilin do të

përcaktohen kategoritë e licencave për trajtim të mjeteve për ftohje masa e BE-së 32014R0517;

- Deri në fund të vitit 2016 dhe më vitin 2017 do të fillojnë aktivitete për themelimi të SIP (GIS) të të dhënave nga monitorimi i zhurmës në mjedisin jetësor me qëllim të zbatimit të plotë të kërkesave në BE Direktivën për themelimi të Infrastrukturës për informim hapësinor në BE (INSPIRE). Direktiva siguron kornizë ligjore për implementim të të dhënave infrastrukturore hapësinore Evropiane dhe do të jetë një prej komponentëve kryesorë të Sistemit Evropian Informativ për mjedis jetësor (SEEIS);
- Deri kah fundi i vitit 2016 do të zbatohen aktivitete në lidhje me përpunimin e hartave strategjike për zhurmë dhe planeve aksionare për zhurmë, me çka do të fitohet pasqyrë e plotë për nivelin e zhurmës në mjedisin jetësor, si dhe masat të cilat do të ndërmerren me qëllim të reduktimit të nivelit të zhurmës kurse me këtë edhe reduktim të efekteve të dëmshme që rezultojnë nga e njëjta. Në këtë periudhë do të fillojnë aktivitete për themelimin e sistemit informativ për gjendjen e zhurmës në mjedisin jetësor, si pjesë e sistemit të përgjithshëm informativ për mjedis jetësor në Republikën e Maqedonisë, që i përfshin të dhënat e pranuar nga monitorimi i zhurmës, Përgatitje të hartave strategjike dhe planeve aksionare dhe të dhënave tjera përkatëse të fituara me matje të zhurmës të çdo rasti veç-veç. Do të fillojnë aktivitete për themelimi dhe mbajtje të kadastrës së krijuesve të zhurmës në mjedisin jetësor.



5. GJENDJA DHE BAZA PËR FINANCIM TË AKTIVITETEVE NGA SFERA E MBROJTJES SË MJEDISIT JETËSOR

5.1 Baza për financim të aktiviteve në sferën e mjedisit jetësor

Sipas kreut XVIII¹¹ të Ligjit për mjedis jetësor mjete për financim të aktiviteve për stimulum, ruajtje, shfrytëzim të qëndrueshëm, mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor, si dhe për përgatitje, zbatim dhe zhvillim të programeve dhe projekteve për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor, sigurohen nga kompensimi të cilin e paguajnë personat juridikë dhe fizikë të cilët:

- kanë burime që ndotin mjedisin jetësor;
- e ndotin mjedisin jetësor me përdorimin e produkteve dhe substancave;
- janë shfrytëzues të pasurive natyrore;
- e ngarkojnë mjedisin jetësor me mbeturina;
- importojnë produkte të caktuara të shfrytëzuara në Republikën e Maqedonisë dhe
- prodhojnë ose importojnë prodhime dhe mallra të cilat janë të dëmshme ose përmbajnë materie të dëmshme për mjedisin jetësor dhe natyrën

dhe nga mjetet prej :

- Buxhetit të Republikës së Maqedonisë;
- mjeteve të realizuara në bazë bashkëpunimi ndërnacional të programeve dhe projekteve;
- donacioneve nga personat juridikë dhe fizikë, të vendit dhe të huaj;
- fondacione dhe dhurata dhe burime tjera.

5.2 Kompensime dhe të ardhura nga kompensimet

Kompensimet për import dhe eksport, kompensimet për prerje të drurit, kompensimet për menaxhim me mbeturina, kompensimet për derivate të naftës dhe kompensimi për prodhimtarinë e energjisë nga lëndët djegëse fosilore janë të ardhura të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe paguhet në llogari përkatëse, në suaza të llogarisë së thesarit.

Mjetet nga kompensimet për mjete motorike dhe objekte lundrimi janë të ardhura të organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor dhe ato paguhet në llogari përkatëse, në suazat e llogarisë së thesarit.

Sipas Nenit 163 të Ligjit, obligues për pagesë të kompensimeve janë persona juridikë dhe fizikë të cilët:

- 1) kanë burime që kryejnë ndotje dhe me veprimin e tyre, tërthorazi ose drejtpërdrejtë, shkaktojnë ndotje të mjedisit jetësor ose janë përgjegjës për emision të gazrave në mjedisin jetësor, në aspekt të Kadastrit për mjedisin jetësor dhe Regjistrin e materieve dhe substancave ndotëse dhe karakteristikave të tyre, si dhe në aspekt të ligjeve të veçanta dhe marrëveshjeve ndërnacionale të cilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë;
- 2) e ndotin mjedisin jetësor me përdorimin e mjeteve motorike dhe objekteve lundruese; me

¹¹ **Financimi**- Ligji për mjedisin jetësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15)

prodhim ose import të derivateve të naftës dhe me import të substancave që varfërojnë mbështjellësin e ozonit;

- 3) janë shfrytëzues të pasurive natyrore duke përdorur pyjet me prerje të drurit; grumbullim dhe eksport të bimëve dhe pjesëve të bimëve, degëve dhe pjesëve tjera të bimëve dhe grumbullim dhe eksport të butakëve (molusqeve) me guaska ose pa guaska;
- 4) e ngarkojnë mjedisin jetësor me mbeturina nëpërmjet krijimit të mbeturinave të parrezikshme industriale me veprimtarinë e tyre ose prodhim të mbeturinave të rrezikshme; prodhime të plastmasës dhe ambalazhe të plastmasës; importim të mbeturinave dhe skrapeve prej plumbi, hiri dhe mbeturina, skrap që kryesisht përmbajnë plumb, mbeturina dhe skrap nga qelizat primare, bateri primare dhe akumulatorë elektrik dhe mbeturina dhe skrap që përmbajnë plumb dhe prodhim dhe import të skrapeve nga nafta ose vajrat dhe mbeturina të vajrave;
- 5) importojnë prodhime të përdorura, dhe atë automjete të përdorura dhe mjete tjera motorike të përdorura, mjete motorike për transport të mallrave; mallra teknike, frigoriferë, pajisje tjera për ftohje dhe ngrirje, goma të mbrojtura dhe të përdorura; magnetofona dhe aparate tjera për inçizim të zërit, aparate pranimit (receptivi) për televizion, video-monitorë dhe video-projektorë dhe
- 6) prodhojnë ose importojnë prodhime dhe mallra të cilat janë të dëmshme ose përmbajnë materiale të dëmshme për mjedisin jetësor dhe natyrën.

5.2.1 Baza për përcaktim të shumës së kompensimit

Shuma e kompensimit të cilën e paguajnë personat juridikë dhe fizikë të cilët kanë burime që shkaktojnë ndotje përcaktohet sipas: sasisë, llojit dhe vëllimit të ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe të emisionit të materieve ndotëse, të nxehtësisë, zhurmës, vibracioneve, dritës, rrezatimit jonizues dhe ajonizues në mjedisin jetësor dhe mënyrës së trajtimit të mbeturinave dhe materieve të mbetura, prodhime ose sende, të cilat drejtpërdrejtë ose tërthorazi pas përdorimit vijnë në kontakt me mjedisin jetësor, ose aktivitete tjera ose dukuri të cilat janë të pavolitshme për mjedisin jetësor.

Shuma e kompensimit të cilën e paguajnë personat juridikë ose fizikë të cilët e ndotin mjedisin jetësor përcaktohet sipas:

- asaj nëse mjetet motorike dhe objektet lundruese kanë ose nuk kanë katalizator, përkatësisht në bazë të lartësisë së sigurimit bazik,
- llojit dhe sasisë së derivateve të prodhuara ose të importuara të naftës dhe
- llojit dhe sasisë së substancave të importuara që varfërojnë mbështjellësin e ozonit.

Shuma e kompensimit të cilën e paguajnë personat juridik dhe fizik shfrytëzues të pasurive natyrore përcaktohet sipas sasisë së drunjve të prerë, llojit dhe sasisë së bimëve dhe pjesëve të bimëve, degë dhe pjesë tjera të bimëve që grumbullohen ose eksportohen dhe sasinë e butakëve me guaska ose pa guaska që grumbullohen ose eksportohen.

Shuma e kompensimit të cilën e paguajnë personat juridikë ose fizikë të cilët ngarkojnë mjedisin jetësor me mbeturina përcaktohet sipas:

- sasisë mbeturinës industriale të krijuar të parrezikshme, llojit dhe sasisë së mbeturinës së rrezikshme të krijuar,

- sasisë së prodhimeve të përdorura të importuara,
- llojit dhe sasisë së prodhimeve të importuara dhe prodhimet e prodhuara të plastmasës dhe ambalazheve prej plastmasës,
- llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe skrapeve të plumbit, hirit dhe skrapve që kryesisht përmbajnë plumb, mbeturina dhe skrap nga celulat e harxhuara primare, bateritë primare dhe akumulatorët elektrik që importohen dhe mbeturina dhe skrap që përmban plumb e të cilat importohen dhe
- llojit dhe sasisë së skrapeve të naftës, vajrave dhe vajrave të mbetura që importohen ose krijohen.

Shuma e kompensimit të cilin e paguajnë personat juridikë ose fizikë të cilët importojnë prodhime të përdorura përcaktohet sipas:

- vëllimit dhe fuqisë së punës së motorit të mjetit, përkatësisht lartësisë së bruto masës së mjetit,
- llojit, sasisë dhe vëllimit të mallit teknik të përdorur që importohet: frigoriferë, ngrirës dhe aparate tjera për ftohje dhe ngrirje, magnetofona dhe aparate tjera për inçizim të zërit, aparate receptive për televizion, video-monitorë dhe video-projektorë dhe
- sasisë së gomave të përdorura ose të mbrojtura që importohen.

Shuma e kompensimit të cilin e paguajnë personat juridikë ose fizikë të cilët prodhojnë ose importojnë prodhime dhe mallra që janë të dëmshme ose përmbajnë materie të dëmshme për mjedisin jetësor përcaktohet sipas çmimit, përkatësisht vlerës doganore të prodhimit, mallit dhe sasisë dhe shkallës së efektit të dëmshëm ose ndikimin negativ mbi mjedisin jetësor.

Baza për lirim nga pagesa e kompensimit

Në bazë të **Nenit 165** të Ligjit për mjedisin jetësor personat juridikë dhe fizikë të cilët prodhojnë mbeturina industriale të parrezikshme, në lartësi të kompensimit për sasinë dhe llojin e hedhurinës që është dërguar në, përkatësisht përpunuar nga persona juridikë dhe fizikë të cilët posedojnë leje për përpunim të mbeturinave, personi i obliguar për të paguar kompensimin mund të parashtrojë kërkesë për çlirim nga pagesa e kompensimit deri te organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor të parashtrojë kërkesë për lirim nga obligimi për të paguar kompensim në nivel të sasisë së mbeturinave që i kanë dorëzuar. Poashtu nga pagesa e kompensimit lirohen personat juridikë dhe fizikë të cilët kanë eksportuar mbeturina, mbeturina dhe skrap nga Republika e Maqedonisë, në lartësi të kompensimit që do të ishte paguar për sasinë dhe llojin e mbeturinave dhe skrapit të eksportuar për të cilat paguhet kompensim (personi i obliguar për të bërë pagesë të kompensimit mund të parashtrojë kërkesë për kthim të kompensimit për sasinë të cilën e ka eksportuar, përkatësisht për sasinë e mbeturinave që është eksportuar për shkak të përpunimit ose riciklimit të mbeturinës).

Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët e mjedisit jetësor në përputhje me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e financave, i përcakton mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e duhur për lirim dhe kthim të kompensimit.

Mënyra dhe procedura e përcaktimit të përlogaritjes, pagesës, si dhe afatet për përlogaritje dhe pagesë të kompensimeve

Mënyrën dhe procedurën e përcaktimit, përlogaritjes, pagesën si dhe afatet për përlogaritje dhe për pagesë të kompensimeve i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punë nga sfera e mjedisit jetësor (MMJPH) në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e financave. Në procedurën për përcaktim, përlogaritje, pagesë të kompensimit dhe përcaktim të afateve për përlogaritje dhe pagesë, aplikohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, Ligjit për procedurë tatimore dhe Ligjit për tatim personal mbi të ardhurat, nëse me Ligjin për mjedis jetësor nuk është rregulluar ndryshe. Kompetent për kontroll të përcaktimit, përlogaritjes, çlirimit nga pagesa e kompensimit të ardhshëm, si dhe për respektim të afateve për pagesë të kompensimeve është Drejtoria e të Ardhurave Publike.

Përcaktimin dhe përlogaritjen e kompensimit e bën organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, gjatë lëshimit të lejes për import ose eksport, me përjashtim të eksportit të bimëve dhe pjesëve të bimëve, degëve dhe pjesëve tjera të bimëve të rrezikuara ose rreptësisht të mbrojtura, që janë grumbulluar në natyrë dhe të eksportit të butakëve me guaska ose pa guaska dhe për kërmij të grumbulluar në natyrë dhe lloje tjera të faunës të mbrojtura që grumbullohen në natyrë kur përlogaritjen e kompensimit e bën organi doganor gjatë zbatimit të procedurë doganore për eksport dhe në bazë të neto sasisë së eksportit që realizohet dhe lejes për eksport të lëshuar nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

MMJPH është e obliguar të mban evidencë të obliguesve për pagesë të kompensimeve.

Lartësia e kompensimeve për import dhe eksport

1. Lartësia e kompensimit që paguhet për marrje të lejes për import të gomave të mbrojtura ose të përdorura është:

- për automjete udhëtimi 60,00 den/copë dhe
- për autobusë, kamionë dhe mjete tjera 150,00 den/copë.

2. Lartësia e kompensimit që paguhet për marrje të lejes për import të frigoriferëve, ngrirësve dhe aparateve tjera të ftohjes dhe ngrirjes është:

- me vëllim deri 250 litra 200 den/copë,
- me vëllim prej 250 deri 340 litra 300 den/copë,
- me vëllim prej 340 deri 900 litra 400 den/copë dhe
- nga 250 den për kW kapacitet të ftohjes dhe për aparat klimatizimi

3. Lartësia e kompensimit që paguhet për eksport të bimëve dhe pjesëve të bimëve, degëve dhe pjesëve tjera të bimëve të rrezikuara ose rreptësisht të mbrojtura, që grumbullohen në natyrë, është për:

- dëllinjë të zezë 1,30 den/kg,
- liken dushku 1,00 den/kg,
- boronicë të kuqe 3,00 den/kg,
- kantarion 0,80 den/kg,

- kërpudha të freskëta 1,00 den/kg,
 - kërpudha të konservuara 2,00 den/kg,
 - kërpudha të thata 4,00 den/kg dhe bimë tjera 1,00 den/kg.
4. Lartësia e kompensimit që paguhet për marrje të lejes për import të substancave që varfërojnë mbështjellësin e ozonit, ndërsa janë të klasifikuara me anekse të Protokollit të Montrealit, është për:
- substanca të Aneksit A, grupi I dhe II
 - substanca të Aneksit B, grupi I, II dhe III dhe
 - substanca të Aneksit C, grupi II 64,00 den/kg,
 - substanca të Aneksit E, grupi I 100,00 den/kg dhe
 - substanca të Aneksit C, grupi I 62,00 den/kg.
5. Lartësia e kompensimit që paguhet për marrje të lejes për import të mbeturinave dhe skrapit prej plumbi; hiri dhe skrap që kryesisht përmbajnë plumb; mbeturina dhe skrap nga celulat e harxhuara primare dhe akumulatorë të harxhuar elektrik dhe mbeturina dhe skrap që përmbajnë plumb, është për:
- hi dhe skrap 20,00 den/kg,
 - mbeturina dhe skrap 25,00 den/kg dhe
 - mbeturina dhe skrap nga celulat primare, bateri primare dhe akumulatorë të harxhuar elektrik 200,00 den/ton.
6. Lartësia e kompensimit që paguhet për eskporti:
- butakëve me guaskë ose pa guaskë dhe për kërmij të grumbulluar në natyrë 1,00 den/kg dhe
 - lloje të tjera të mbrojtura të grumbulluara në natyrë 1,00 den/kg.
7. Lartësia e kompensimit që paguhet gjatë importimit të:
- 1) mjeteve të përdorura motorike për transport të dhjetë ose më shumë personave, duke përfshirë edhe shoferin dhe me piston motor me djegie të brendshme me ndezje me ndihmë kompresionit ose me ndihmë të kandelave, është 3.000,00 den/copë;
 - 2) automjete të përdorura dhe mjete tjera motorike kryesisht të konstruara për transport të personave, përveç mjetet nga pika 1, me motor me piston (përveç motorit me piston rrotullues) me djegie të brendshme me ndezje me ndihmë kandelave:
 - me vëllim të cilindrit që nuk tejkalon 1.000 cm³, është 1.500,00 den/copë,
 - me vëllim të cilindrit që tejkalon 1.000 cm³, por nuk tejkalon 1.500 cm³, dhe është 2.000,00 den/copë,
 - me vëllim të cilindrit që tejkalon 1.500 cm³, por nuk tejkalon 3.000 cm³, është 2.000,00 den/copë dhe
 - me vëllim të cilindrit që tejkalon 3.000 cm³, është 3.500,00 den/copë;
 - 3) automjete të përdorura udhëtimi dhe mjete tjera motorike kryesisht të konstruara për transport të personave, përveç automjetet nga pika 1, me motor me piston me djegie të brendshme me ndihmë të kompresionit (dizel dhe gjysëmdizel):

- me vëllim të cilindrit që nuk tejkalon 1.500 cm^3 , është 2.500,00 den/copë,
 - me vëllim të cilindrit që tejkalon 1.500 cm^3 , por nuk tejkalon 2.500 cm^3 , është 3.000,00 den/copë dhe
 - me vëllim të cilindrit që tejkalon 2.500 cm^3 , është 3.500,00 den/copë;
- 4) mjete të përdorura motorike për transport të mallrave, me motor me piston me djegie të brendshme me ndezje me ndihmë të kompresionit (dizel dhe gjysëmdizel):
- me bruto masë që nuk tejkalon 5 t, është 5.000,00 den/copë,
 - me bruto masë që tejkalon 5 t, por nuk tejkalon 20 t, është 7.000,00 den/copë dhe
 - me bruto masë që tejkalon 20 t, është 8.000,00 den/copë dhe
- 5) mjete të përdorura motorike për transport të mallrave, me motor me piston me djegie të brendshme me ndezje me ndihmë të kandelave:
- me bruto masë që nuk tejkalon 5 t, është 3.000,00 den/copë dhe
 - me bruto masë që tejkalon 5 t, është 4.500,00 den/copë.

8. Lartësia e kompensimit që paguhet për marrje të lejes për import të magnetofonave dhe aparateve tjera për inçizim të zërit, aparate receptive për televizion, video-monitorë, video-projektor të përdorur, është 200,00 den/copë.

Obligues për të paguar kompensimin sipas zërave të lartpërmendur mund të jetë person juridik i cili kërkon leje për import të prodhimeve, dhe/ose person fizik i cili i importon prodhimet dhe person juridik i cili bën kërkesë për import të prodhimeve.

Lartësia e kompensimeve për mjete motorike dhe objekte lundruese

Lartësinë e kompensimit që paguhet për persona juridikë dhe fizikë vendas të cilët e ndotin mjedisin jetësor me shfrytëzimin e mjeteve motorike për periudhë prej një viti e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili e udhëheqë organin e administratës shtetërore përgjegjëse për sferën e mjedisit jetësor.

Lartësia e kompensimit përcaktohet varësisht nga kategoria e automjetit, vitit të prodhimit të automjetit si dhe lloji i motorit të automjetit. Gjatë përcaktimit të lartësisë merret parasysh ndikimi negativ që automjeti e shkakton mbi mjedisin jetësor sipas llojit të karburantit që përdoret për automjetin dhe vjetërsisë së automjetit. Lartësia e kompensimit që paguhet për persona juridikë dhe fizikë vendorë të cilët e ndotin mjedisin jetësor duke përdorur objekte lundruese, gjatë regjistrimit të objekteve lundruese për periudhë prej 1 vjeti e kap shumën prej 3% të sigurimit themelor.

Lartësia e kompensimit për prerje të drunjve

Lartësia e kompensimit që paguhet për prerje të drunjve përcaktohet me Ligjin për pyjet.

Lartësia e kompensimit për menaxhim me mbeturina

Lartësia e kompensimit që paguhet për krijimin e mbeturinave të parrezikshme industriale e kap lartësinë 0,5% prej çmimit të përcaktuar për kryerje të shërbimit për grumbullim i mbeturinave.

Kompensimin e përlogarit kryerësi i shërbimit për grumbullim të mbeturinave, ndërsa mjetet i arkëton gjatë pagesës së çmimit për shërbimin e kryer të grumbullimit të mbeturinave dhe atë e

paraqet veçmas në faturë. Kryerësi i shërbimit e ka për obligim që një herë në muaj të bëj pagesë të kompensimit për shërbimin e caktuar në gjiro llogarinë përkatëse në kuadër të llogarisë së thesarit.

Lartësia e kompensimit për derivatet e naftës

Lartësia e kompensimit që paguhet gjatë importit të derivateve të naftës ose prodhimit të derivateve të naftës, është për:

- 1) benzinë të motorit, edhe atë: benzinë i motorit që përmban plumb më tepër se 0.013 g/l dhe benzinë për aeroplanë kap shumën prej 0.015 den/l si dhe benzinë pa plumb kap shumën 0.08 den/l;
- 2) vaj gazi, edhe atë që përdoret si: karburant për motorë dizel, është 0.03 den/l ndërsa si vaj ekstra i lehtë për djegie e kap shumën 0.04 den/l dhe
- 3) vaj për djegie M1, M2 (mazut) e kap shumën 0.05 den/kg.

Obligim për të paguar këtë kompensimi ka personi juridik i cili prodhon ose importon derivate të naftës.

Kompensim për prodhimtari të energjisë prej lëndëve djegëse fosilore

Lartësia e kompensimit për prodhimtari të energjisë që prodhohet me djegien e lëndëve djegëse fosilore e kap shumën: 0.007 den për një kilovat-orë (kWh) energji të prodhuar.

Obligim për të paguar këtë kompensim kanë personat juridikë dhe fizikë të cilët drejtojnë instalacione të cilat prodhojnë energji e që prodhohet me djegie të lëndëve djegëse fosilore.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët në sferën e energjetikës, e me pëlqim të ministrit i cili e udhëheq organin e administratës shtetërore kompetent për punë në sferën e mjedisit jetësor më 01.07.2007 i përcaktoi llojin dhe vëllimin e instalacioneve me *Rregulloren për llojin dhe vëllimin e instalacioneve të cilat prodhojnë energji e cila prodhohet me djegie të lëndëve djegëse fosilore (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 84/07)*.

Instalacionet varësisht nga lloji i energjisë të cilën ata e prodhojnë, me djegien e lëndëve djegëse fosilore, përcaktohen si instalacione që menaxhohen nga një prodhues për:

- prodhimtari të energjisë elektrike; ose
- prodhimtari të energjisë së nxehtësisë; ose
- prodhimtari të kombinuar të energjisë elektrike dhe të nxehtësisë.

Instalacionet që prodhojnë energji me djegie të lëndëve djegëse fosilore janë instalacionet me fuqi të instaluar të përgjithshme të barabartë me ose më e madhe se 10MW. Kompensimi është e ardhur në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë dhe paguhet në gjiro llogari përkatëse në suaza të llogarisë së thesarit.

Mjetet e grumbulluara nga ky kompensim përdoren për financim të programeve dhe aktiviteteve për menaxhim me mjedisin jetësor lidhur me ndikimet e sektorit energjetik edhe atë në rajonet e komunave në përpjesëtim me të ardhurat e realizuara nga arkëtimi i këtij kompensimi.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, më 02.08.2008, me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për çështje nga sfera e vetëqeverisjes lokale, e me pëlqimin e ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për çështje nga sfera e mjedisit jetësor miratoi *Urdhëresë (dekret) për metodologjinë e shpërndarje së mjeteve të realizuara si të ardhura nga kompensimi për prodhimtar të energjisë nga lëndë djegëse fosilore ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr 12/09)*.

Sipas metodologjisë së përcaktuar shpërndarja e lartpërmendur e mjeteve bëhet në përputhje me kriteret në vijim:

- Zona e komunës ku personi i obliguar për të paguar kompensimin për prodhimtari të energjisë nga lëndë djegëse fosilore e realizon veprimtarinë e vet
- Numri i banorëve të komunës në zonën e së cilës personi i obliguar për të paguar kompensimin për prodhimtari të energjisë nga lëndë djegëse fosilore e realizon veprimtarinë e vet
- Numri i banorëve të komunave fqinje të komunës në zonën e së cilës personi i obliguar për të paguar kompensimin për prodhimtari të energjisë nga lëndë djegëse fosilore e realizon veprimtarinë e vet
- Zona e komunave fqinje të komunës në zonën e së cilës personi i obliguar për të paguar kompensimin për prodhimtari të energjisë nga lëndë djegëse fosilore e realizon veprimtarinë e vet

Mjetet iu shpërndahen komunave në zonën e së cilave personi i obliguar për të paguar kompensimin për prodhimtari të energjisë nga lëndë djegëse fosilore e realizon veprimtarinë e vet si dhe komunave fqinje të komunës në zonën e së cilës personi i obliguar për të paguar kompensimin për prodhimtari të energjisë nga lëndë djegëse fosilore e realizon veprimtarinë e vet e që gjenden në largësi në një rreze prej 10km ajrore nga vendi ku gjendet instalacioni edhe atë me anë të një pjese fikse dhe një ndryshoreje (varijablës).

Klasteri i paraqet të gjitha komunat të cilat do të përdorin mjetet e të njëjtit person të obliguar për pagesë të kompensimit për prodhimtari të energjisë nga lëndë djegëse fosilore.

Pjesa fikse e mjeteve në lartësi prej 15% iu alokohet komunave ku personi i obliguar për pagesë të kompensimit për prodhimtari të energjisë nga lëndë djegëse fosilore e realizon veprimtarinë e vet, ndërsa pjesa variabël në lartësi prej 85% alokohet proporcionalisht dhe varet nga numri i banorëve të të gjitha komunave përfshirë edhe komunën në zonën e së cilës personi i obliguar për të paguar kompensimin e prodhimtarisë së energjisë nga lëndët djegëse fosilore e realizon veprimtarinë e vet.

5.3 Programi për investim në mjedisin shëndetësor

Baza për financim dhe procedurë për miratim të programit për investim në mjedisin jetësor

Financimi dhe realizimi i aktiviteteve në sferën e mjedisit jetësor bëhet në bazë të programit vjetor për investim në mjedisin jetësor (tani e tutje: programi), të cilin e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Ministrisë për mjedisin jetësor dhe planifikim hapësinor.

Shfrytëzues të mjeteve nga programi janë persona juridikë dhe fizikë, duke i përfshirë edhe organet e qeverisë shtetërore, si dhe organet e komunave, qyteti i Shkupit dhe komunat e qytetit të Shkupit dhe organet e bashkësive lokale në komna të cilat realizojn programe, projekte dhe aktivitete të tjera të ngjashme për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor dhe natyrës.

Programi përgatitet në përputhje me Planin aksionar nacional për mbrojtje të mjedisit jetësor, Planin hapësinor i Republikës së Maqedonisë, strategjitë tjera, programe dhe akte nga sfera e mjedisit jetësor, si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërnacionale të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë.

Programi për vitin e caktuar fiskal parashtrohet në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e shpalljes së Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për atë vit fiskal në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë". Programin e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të organit të administratës shtetërore kompetente për punë në sferën e mjedisit jetësor. Programi shpallet në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

Organi i administratës shtetërore kompetent për punë në sferën e mjedisit jetësor e realizon programin nëpërmjet vendosjes së mjeteve për financim të plotë ose të pjesshëm të programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera.

Për programe, projekte dhe aktivitete tjera të përshtatshme për financim me mjete të programi posaçërisht vlerësohen: blerja e pajisjes që dedikohet për mbrojtje të drejtpërdrejt të mjedisit jetësor dhe mbrojtje e avancim të shëndetit të njerëzve, përgatitje të dokumentacionit investues dhe studime të realizueshmërisë (studime fizibiliteti) dhe realizimi i tyre, përgatitja e planeve operative dhe realizimi i fazave të veçanta të planeve operative nga licenca (leja) për harmonizimi, realizimi të punëve ndërtimore për mbrojtje të drejtpërdrejt të mjedisit jetësor, stimulim të selektimit, riciklimit dhe mënjanimit të mbeturinave, harmonizim të normave dhe standardeve të mjedisit jetësor, përgatitje të studimeve dhe dokumenteve të planifikimit për mbrojtje dhe avancim të llojshmërisë biologjike, edukim dhe trajnim të personelit dhe aktivitete tjera të ngjashme për mbrojtje dhe avancim të ambientit jetësor.

Dedikimi i mjeteve

Sipas **Nenit 174** nga Ligji për mjedisin jetësor, mjetet përdoren për financim të përgatitjes dhe realizimit të programeve, projekteve dhe aktiviteteve tjera, si dhe për ndërmarrje të masave parandaluese dhe masave për stimulim, ruajtje, përdorim të qëndrueshëm, mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor e sidomos ato të cilat e kanë për qëllim:

- mbrojtjen, ruajtjen dhe avancimin e cilësisë së ajrit, tokës, zbutjen e ndryshimeve klimatike, mbrojtjen e mbështjellësit të ozonit dhe mbrojtje nga rrezatimi;
- sanacionin dhe ndërtimin e deponive për mbeturina, stimulim të zvogëlimit të prodhimit të mbeturinave, përpunim dhe selektim të mbeturinave;
- avancim dhe mbrojtje e llojshmërisë biologjike;
- avancim dhe mbrojtje e shëndetit të njerëzve;
- stimulim i prodhimit më të pastër;
- ndërrim i shfrytëzimit të lëndëve djegëse fosilore me gazin natyror, lëndë djegëse biologjike dhe llojet të tjera të lëndëve djegëse të pranueshme për mjedisin jetësor;
- ngritje e vetëdijes publike në sferën e mjedisit jetësor;
- përmirësimi i monitorimit dhe vlerësimi i gjendjes në mjedisin jetësor dhe inkorporim të mënyrës për menaxhim me mjedisin jetësor;
- stimulim i shfrytëzimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore;
- stimulim për përmbushje të standardeve ekologjike gjatë kryerjes së veprimtarive ekonomike dhe veprimtarive tjera;
- stimulim i projekteve arsimore, studimeve hulumtuese dhe zhvillimore, programeve dhe aktivitete tjera të ngjashme për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor dhe natyrës;

- mbështetje të organizatave joqeveritare dhe jofitimprurëse në sferën e mjedisit jetësor;
- mbështetje e përgatitjes së planeve aksionare lokale për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe
- stimulim të zhvillim të qëndrueshëm të hapësirave rurale.

Gjatë shpërndarjes së mjeteve nga programi, organi i administratës shtetërore kompetent për çështje nga sfera e mjedisit jetësor posaçërisht vlerëson nëse programet, projektet dhe aktivitetet që shkaktojnë efekte të dukshme të matshme ekologjike, nëse ato janë të harmonizuara me strategjitë, planet dhe programet e Republikës së Maqedonisë dhe organit të administratës shtetërore kompetent për punë në sferën e mjedisit jetësor nëse të njëjtit janë në përputhje me prioritetet dhe qëllimet për mbrojtje të mjedisit jetësor ose prioritetet për mbrojtje të mediumi të caktuar ose avancim të gjendjes në një sferë të caktuar të mjedisit jetësor dhe nëse të njëjtit janë në përputhje me obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërnacionale të cilat Republika e Maqedonisë i ka ratifikuar.

Shpërndarja e mjeteve nga programi bëhet me anë të konkursit publik të cilin e shpall dhe e realizon organi i administratës shtetërore kompetent për çështje nga sfera e mjedisit jetësor.

Me përjashtim, mjetet nga programi, mund të shpërndahen edhe me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me propozim të organit të administratës shtetërore kompetent për çështje nga sfera e mjedisit jetësor, nëse:

- mjetet dedikohen për ndërtim të objekteve infrastrukturore për mbrojtje të mjedisit jetësor me interes të gjerë publik,
- ndërtimi i objekteve është paraparë me dokumentet e planifikimit në sferën e mjedisit jetësor dhe
- dedikimi i mjeteve është përcaktuar në programin e nenit 172 të Ligjit për mjedisin jetësor.

Bashkëfinancimi

MMJPH-ja si palë afariste mundet me mjetet e programit për mjedisin jetësor, në përputhje me Ligjin për mjedisin jetësor, të merr pjesë edhe në bashkëfinancim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera të ngjashme të cilat i organizon dhe financon komuna, qyteti Shkup dhe komunat në qytetin e Shkupit, bashkësi lokale, persona juridikë dhe fizikë si dhe organizata ndërnacionale, institucione financiare dhe institucione tjera të ngjashme.

Në rastet kur mjetet ndahen si bashkëfinancim, shfrytëzuesit i mjeteve e ka për obligim të shpallë thirrje publike për përzgjedhje të ofertuesit më të volitshëm.

Mjetet prej donatorëve vendorë dhe të huaj plasohen për realizim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve tjera të ngjashme në mënyrë dhe kushte të përcaktuara nga donatori.

Për shpërndarje të mjeteve nga programi, lidhet kontratë ndërmjet MMJPH-së dhe shfrytëzuesit të mjeteve. Shfrytëzuesi i mjeteve e ka për obligim që mjetet e shpërndara t'i shfrytëzojë në mënyrë dhe sipas kushteve dhe dedikimeve të përcaktuara në kontratën dhe në përputhje me Ligjin për mjedisin jetësor. Gjatë kohës dhe pas përfundimit të kontratës shfrytëzuesi e ka për obligim që të parashtrijë raport me revizion për realizimin e mjeteve të përcaktuara me kontratën, si dhe raport të efekteve të arritura ekologjike me realizimin e programit.

5.3.1 Analiza e programit për investim në mjedisin jetësor gjatë 10 viteve të kaluara

Në këtë kapitull është bërë analiza e Programeve për investim në mjedisin jetësor për periudhën 2007-2016. Janë paraqitur bazat për sigurim dhe realizim të programit, të dedikimit dhe shuma e mjeteve për secilin dedikim, si dhe shfrytëzuesit e mundshëm të mjeteve nga programi (shuma e mjeteve nga programi sipas llojeve të shfrytëzuesve të cilët janë grupi shënjestër për nevojat e projektit).

Programi për investime në mjedisin jetësor për vitin 2007

Mjetet e siguruar në përputhje me **Nenin 180** të Ligjit për mjedis jetësor më vitin 2007 kapin shumën prej 90.000.000 denarë. Programi u realizua sipas **Nenit 172** të Ligjit për mjedis jetësor dhe mjetet janë dedikuar me sa vijon:

1. Përpunim i planeve dhe programeve për menaxhim me mbeturina - 6.000.000 den;
2. Përpunim i dokumentacionit të projektit për menaxhim të integruar me mbeturina (selektim, qendra grumbullimi, përpunim të mbeturinave dhe mënjanim të mbeturinave dhe tjera) (vetëm për menaxhim të integruar me mbeturina të forta, aglomerate, qytete ose rajone me mbi 50.000 banorë në përputhje me planin nacional për menaxhim me mbeturina) – 30.000.000 denarë;
3. Mbështetje e përgatitjes dhe/ose implementim të projekteve për grumbullim, selektim dhe përpunim të mbeturinave – 6.000.000 denarë;
4. Realizim i projekteve për spastrim të deponive informale - 7.000.000 denarë;
5. Realizim të projekteve për sanim të deponive për mbeturina komunale - 10.000.000 denarë;
6. Përpunim të planeve aksionare lokale për mbrojtje të mjedisit jetësor (LEAP) në shumë prej - 3.000.000 denarë;
7. Mbrojtje, ruajtje dhe avancim i cilësisë së ujërave 3.000.000 denarë;
8. Mbrojtje e natyrës dhe llojshmërisë biologjike - 4.000.000 denarë;
9. Ngritje e vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor - 3.000.000 denarë;
10. Stimulum i programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës - 3.000.000 denarë;
11. Realizim të trajnimeve të NjVL-ve për zbatimin e ligjeve nga sfera e mjedisit jetësor - 2.000.000 denarë;
12. Përkrahje e projekteve dhe aktiviteteve të organizatave joqeveritare të formuara me qëllim të mbrojtjes së mjedisit jetësor - 3.000.000 denarë;
13. Mjete për edukim dhe trajnim të nëpunësve shtetëror - 3.000.000 denarë;
14. Shpenzime për zbatim të programit - 7.000.000 denarë.

Personat juridikë dhe fizikë mund të shfrytëzojnë mjete nga pika 2 deri në pikën 13 të Programit. Pikat tjera për shfrytëzim të mjeteve janë të dedikuara për NjVL-të dhe Qytetin e Shkupit.

Mediet kanë mund të kërkojnë mjete rreptësisht sipas pikave 9 Ngritja e vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor, 10 Stimulum i programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor me buxhet të përgjithshëm prej 6.000.000 denarë ose mundësi për qasje prej maksimum 6,66% të mjeteve të programit.

Organizatat jofitimprurëse dhe joqeveritare (përfshirë universitete dhe institucione tjera shkencore) mund të përdorin mjete për dedikimet nga pika 3 deri në pikën 13 ose 45.000.000 denarë, përkatësisht mundësi për qasje prej maksimum deri 50% të mjeteve të programit. Organizatat joqeveritare të formuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor sipas pikës 12 kanë mund të shfrytëzojnë 3.000.000 denarë ose 3,33%.

Në Foto 3 në vijim është prezantimi grafik i mjeteve dhe shfrytëzuesve të mjeteve të parapara me programin për investime:




Foto 3 Mjete dhe dedikim sipas llojit të shfrytëzuesve

Program për investime në mjedisin jetësor për vitin 2008

Mjetet për realizim të Programit për investim në mjedisin jetësor për vitin 2008 janë siguruar në përputhje me **nenin 162** të Ligjit për mjedis jetësor dhe kapin shumën prej 152.000.000 denarë, dhe atë në mënyrë në vijim:

1. Përgatitje të planeve dhe programeve për menaxhim me mbeturina - 4.000.000 denarë;
2. Përpunim të dokumentacionit të projektit për menaxhim të integruar me mbeturina (selektim, qendra grumbullimi, përpunim të mbeturinave dhe mënjanim të mbeturinave dhe tjera) për përkrahje të projekteve për grumbullim, selektim dhe përpunim të mbeturinave – 10.000.000 denarë;
3. Realizim të projekteve për spastrim të deponive informale - 10.000.000 denarë;
4. Realizim të projekteve për sanim të deponive për mbeturina komunale - 10.000.000 denarë;
5. Përpunim të Planeve aksionare lokale për mbrojtje të mjedisit jetësor (LEAP) në shumë prej 3.000.000 denarë;
6. Përpunim të dokumentacionit teknik dhe realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje, ruajtje dhe avancim të cilësisë së ujërave – 60.000.000 denarë;
7. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje të natyrës dhe llojshmërisë biologjike – 4.000.000 denarë;
8. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor - 4.000.000 denarë;
9. Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe

- aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës - 4.000.000 denarë;
10. Mbështetje të projekteve dhe aktiviteteve të organizatave joqeveritare të formuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor – 4.000.000 denarë;
11. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për edukim dhe trajnim të nëpunësve shtetëror në nivel qendror dhe lokal - 2.000.000 denarë;
12. Përkrahje në përpunim të Licencave për harmonizim me plan operativ për deponi – 3.000.000 denarë;
13. Përkrahje në realizim të Planeve operative të Licencave për harmonizim me plan operativ për deponi – 2.000.000 denarë;
14. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve të miratuara në përputhje me Programin për investim për vitin 2007 – 30.000.000 denarë.
15. Shpenzime për zbatim të programit – 2.000.000 denarë.

Personat juridikë dhe fizikë mund të shfrytëzojnë mjete nga pikat 2, 6, 7, 8, 9 11 dhe 13 të Programit. Pikat tjera për shfrytëzim të mjeteve të dedikuara për bashkësi lokale, NjVL-të dhe Qytetin e Shkupit, shoqata rajonale të NjVL-ve dhe ndërmarrje publike.

Mediet mund të kërkojnë mjete rreptësisht sipas pikave 8 Realizim të projekteve dhe aktivitete për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor dhe 9 Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës me buxhet të përgjithshëm prej 8.000.000 denarë ose mundësi për qasje prej maksimum 5,26% të mjeteve nga programi.

Organizatave jofitimprurëse dhe joqeveritare (duke përfshirë universitete dhe institucione tjera shkencore) mund të shfrytëzojnë mjete për dedikimet nga pikat 2, 7, 8, 9 dhe 11 ose 24.000.000 denarë – mundësi për qasje prej maksimum 15,78% të mjeteve të programit. Organizatat joqeveritare të formuara për mbrojtje të mjedisit jetësor sipas pikës 10 mund të shfrytëzojnë 4.000.000 denarë ose 2,63%.

Në Foto 4 në vijim është prezantimi grafik i mjeteve dhe shfrytëzuesve të mjeteve të parapara me programin për investime:




Foto 4 Mjete dhe dedikimi sipas llojit të shfrytëzuesve për vitin 2008
Program për investime në mjedisin jetësor për vitin 2009

Mjetet për realizim të Programit për investim në mjedisin jetësor për vitin 2009 janë siguruar në përputhje me Nenin 162 të Ligjit për mjedis jetësor dhe kapin shumën prej 163.000.000 denarë.

1. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për menaxhim me mbeturina:
 - 1.1. Përgatitje të planeve dhe programeve për menaxhim me mbeturina;
 - 1.2. Përpunim të dokumentacionit të projektit për menaxhim të integruar me mbeturina (selektim, qendra grumbullimi, përpunim të mbeturinave dhe mënjanim të mbeturinave dhe tjera) dhe përkrahje të realizimit të projekteve për grumbullim, selektim dhe përpunim të mbeturinave;
 - 1.3. Realizim të projekteve për spastrim të deponive informale;
 - 1.4. Realizim të projekteve për sanim të deponive për mbeturina komunale;
 Shuma në pikën 1 - 53.000.000 denarë.
2. Përpunim të Planeve aksionare lokale për mbrojtje të mjedisit jetësor (LEAP) në shumë prej 2.000.000 denarë.
3. Përpunim të dokumentacionit teknik dhe realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje, ruajtje dhe avancim të cilësisë së ujërave – 46.000.000 denarë.
4. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje të natyrës dhe llojshmërisë biologjike – 10.000.000 denarë.
5. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor - 3.000.000 denarë.
6. Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës - 2.000.000 denarë.
7. Përkrahje të projekteve dhe aktiviteteve të organizatave joqeveritare të formuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor – 2.000.000 denarë.
8. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve të miratuara në përputhje me Programin për investim për vitin 2007 dhe 2008 – 45.000.000 denarë.

Personat juridikë dhe fizikë mund të shfrytëzojnë mjete nga pikat 1 (nënpika 1.2), 4, 5 dhe 6 të Programit. Pikat tjera për shfrytëzim të mjeteve janë të dedikuara për bashkësi lokale, NJVL dhe Qytetin e Shkupit, shoqata rajonale të NJVL dhe ndërmarrje publike.

Mediet mund të kërkojnë mjete rreptësisht sipas pikave 5 Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor dhe 6 Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës me buxhet të përgjithshëm prej 5.000.000 denarë ose mundësi për qasje prej maksimum 3,06% të mjeteve nga programi.

Organizatat jofitimprurëse dhe joqeveritare (duke përfshirë edhe universitete dhe institucione tjera shkencore) mund të shfrytëzojnë mjete për dedikimet nga pikat 1 (nënpika 1.2), 4, 5 dhe 6 më saktësisht 15.000.000 denarë duke përjashtuar pikën 1 (nënpika 1.2) për të cilën nuk ka shumë të caktuar të mjeteve. Pa shumën e mjeteve pika 1 (nënpika 1.2) të njëjtat do kishin mundësi për qasje prej maksimum 9,20% të mjeteve të programit.

Organizatat joqeveritare të formuara për mbrojtje të mjedisit jetësor sipas pikave 1 (nënpika 1.2) 4, 5, 6 dhe 7 mund të shfrytëzojnë 19.000.000 denarë ose 11,65%.

Në Foto 5 në vijim është prezantimi grafik i mjeteve dhe shfrytëzuesve të mjeteve të parapara me programin për investime:




Foto 5 Mjete dhe dedikimi sipas llojit të shfrytëzuesve për vitin 2009

Program për investime në mjedisin jetësor për vitin 2010

Mjetet për realizim të Programit për investim në mjedisin jetësor për vitin 2010 janë siguruar në përputhje me Nenin 162 të Ligjit për mjedis jetësor dhe kapin shumën prej 122.500.000 denarë.

Në program janë përfshirë edhe mjete për bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse nga sfera e mjedisit jetësor.

1. Realizim të projekteve për spastrim të deponive informale - 5.000.000 denarë;
2. Përpunim të Planeve aksionare lokale për mbrojtje të mjedisit jetësor (LEAP) në shumë prej 2.000.000 denarë;
3. Përpunim të dokumentacionit teknik dhe realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje, ruajtje dhe avancim të cilësisë së ujërave – 15.000.000 denarë;
4. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje të natyrës dhe llojshmërisë biologjike – 9.000.000 denarë;
5. Realizim të projekteve dhe aktivitete për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor - 10.000.000 denarë;
6. Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës - 10.000.000 denarë;
7. Mbështetje të projekteve dhe aktiviteteve të organizatave joqeveritare të formuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor – 10.000.000 denarë;
8. Bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse nga sfera e mjedisit jetësor - 15.000.000 denarë;
9. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve të miratuara në përputhje me Programin për investim për vitin 2009 - 26.500.000 denarë;
10. Shpenzime për zbatim të programit – 20.000.000 denarë.

Personat juridikë dhe fizikë mund të shfrytëzojnë mjete nga pikat 4, 5, 6 dhe 7 të Programit. Mediet mund të kërkojnë mjete rreptësisht sipas pikave 5 Realizim të projekteve dhe aktivitete për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor dhe 6 Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për

mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës me buxhet të përgjithshëm prej 20.000.000 denarë ose mundësi për qasje prej maksimum 16,32% të mjeteve nga programi.

Organizatave jofitimprurëse dhe joqeveritare (duke përfshirë universitete dhe institucione tjera shkencore) mund të shfrytëzojnë mjete për dedikimet nga pikat 4, 5 dhe 6 më saktësisht 29.000.000 denarë, që donë të thotë mundësi për qasje prej maksimum 23,67% të mjeteve të programit.

Organizatave joqeveritare të formuara për mbrojtje të mjedisit jetësor sipas pikave 4, 5 6 dhe 7 të Programit mund të shfrytëzojnë 39.000.000 denarë ose 31,83%.

Në Foto 6 në vijim është prezantimi grafik i mjeteve dhe shfrytëzuesve të mjeteve të parapara me programin për investime:




Foto 6 Mjete dhe dedikimi sipas llojit të shfrytëzuesve për vitin 2010

Program për investime në mjedisin jetësor për vitin 2011

Mjetet për realizim të Programit për investim në mjedisin jetësor për vitin 2011 janë siguruar në përputhje me **Nenin 162** të Ligjit për mjedis jetësor dhe kapin shumën prej 122.500.000 denarë. Në program janë përfshirë edhe mjete për bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse nga sfera e mjedisit jetësor.

1. Përpunim të dokumentacionit teknik dhe realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje, ruajtje dhe avancim të cilësisë së ujërave – 23.000.000 denarë.
2. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje të natyrës dhe llojshmërisë biologjike – 8.000.000 denarë.
3. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor - 10.000.000 denarë.
4. Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës - 10.000.000 denarë.
5. Përkrahje të projekteve dhe aktiviteteve të organizatave joqeveritare të formuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor – 10.000.000 denarë.
6. Bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse nga sfera e mjedisit jetësor - 15.000.000 denarë.
7. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve të miratuara në përputhje me Programin për investim për vitin 2010 - 28.500.000 denarë.
8. Shpenzime për zbatim të programit – 18.000.000 denarë.

Personat juridikë dhe fizikë mund të shfrytëzojnë mjete nga pikat 3 dhe 4 të Programit. Mediet mund të kërkojnë mjete rreptësisht sipas pikave 3 Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor dhe 4 Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës me buxhet të përgjithshëm prej 20.000.000 denarë ose mundësi për qasje prej maksimum 16,32% të mjeteve nga programi.

Organizatata jofitimprurëse dhe joqeveritare (duke përfshirë universitete dhe institucione tjera shkencore) mund të shfrytëzojnë mjete për dedikimet nga pikat 2, 3 dhe 4 më saktësisht 28.000.000 denarë, që donë të thotë mundësi për qasje prej maksimum 22,85% të mjeteve nga programi.

Organizatata joqeveritare të formuara për mbrojtje të mjedisit jetësor sipas pikave 2, 3, 4 dhe 5 mund të shfrytëzojnë 38.000.000 denarë ose 31,02%.

Në Foto 7 në vijim është prezantimi grafik i mjeteve dhe shfrytëzuesve të mjeteve të parapara me programin për investime:




Foto 7 Mjete dhe dedikimi sipas llojit të shfrytëzuesve për vitin 2011

Program për investime në mjedisin jetësor për vitin 2012

Mjetet për realizim të Programit për investim në mjedisin jetësor për vitin 2012 janë siguruar në përputhje me **Nenin 162** të Ligjit për mjedis jetësor dhe kapin shumën prej 122.000.000 denarë.

Në program janë përfshirë edhe mjete për bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse nga sfera e mjedisit jetësor.

1. Përpunim të dokumentacionit teknik dhe realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje, ruajtje dhe avancim të cilësisë së ujërave – 30.000.000 denarë;
2. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje të natyrës dhe llojshmërisë biologjike – 5.000.000 denarë;
3. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor - 5.000.000 denarë;
4. Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës - 5.000.000 denarë;
5. Mbështetje të projekteve dhe aktiviteteve të organizatave joqeveritare të formuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor – 4.000.000 denarë;

6. Bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse nga sfera e mjedisit jetësor - 20.000.000 denarë;
7. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve të miratuara në përputhje me Programin për investim për vitin 2010 dhe 2011 – 40.000.000 denarë;
8. Shpenzime për zbatim të programit – 13.000.000 denar.

Personat juridikë dhe fizikë mund të shfrytëzojnë mjete nga pikat 3 dhe 4 të Programit.

Mediet mund të kërkojnë mjete rreptësisht sipas pikave 3 Realizim të projekteve dhe aktivitete për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor dhe 4 Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës me buxhet të përgjithshëm prej 10.000.000 denarë ose mundësi për qasje prej maksimum 8,19% të mjeteve nga programi.

Organizatat jofitimprurëse dhe joqeveritare (duke përfshirë universitete dhe institucione tjera shkencore) mund të shfrytëzojnë mjete për dedikimet nga pikat 2, 3 dhe 4 më saktësisht 15.000.000 denarë, që donë të thotë mundësi për qasje prej maksimum 12,29% të mjeteve nga programi.

Organizatat joqeveritare të formuara për mbrojtje të mjedisit jetësor sipas pikave 2, 3, 4 dhe 5 mund të shfrytëzojnë 19.000.000 denarë ose 15,57%.

Në Foto 8 në vijim është prezantimi grafik i mjeteve dhe shfrytëzuesve të mjeteve të parapara me programin për investime:




Foto 8 Mjete dhe dedikimi sipas llojit të shfrytëzuesve për vitin 2012

Program për investime në mjedisin jetësor për vitin 2013

Mjetet për realizim të Programit për investim në mjedisin jetësor për vitin 2013 janë siguruar në përputhje me **Nenin 162** të Ligjit për mjedis jetësor dhe kapin shumën prej 122.800.000 denarë.

Në program janë përfshirë edhe mjete për bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse nga sfera e mjedisit jetësor.

1. Përpunim të dokumentacionit teknik dhe realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje, ruajtje dhe avancim të cilësisë së ujërave – 31.000.000 denarë;
2. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje të natyrës dhe llojshmërisë biologjike – 6.000.000 denarë;

3. Realizim të projekteve dhe aktivitete për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor - 6.000.000 denarë;
4. Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës - 5.000.000 denarë;
5. Mbështetje të projekteve dhe aktiviteteve të organizatave joqeveritare të formuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor – 7.000.000 denarë;
6. Financim të projektit për përpunim të Raportit për gjendjen me mjedisin jetësor në Republikën e Maqedonisë - 7.000.000 denarë;
7. Bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse nga sfera e mjedisit jetësor - 30.000.000 denarë;
8. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve të miratuara në përputhje me Programin për investim për vitin 2011 - 20.000.000 denarë;
9. Shpenzime për zbatim të programit – 10.800.000 denarë.

Personat juridikë dhe fizikë mund të shfrytëzojnë mjete nga pikat 3 dhe 4 të Programit. Mediet mund të kërkojnë mjete rreptësisht sipas pikave 3 Realizim të projekteve dhe aktivitete për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor dhe 4 Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës me buxhet të përgjithshëm prej 11.000.000 denarë ose mundësi për qasje prej maksimum 8,95% të mjeteve nga programi.

Organizatata jofitimprurëse dhe joqeveritare (duke përfshirë universitete dhe institucione tjera shkencore) mund të shfrytëzojnë mjete për dedikimet nga pikat 2, 3 dhe 4 më saktësisht 17.000.000 denarë, që donë të thotë mundësi për qasje prej maksimum 13,84% të mjeteve nga programi.

Organizatata joqeveritare të formuara për mbrojtje të mjedisit jetësor sipas pikave 2, 3, 4 dhe 5 mund të shfrytëzojnë 24.000.000 denarë ose 19,54%.

Në Foto 9 në vijim është prezantimi grafik i mjeteve dhe shfrytëzuesve të mjeteve të parapara me programin për investime:




Foto 9 Mjete dhe dedikimi sipas llojit të shfrytëzuesve për vitin 2013
Program për investime në mjedisin jetësor për vitin 2014

Mjetet për realizim të Programit për investim në mjedisin jetësor për vitin 2014 janë siguruar në përputhje me **Nenin 162** të Ligjit për mjedis jetësor dhe kapin shumën prej 122.800.000 denarë.

Në program janë përfshirë edhe mjete për Bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse nga sfera e mjedisit jetësor.

1. Përpunim të dokumentacionit teknik dhe realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje, ruajtje dhe avancim të cilësisë së ujërave – 31.000.000 denarë;
2. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje të natyrës dhe llojshmërisë biologjike – 5.000.000 denarë;
3. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor - 8.000.000 denarë;
4. Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës - 8.000.000 denarë;
5. Mbështetje të projekteve dhe aktiviteteve të organizatave joqeveritare të formuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor – 8.000.000 denarë;
6. Bashkëfinancim të Projektit për fuqizim të kapaciteteve institucionale të NjVL-ve nëpërmjet përpunimit të strategjive për mjedis jetësor dhe ndryshime klimatike – 6.000.000 denarë;
7. Bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse nga sfera e mjedisit jetësor - 23.000.000 denarë;
8. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve të miratuara në përputhje me Programin për investim për vitin 2013 - 30.000.000 denarë;
9. Shpenzime për zbatim të programit – 3.800.000 denarë.

Personat juridikë dhe fizikë mund të shfrytëzojnë mjete nga pikat 3 dhe 4 të Programit. Mediet mund të kërkojnë mjete rreptësisht sipas pikave 3 Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor dhe 4 Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës me buxhet të përgjithshëm prej 16.000.000 denarë ose mundësi për qasje prej maksimum 13,02% të mjeteve nga programi.

Organizatave jofitimprurëse dhe joqeveritare (duke përfshirë universitete dhe institucione tjera shkencore) mund të shfrytëzojnë mjete për dedikimet nga pikat 2, 3 dhe 4 më saktësisht 21.000.000 denarë, që donë të thotë mundësi për qasje prej maksimum 17,10% të mjeteve nga programi.

Organizatave joqeveritare të formuara për mbrojtje të mjedisit jetësor sipas pikave 2, 3, 4 dhe 5 mund të shfrytëzojnë 29.000.000 denarë ose 23,61%.

Në Foto 10 në vijim është prezantimi grafik i mjeteve dhe shfrytëzuesve të mjeteve të parapara me programin për investime:




Foto 10 Mjete dhe dedikimi sipas llojit të shfrytëzuesve për vitin 2014

Program për investime në mjedisin jetësor për vitin 2015

Mjetet për realizim të Programit për investim në mjedisin jetësor për vitin 2015 janë siguruar në përputhje me **Nenin 162** të Ligjit për mjedis jetësor dhe kapin shumën prej 122.800.000 denarë. Në program janë përfshirë edhe mjete për bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse nga sfera e mjedisit jetësor.

1. Përpunim të dokumentacionit teknik dhe realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje, ruajtje dhe avancim të cilësisë së ujërave – 49.000.000 denarë;
2. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje të natyrës dhe llojshmërisë biologjike – 2.000.000 denarë;
3. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor - 4.000.000 denarë;
4. Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës - 4.000.000 denarë;
5. Mbështetje të projekteve dhe aktiviteteve të organizatave joqeveritare të formuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor – 4.000.000 denarë;
6. Bashkëfinancim të Projektit për fuqizim të kapaciteteve institucionale të NJVL nëpërmjet përpunimit të strategjive për mjedis jetësor dhe ndryshime klimatike – 3.000.000 denarë;
7. Bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse nga sfera e mjedisit jetësor - 33.000.000 denarë;
8. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve të miratuara në përputhje me Programin për investim për vitin 2014 - 20.000.000 denarë;
9. Shpenzime për zbatim të programit – 3.800.000 denarë.

Personat juridikë dhe fizikë mund të shfrytëzojnë mjete nga pikat 3 dhe 4 të Programit.

Mediet mund të kërkojnë mjete rreptësisht sipas pikave 3 Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për ngritje të vetëdijes publike dhe edukim në sferën e mjedisit jetësor dhe 4 Stimulim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore dhe aktiviteteve të ngjashme për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës me buxhet të përgjithshëm prej 8.000.000 denarë ose mundësi për qasje prej maksimum 6,51% të mjeteve nga programi.

Organizatave jofitimprurëse dhe joqeveritare (duke përfshirë universitete dhe institucione tjera

shkencore) mund të shfrytëzojnë mjete për dedikimet nga pikat 2, 3 dhe 4 më saktësisht 10.000.000 denarë, që donë të thotë mundësi për qasje prej maksimum 8,14% të mjeteve nga programi.

Organizatata joqeveritare të formuara për mbrojtje të mjedisit jetësor sipas pikave 2, 3, 4 dhe 5 mund të shfrytëzojnë 14.000.000 denarë ose 11,40%.

Në Foto 11 në vijim është prezantimi grafik i mjeteve dhe shfrytëzuesve të mjeteve të parapara me programin për investime:




Foto 11 Mjete dhe dedikimi sipas llojit të shfrytëzuesve për vitin 2015
Program për mjedis jetësor për vitin 2016

Program për avancimin e mjedisit jetësor për vitin 2016

Me këtë Program (për avancimin e mjedisit jetësor për vitin 2016) në bazë të **Nenit 50** të Ligjit për realizim të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 209/2015), Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në seancën, mbajtur më 05.01.2016, përcaktoi dedikimin e mjeteve nga Ndarja 121.01 – Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, Nënprogrami C1 – Avancim të mjedisit jetësor dhe atë mjete nga donacionet në shumë të përgjithshme prej 40.971.000,00 denarë.

Mjetet për realizim të Programit për avancim të mjedisit jetësor për vitin 2016 janë të ardhura nga:

mjetet donacion – llogaria 785 në shumë të përgjithshme prej 40.971.000,00 denarë dhe atë të ardhurat në vijim:

- 742 111- Të ardhura nga Kombet e Bashkuara në shumë prej 20.198.000,00 denarë
- 742 114- Të ardhura nga Bashkimi Evropian në shumë prej 20.500.000,00 denarë dhe
- 742115 – Të ardhura nga Shtetet Evropiane në shumë prej 273.000,00 denarë

Mjetet do të realizohen në bazë të furnizimeve publike dhe konkurseve, për angazhim të personave juridikë dhe fizikë (ekspert të sferave të veçanta) që i publikon dhe zbaton Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, në përputhje me Ligjin për furnizime publike. Mjetet nga ky program shpërndahen për dedikimet në vijim:

1. Financim të Zyrës së Projektit Ozon, donacion i Kombeve të Bashkuara, në shumë të përgjithshme prej 381.000,00 denarë;
2. Financim të Projektit për distribuim efikas të energjisë – Komponenti 4, donacion i Sekretariatit shtetëror për çështje ekonomike të Zvicrës, SECI, Qeveria e Zvicrës për pagesë shtesë të faturave prej vitit 2015 në shumë të përgjithshme prej 123.000,00 denarë;
3. Financim të Projektit POPs, donacion i Fondit Global Ekologjik të Kombeve të Bashkuara, në shumë të përgjithshme prej 1.230.000,00 den;
4. Financim të Projektit për stabilizim të POPs në deponi, donacion i Fondit Global Ekologjik i Kombeve të Bashkuara për pagesë shtesë të faturave prej vitit 2014 në lartësi prej 237.000,00 denarë;
5. Financim të Projektit Fuqizim të kapacitetit për pjesëmarrje në institucion kliringu, donacion i Fondit Global Ekologjik i Kombeve të Bashkuara në lartësi prej 18.200.000,00 denarë;
6. Financim të Projektit Monitorim i lumenjve, donacion i Qeverisë së Zvicrës për pagesë të faturave prej vitit 2014 në lartësi prej 150.000,00 denarë;
7. Financim të Projektit Unesco, donacion i Kombeve të Bashkuara, në lartësi prej 125.000,00 denarë;
8. Financim të Projektit për bashkëpunim në mjedisin jetësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm (Nënprojekte;: “Parandalim i integruar dhe kontroll i ndotjes në Maqedoni” dhe “Fuqizim të kapaciteteve për lehtësim të zbatimit të Skemës Evropiane për tregti me emisione në Republikën e Maqedonisë”), donacion nga Mbretëria e Norvegjisë në lartësi prej 20.500,00 denarë;
9. Financim të Projektit rrjeti Emerald, donacion i Kombeve të Bashkuara, në lartësi prej 25.000,00 denarë.

Mjetet nga ky program mund t'i shfrytëzojnë personat juridikë dhe fizikë në bazë të furnizimeve publike dhe konkurseve.

Program për investime në mjedisin jetësor për vitin 2016

Me këtë Program Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përcakton dedikimin e mjeteve buxhetore, në bazë të **Nenit 26** të Ligjit për realizim të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 209/15), Ndarja 121.01 të Ministrisë për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, Nënprogrami 21 - Investime në mjedisin jetësor, për vitin 2016.

Mjetet për realizim të Programit për Investime në mjedisin jetësor për vitin 2016 sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2016 nga llogaria 637-12, në shumë prej 192.000.000,00 denarë. Mjetet do të realizohen në bazë të:

- (1) Furnizimeve publike të cilat i shpall dhe zbaton Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, në përputhje me Ligjin për furnizime publike. Mjetet do të dedikohen për financim të projekteve rrjedhëse si dhe bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse të donatorëve nga sfera e mjedisit jetësor;
- (2) Dotacione të dedikuara për komunat nga mjetet e realizuara në bazë të kompensimit për prodhim të energjisë nga lëndët djegëse fosilore për vitin 2015. Mjetet do të dedikohen për financim të projekteve nga sfera e mjedisit jetësor, projekte që janë parashtruar nga komunat Novaci, Manastir, Mogillë, Kërçovë, Gazi Babë, Aerodrom, Qendër, Kisella Vodë dhe Çair;

(3) Dotacione kapitale për NjVL-ve për ndërtim të stacionit për trajtim dhe pastrim të ujit për Demir Hisarin dhe vendbanimet përreth dhe ndërtim të stacionit për filtrim të ujit për pije për fshatin Dobridoll, komuna Vrapçishtë, që do të realizohen në bazë të furnizimeve publike të cilat do t'i zbatojnë komuna Demir Hisar dhe Komuna Vrapçishtë.

Mjetet nga ky program shpërndahen për dedikimet në vijim:

1. Financim të projektit shumëvjeçar për Ndërtim të kanalizimit për fekale me stacion të pastrimit për vendbanimin Tërpejcë, komuna Ohrit, (me vlerë të përgjithshme të llogaritur të Projektit prej 78.356.514,00 denarë) në shumë prej 10.000.000,00 denarë për vitin 2016;
2. Bashkëfinancim të projektit për Trajtim të ujërave të zeza në Koçani, me donacion nga Sekretariati Shtetëror për çështje ekonomike të Zvicrës, SECO - Qeveria e Zvicrës, dhe mjete buxhetore në shumë prej 30.000.000,00 denarë për vitin 2016;
3. Financim të Projektit për pastrim të shtratit të lumit Vardar prej vendbanimit Tudencë, komuna Jegunovcë, sipas Konkluzionit nr. 42-924/1 të Qeverisë prej 17.02.2015, (me vlerë të llogaritur të përgjithshme të Projektit prej 401.000.000,00 denarë) në shumë prej 100.000.000,00 denarë për vitin 2016;
4. Dotacione të dedikuara për komunave Novaci, Manastir, Mogillë, Kërçovë, Gazi Babë, Aerodrom, Qendër, Kisella Vodë dhe Çair për projekte nga sfera e mjedisit jetësor në shumë prej 29.000.000,00 denarë për vitin 2015;
5. Dotacione kapitale për Komunën Demir Hisar për ndërtim të stacion për filtrim për Demir Hisar dhe vendbanimet përreth në shumë prej 18.000.000 denarë;
6. Dotacione kapitale në Komunën Vrapçishtë për ndërtim të stacionit për filtrimit të ujit për pije për fshatin Dobridoll në shumë prej 5.000.000 denarë.

Mjetet nga ky program mund t'i shfrytëzojnë persona juridikë në bazë të furnizimeve publike, për dedikime nga pika 1, 2 dhe 3 të këtij programi.

Mjetet e këtij programi mund të shfrytëzohen nga komunat Novaci, Manastir, Mogillë, Kërçovë, Gazi Babë, Aerodrom, Qendër, Kisella Vodë dhe Çair në bazë të dotacioneve të dedikuara dhe furnizimeve publike të zbatuara nga ana e komunave, për dedikime nga pika 4 të këtij programi.

Në Foto 12 në vijim është prezantimi grafik i mjeteve dhe shfrytëzuesve të mjeteve të parapara me programin për investime:




Foto 12 Mjete dhe dedikimi sipas llojit të shfrytëzuesve për vitin 2016

Mjetet nga ky program mund të shfrytëzohen nga Komunitetet Demir Hisar dhe Vrapçishtë, në bazë të furnizimeve publike, për dedikime nga pikat 5 dhe 6 të këtij programi.

Duke pasur parasysh se në dy programet është paraparë dedikimi i mjeteve që në mënyrë më rigorozë është përcaktuar dhe do të bëhet në bazë të furnizimeve publike dhe konkurseve nga ana e shfrytëzuesve të mjeteve (të cilat i shpall dhe zbaton Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, në përputhje me Ligjin për furnizime publike si dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale që fitojnë dotacione), nuk është e mundur analizë më e hollësishme për atë çfarë pjesë e mjeteve do të dedikohet për shërbime të llojit të projekteve, hulumtimeve dhe aktiviteteve për mbrojtje të mjedisit jetësor, vetëdijesim publik dhe arsim që do të mund t'i shfrytëzonin Mediet, organizatat jofitimprurëse dhe joqeveritare (duke përfshirë dhe institucionet arsimore), si dhe organizatat joqeveritare të formuara për aktivitete për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Në Foto 13 në vijim është prezantimi grafik i mjeteve dhe shfrytëzuesve të mjeteve të parapara me programin për investime dhe programin për avancimin e mjedisit jetësor.





Foto 13 Mjetet dhe shfrytëzuesit e mjeteve të parapara me programin për investime dhe programin për avancimin e mjedisit jetësor

Në tabelën që vijon janë paraqitur të dhëna për mjetet e përgjithshme të parapara me Programet për investime në mjedisin jetësor për 10 vitet e fundit si dhe shumat në dispozicion të personave juridikë dhe fizikë duke mos përfshirë mjetet e parapara për përgatitje të dokumentacionit teknik, organizatave jofitimprurëse dhe joqeveritare të formuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Tabela 1 Mjetet e parapara me Programet për investime në MJ për 10 vitet e fundit

Viti	Gjithsej mjete	Mjete për persona juridikë dhe fizikë	Organizata jofitimprurëse dhe joqeveritare	Organizata joqeveritare për mjedisin jetësor
2007	90.000.000	6.000.000	45.000.000	3.000.000
2008	152.000.000	8.000.000	24.000.000	4.000.000
2009	163.000.000	5.000.000	15.000.000	19.000.000
2010	122.500.000	20.000.000	29.000.000	39.000.000
2011	122.500.000	20.000.000	28.000.000	38.000.000
2012	122.000.000	10.000.000	15.000.000	19.000.000
2013	122.800.000	11.000.000	17.000.000	24.000.000
2014	122.800.000	16.000.000	21.000.000	29.000.000
2015	122.800.000	8.000.000	10.000.000	14.000.000
2016 Programi Avancimi	40.971.000	40.971.000	40.971.000	40.971.000
2016 Programi Investime	192.000.000	29.000.000	29.000.000	29.000.000
Gjithsej 2016	232.971.000	69.971.000	69.971.000	69.971.000

Në fotot në vijim janë paraqitur rezultatet nga analiza e mjeteve në dispozicion sipas Programit për investime në periudhë prej 10 viteve të kaluara, si dhe mjetet e dedikuara për grupet shënjestër nga analiza e nevojave të Projektit për Zhvillim të gazetarisë hulumtuese ekologjike në Republikën e Maqedonisë të prezantuara në tabelën 1.

**Foto 14** Mjete të programeve për investim në mjedisin jetësor (për vitin 2016, janë përfshirë të dy programet për investime dhe avancim të mjedisit jetësor)




Foto 15 Mjete për Program për investim në mjedisin jetësor dhe dedikimi i mjeteve

Nga analiza e Programeve për investime në mjedisin jetësor mund të vërehet se ka ndërthurje të madhe të dedikimeve të mjeteve sipas tipave të shfrytëzuesve si: personat juridikë dhe fizikë duke përfshirë në këtë grup edhe mediet me grupet e organizatave joqeveritare dhe jofitimprurëse dhe organizatat joqeveritare të formuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Me fjalë tjera, disa pika të programeve janë dedikuar vetëm për një lloj të shfrytëzuesve të mjeteve.

Nëse krahasohen sipas lartësisë së mjeteve Programet për investime në mjedisin jetësor mund të konstatohet se ato në disa vitet e fundit janë në nivel të njëjtë me përjashtim të vitit 2016 kur për herë të parë instalohet Programi për avancimin e mjedisit jetësor që i rregullon donacionet e Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe shteteve Evropiane me mjete konkrete dhe dedikim sipas projekteve.

Gjithashtu nëse krahasohet vetëm Programi për investime në mjedisin jetësor për vitin 2016 me programet e viteve të kaluara do të vërehet rritje e mjeteve. Poashtu mund të konstatohet se për herë të parë aplikohet metodologjia sipas Urdhëresës për metodologji për shpërndarje të mjeteve të realizuara si të ardhura nga kompensimi për prodhim të energjisë nga lëndët djegëse fosilore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/08), edhe pse e njëjta ka hyrë në fuqi ditën pas publikimit në Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë (24.01.2008). Programi përcakton mjete sipas dedikimeve paraprakisht të përcaktuara: financim të projekteve rrjedhëse dhe Bashkëfinancim të projekteve rrjedhëse të donatorëve, dotacione kapitale për ndërtim të infrastrukturës dhe donacione për NjVL-të në bazë të projekteve për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Në dispozicion për organizatat joqeveritare për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe grupe të lëndueshme dhe mediet janë vetëm donacionet për NjVL-të të cilat do të jenë lëndë e furnizimeve

publike nga ana e komunave.

Në këtë mënyrë të alokimit të mjeteve paraqitet pamundësi për marrje të drejtpërdrejtë të mjeteve për aktivitete për mbrojtje të mjedisit jetësor, por edhe mundësi për bashkëpunim më të afërt ndërmjet medieve rajonale dhe lokale, organizatave jofitimprurëse dhe joqeveritare të formuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor nga njëra anë dhe komunave shfrytëzues të mjeteve.

Shpërndarja e mjeteve nga Programi për investim në mjedisin jetësor për vitin 2016, mund të ndikojë drejtpërdrejtë në avancimin e grupeve të lëndueshme të zonave të prekura (klaster të komunave) gjithashtu edhe donacionet kapitale të komunave nga buxheti i Republikës së Maqedonisë sipas prioriteteve të hartuara paraprakisht të përcaktuara me dokumentet e planit.

Avancimi i cilësisë së jetës nëpërmjet investimeve në infrastrukturë (dokumentacion teknik për avancim të cilësisë së ujërave, menaxhim i integruar me mbeturinat etj.) janë karakteristikë edhe për Programet për investim në mjedisin jetësor nga vitet e kaluara në të cilat të njëjtat janë dhënë si dedikime të veçuara.

Megjithatë, analizë plotësuese do të nevojitet për t'u përcaktuar dedikimi i mjeteve (projekte për mbrojtje të mjedisit jetësor) nga kompensimi për prodhim të energjisë nga lëndët djegëse fosilore të dedikuara për klaster të komunave që janë dhënë në programin të cilat do të jenë objektiv i furnizimeve publike të zbatuara nga komunat të cilat pranojnë mjetet. Deri më tani në Programet për investim në mjedisin jetësor nuk ka pasur dedikim të veçantë të mjeteve për projekte dhe aktivitete për mbrojtje dhe avancim të cilësisë së ajrit. Me donacionet sipas këtij zëri në komunat për projekte për mbrojtje të mjedisit jetësor mund të pritët realizim i projekteve që do të kontribuojnë për avancimin e cilësisë së mjedisit jetësor duke përfshirë dhe ajrin si medium të mjedisit jetësor.

Gjatë analizës së Programeve është përcaktuar se disa mjete janë me dedikim për pagesë të mjeteve për financim të projekteve të parapara me programet për investime prej një ose dy viteve paraprake (Programe vjetore për investim në mjedisin jetësor për vitet 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 2014 dhe 2015). Kjo është rezultat i zbatimit të projekteve më afatgjata, megjithatë, e njëjta nënkupton se qasja te mjetet për dedikime tjera të parapara nga programet rrjedhëse është më e ulët (prej 20.000.000 deri 40.000.000 denarë) që paraqet përqindje të konsiderueshme të mjeteve të dedikuara për investim (prej 16 deri 30%).

5.4 Donacione nga donatorë të huaj për projekte për mjedis jetësor

Në bazë të analizës së realizuar të bazës qendrore të të dhënave, për ndihmën e huaj, pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë janë përcaktuar projektet/donacionet e regjistruara në Maqedoni që janë financuar me mjete të pakthyeshme monetare të donatorëve të huaj (grante/donacione), kurse në të cilat janë përfaqësuar çështje nga sfera e mbrojtjes së mjedisit jetësor, edukimi ekologjik, projekte që kanë të bëjnë me grupet e lëndueshme dhe të cilat janë të dedikuara për sektorin joqeveritar për periudhën 2010-2014. Lista e projekteve të regjistruara për mjedis jetësor të financuara me donacione të huaja është dhënë në Shtojcën nr. 2. Mjetet janë shpërndarë në sektorët në vijim:

- Furnizimi me ujë dhe veprimtari komunale;
- Turizmi;
- Arsimi dhe trajnimi për mjedisin jetësor;

- Politika e mjedisit jetësor dhe menaxhmenti administrativ;
- Zhvillimi rural;
- Llojshmëria biologjike;
- Mbrojtja e përgjithshme e mjedisit jetësor;
- Hulumtime për mjedisin jetësor;
- Zhvillimi dhe menaxhimi urbanistik

Në foton në vijim (Foto 16) është dhënë prezantim grafik i shpërndarjes së donacioneve të huaja për projekte për mbrojtje të mjedisit jetësor sipas Sektorëve.




Foto 16 Projekte të realizuara për MMJ-së sipas sektorëve nga donatorë të huaj

Nga paraqitja grafike mund të vërehet se numri më i madh i donacioneve është për realizim të projekteve infrastrukturore, përkatësisht ndërtim, sanim të infrastrukturës së kanalizimit, menaxhim me resurse ujore, menaxhim me mbeturina, si dhe për realizim të projekteve për implementim të politikave për mjedis jetësor.

Lidhur me projekte specifike që kanë të bëjnë me fuqizimin e kapaciteteve të OJQ-vë dhe grupve të lëndueshme numri i projekteve është mjaft modest, përkatësisht janë akorduar mjete për realizim të vetëm dy projekteve.

5.5 Shpenzime për mbrojtje të mjedisit jetësor

Krahas mjeteve të cilat janë të dedikuara për investime në mjedisin jetësor, tregues shumë i rëndësishëm për gjendjen e mjedisit jetësor është edhe shpërndarja e shpenzimeve, përkatësisht dedikimi kryesor i mjeteve të parapara. Nëpërmjet analizës së shpenzimeve mund të përcaktohet aktualiteti i medieve dhe sferave në mjedisin jetësor dhe masat e ndërmarra për tejkalim të problemeve

të identifikuar në mjedisin jetësor.

Shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor përbëhen prej dy komponentëve: investime në pajisje për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe shpenzime për mirëmbajtje të pajisjeve për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Në përputhje me analizën e zbatuar të statistikave të publikuara për mjedisin jetësor prej vitit 2007 deri në vitin 2015 analiza e shpenzimeve është zbatuar vetëm për vitin 2013 – Statistikë e mjedisit jetësor, 2015 Republika e Maqedonisë, Enti Shtetëror për Statistikë. Në vitin 2013, më e larta është pjesëmarrja e shpenzimeve për trajtim me mbeturina (43,0%), pastaj pjesëmarrja e shpenzimeve për sistem qarkullimi për furnizim me ujë (29,8%) dhe shpenzimet për mbrojtje të ajrit (10,4%) – Foto 17.




Foto 17 Shpërndarje e shpenzimeve për mbrojtje të mjedisit jetësor më vitin 2013 (Burim: Enti Shtetëror për Statistikë)

Në Tabelën në vijim (Tabela 2) është dhënë prezantim i pjesëmarrjes së shpenzimeve për mbrojtje të mjedisit jetësor sipas dedikimit:

Tabela 2 Pjesëmarrja e shpenzimeve për mbrojtje të mjedisit jetësor sipas dedikimit

Shpenzime sipas dedikimit	Gjithsej (në 000 Denarë)	Pjesëmarrje e shpenzimeve sipas dedikimit
Gjithsej	7 556 048	100.0
Menaxhim me ujëra të zeza	730 197	9.7
Sistem qarkullimi për furnizim me ujë	2 250 512	29.8
Mbrojtje e ajrit	784 894	10.4
Mbrojtje e tokës, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	247 562	3.3
Mbrojtje të pyjeve	160	0.0
Mbrojtje të biodiversitetit dhe natyrës	77 457	1.0
Trajtimi i mbeturinave	3 248 888	43.0
Mbrojtje nga zhurma	57 110	0.8
Aktivite për hulumtim dhe zhvillim	26 173	0.3
Aktivite arsimore, edukative dhe aktivite tjera të ngjashme	903	0.0
Aktivitet administrativ	2 398	0.0
Pajisje për monitorim dhe kontroll, analizë dhe shpenzime për mirëmbajtje të pajisjes	123 721	1.6
Vlerësim të ndikimit në mjedisin jetësor dhe vlerësimi i konsistencës	6 026	0.1

Burim: Enti Shtetëror për Statistikë

Nga paraqitja tabelore dhe grafike nuk mund të fitohet pasqyrë e plotë për shpërndarjen e shpenzimeve, përkatësisht nëse ndonjë pjesë e mjeteve të planifikuara në Programin për investime në mjedis jetësor është shpenzuar për realizim të projekteve nga ana e sektorit joqeveritar dhe jo-profitabil dhe organizatave civile për mjedis jetësor, si dhe për mbështetje të grupeve të lëndueshme. Megjithatë mund të vërehet se në dedikimet e shqyrtuara, të shpenzimeve për dedikimet Sistem Qarkullimi për furnizim me ujë dhe trajtim të mbeturinave janë mbi 70% të mjeteve që mund të jetë indikator se investimet në infrastrukturë të re dhe mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese komunale janë prioritet. Lloji i tillë i dedikimit të mjeteve do të rrit nivelin e qasjes deri te uji për pije, avancim të kushteve sanitare-higjenike dhe menaxhimin me mbeturinat me çka në afat të gjatë do të ishin përmirësuar kushtet dhe cilësia e jetës së grupeve të lëndueshme.

Nëpërmjet identifikimit të shpenzimeve për mbrojtje të mjedisit jetësor do të mundësohet të përcaktohet përgjigja e shoqërisë ndaj rreziqeve në mjedisin jetësor nëpërmjet sigurimit dhe kërkesës së shërbimeve për mbrojtje të mjedisit jetësor, si dhe nëpërmjet miratimit të shprehive të prodhimit dhe konsumimit të drejtuara në mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Kjo informatë mund të shërbejë për analizë të vëllimit të aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe përcaktim dhe theksim të ndryshimeve në sferat kryesore siç janë shpenzime për parandalim dhe reduktim të ndotjes, kontribut nga aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit jetësor për

ekonominë dhe kalim në teknologjitë për parandalim të ndotjes.

Nevojitet të bëhet shpërndarje më e detajuar e shpenzimeve të investimeve dhe shpenzimeve për mirëmbajtje, me qëllim që të identifikohet përfshirja e OJQ-ve (OC) në realizim të projekteve për avancim të mjedisit jetësor me mjete të pranuar nga Programi për investime në mjedisin jetësor, si dhe dedikim të mjeteve për mediet e shtypura dhe elektronike.

6. QASJE DERI TE INFORMATAT PËR MJEDISIN JETËSOR, MEDIET E SHTYPURA, ELEKTRONIKE DHE MJEDISI JETËSOR

6.1 Qasje deri te informatat për mjedisin jetësor

Informata nga sfera e mjedisit jetësor janë çdo lloj informatash në formë të shkruar, vizuale, elektronike dhe lloj tjetër të formës material.¹³

Qasja e lirë deri te informatat dhe të dhënat për mjedisin jetësor paraqet dëshirë afatgjatë të publikut në pothuaj të gjitha shtetet evropiane, kurse daton që nga konferenca e KB-ve për mjedisin jetësor të njeriut në Stokholm, në vitin 1972, nëse jo edhe prej më herët.

E drejta për qasje te informatat për mjedis jetësor është e drejtë e garantuar kushtetuese¹⁴ dhe është një prej parimeve themelore të Ligjit për mjedis jetësor¹⁵, si dhe kërkesë e Konventës së Aarhusit për qasje deri te informatat për mjedisin jetësor, pjesëmarrje e publikut në miratimin e vendimeve dhe qasje në drejtësinë.

Kushtet, mënyra dhe procedura për realizimin e qasjes së lirë deri te informatat me karakter publik, janë përcaktuar në Ligjin për qasje të lirë te informatat me karakter publik ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 13/06, 86/08, 6/10, 42/14, 148/15). 13/06, 86/08, 6/10, 42/14, 148/15).

Secili ka të drejtë për qasje te informatat për mjedisin jetësor me ç'rast nuk është e domosdoshme të dëshmojë interesin e vet. E drejta për qasje te informatat realizohet në mënyrë të caktuar me Ligjin¹⁶ për mjedis jetësor, dhe kjo e drejtë u takon të gjithë kërkuesve në mënyrë të njëjtë dhe me kushte të njëjta dhe ata janë të barabartë në realizimin e tyre.

E drejta e qasjes te informatat për mjedisin jetësor realizohet lidhur me të gjitha informatat në formë të shkruar, vizuale, audio, elektronike ose në çdo mënyrë të formës së arritshme, e që kanë të bëjnë me:

1. Gjendjen e medieve dhe sferave të mjedisit jetësor, siç janë ajri dhe atmosfera, uji, toka, trualli, llojshmëria biologjike dhe rajonale, duke përfshirë edhe organizmat gjenetiki të modifikuar, si dhe ndërveprimin e ndërsjellë të këtyre elementeve;

2. Faktorët, siç janë materia, energjia, lëndët djegëse nukleare dhe energjia nukleare, zhurmëna, rrezatimi ose mbeturinat, duke përfshirë edhe mbeturinat radioaktive, emisionet dhe format tjera të shkarkimeve në mjedisin jetësor që ndikojnë ose mund të ndikojnë në mediumet dhe sferat e mjedisit jetësor dhe të jetës dhe shëndetit të njeriut;

3. Masat, duke përfshirë edhe ato administrative, siç është politika, legjislacioni, planet, programet, marrëveshjet që kanë të bëjnë me çështjet lidhur me mjedisin jetësor, si dhe aktivitetet që mund drejtpërdrejt ose tërthorazi të ndikojnë mbi mediumet, sferat dhe mbi faktorët e mjedisit jetësor, si dhe masat ose aktivitetet për mbrojtje të atyre elementeve;

4. Raportet, për implementimin e ligjeve dhe dispozitave dhe akteve tjera që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor;

¹³ Neni 5 ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 44/15)

¹⁴ Neni 16 (3) – Garantohet qasje e lirë deri te informatat, pranim dhe transmetim i lirë i informatave

¹⁵ Parimi i pjesëmarrjes së publikut dhe qasja deri te informatat

¹⁶ Neni 51 – Qasje deri te informatat

5. Analizë e shpenzimeve dhe të përfitimeve dhe analiza të tjera ekonomike dhe financiare dhe supozime që përdoren në suaza të masave të ndërmarra dhe aktivitete për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor dhe

6. Gjendjet që kanë të bëjnë me jetën dhe shëndetin dhe me sigurinë e njerëzve, siguria e prodhimeve ushqimore duke përfshirë edhe ndikimin e ndotjes së zinxhirit të ushqimit, kushtet për jetë të njerëzve, vendet me rëndësi për kulturën dhe objektet e ndërtuara, në masë në të cilën ato janë nën ndikim ose mund të jenë nën ndikim të medimeve dhe sferave të mjedisit jetësor ose nëpërmjet ndikimeve të atyre medimeve dhe sferave mbi cilën do situatë të elementeve dhe faktorëve të përmendur.

Obligim për të siguruar informata për mjedisin jetësor kanë të gjitha subjektet që posedojnë informata për mjedisin jetësor, siç janë: Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe organet e administratës shtetërore, organet e komunës, të qytetit të Shkupit, personat juridikë dhe fizikë të cilëve, në përputhje me ligj, u janë besuar autorizime publike, duke përfshirë edhe obligime të veçanta, aktivitete dhe shërbime në sferën e mjedisit jetësor dhe/ose personat juridikë dhe fizikë, të cilët në bazë të ligjit ose marrëveshjes, kryejnë veprimtari ose shërbim të interesit publik në sferën e mjedisit jetësor. Subjektet e kanë për obligim, varësisht nga kompetenca e tyre, informatat për mjedisin jetësor me të cilat menaxhojnë ose të cilat i mbajnë në emër të tyre, të sigurojnë përhapje, qaje nga ana e publikut dhe përditësim të informatave, në forma dhe në formate që me lehtësi do të mund të riprodhohen dhe të jenë në dispozicion nëpërmjet rrjeteve të komunikimit elektronik.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, shpall dhe mban listë të subjekteve që posedojnë ose për të cilët posedohen informata që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor në Vendim për publikim të listës së subjekteve që posedojnë ose për të cilët posedohen informata për mjedisin jetësor ("G. zyrtare e RM-së" nr. 82/07). 82/07). Në Listë përcaktohen edhe informatat të cilat i posedon secili prej subjekteve të përmendur.

Në përputhje me këtë Vendim Sektori për komunikim me publikun (SKP) është përgjegjës për këmbim të informatave me publikun dhe bashkëpunim me mediet e shtypura dhe elektronike, organizatave qeveritare dhe joqeveritare, si dhe për vetëdijësimin dhe edukimin e publikut. SKP-ja është i formuar në janar të vitit 1999 si Zyrë për marrëdhënie me publikun me rekomandim dhe me përkrahje financiare të Bashkimit Evropian. Përbëhet prej dy seksioneve: Seksioni për marrëdhënie me publikun dhe Seksioni për ngritjen e vetëdijes publike dhe edukimit publik. Roli themelor i SKP-së është:

- Sigurim i transparencës dhe informata për aspekte të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit jetësor, në dispozicion të publikut;
- Avancim të arsimit në sferën e mbrojtjes së mjedisit jetësor, për kuptuar më mirë të njëjtën, me inkuadrim në programe të ndryshme shkencore dhe arsimore;
- Rritje të vetëdijes publike dhe kuptim të problemeve të rëndësishme ekologjike dhe opsione për zgjidhje të mundshme, me qëllim të avancimit të kushteve ekologjike;
- Pranim të informatave të dobishme nga qytetarët dhe organizatat që kanë njohuri personale dhe të specializuar për resurset dhe problemet e mjedisit jetësor, kurse të cilat nuk mund të fitohen në tjetër mënyrë;
- Informim për miratim të vendimeve për prioritetet ekologjike dhe zgjidhjet dhe përfshirjen e

publikut gjatë vendimmarrjes;

- Zhvillim të bazave të të dhënave për institucione, organizata, afaristë dhe individë relevantë të domosdoshëm për informim dhe zbatim të proceseve të caktuara në mjedisin jetësor;
- Përgatitje të informatave dhe informim të medieve për aktivitetet nëpërmjet: përgatitje të lajmërimeve, komunikatave, informatave për ngjarje të realizuara dhe fotografi dhe shpërndarja e tyre nëpër medie.
- Organizim të takimeve me OJQ-të

Parimi themelor i punës së Sektorit është komunikim i dyanshëm përkatësisht dhënie dhe marrje të informatave nga publiku, i bazuar në **Konventën e Aarhusit** dhe në **Ligjin për qasje të lirë te informatat me karakter publik**.

Nga ana e sektorit joqeveritar është formuar i ashtuquajtur i Koalicion–Familja e Aarhusit në Republikën e Maqedonisë (rrjet i shoqatave të qytetarëve që punojnë në zbatimin e Konventës së Aarhusit) me qëllim të implementimit të qëllimeve të hartuara në konventën dhe fuqizimin e rolit të sektorit joqeveritar në zbatimin e të njëjtës.

Konventa e Aarhusit si marrëveshje ndërnacionale është një prej instrumenteve më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndoshë jetësor. Publiku ka të drejtë dhe nevojë të jetë i informuar, të merr pjesë në vendimmarrje lidhur me çështjet e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe të ketë qasje të lirë te të njëjtat. Implementimi i Konventës së Aarhusit mundëson avancim të qasjes te informatat, rritje të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen me çka përmirësohet cilësia e vendimeve, kurse gjithë kjo do të rezultojë me avancimin e cilësisë së mjedisit jetësor. Implementimi i Konventës së Aarhusit kontribuon në mbrojtjen e të drejtës së secilit individ të gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme, të jetojë në mjedis jetësor që është i volitshëm për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe të mundësohen të drejtat e qasjes te informatat, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe qasje në drejtësinë në lidhje me çështjet në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor.

MMJPH-ja bashkëpunimin me OJQ-të (OC) që veprojnë në sferën e mjedisit jetësor e realizon në më tepër mënyra edhe atë: nëpërmjet përkrahjes financiare të projekteve të tyre, nëpërmjet ndihmës profesionale, sigurimit të informatave dhe të dhënave për nevojat e tyre. Gjithashtu bëhet inkuadrim i OC-ve edhe në grupe punuese gjatë përgatitjes të dispozitave, programeve, politikave, projekteve dhe aktiviteteve të reja ligjore.

Refuzimi i kërkesës për të dhënë informatë mund të bëhet vetëm në raste të caktuara. Organet e caktuara me këtë ligj e kanë për obligim të grumbullojnë dhe publikojnë informata për mjedisin jetësor nga sferëveprimi i punës së tyre.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton mënyrën dhe procedurën e sigurimit të qasjes te informatat në lidhje me mjedisin jetësor në Rregullore për mënyrën dhe procedurën e sigurimit të qasjes te informatat në lidhje me mjedisin jetësor (“G. zyrtare e RM-së” nr. 93/07). 93/07).

MMJPH-ja ka obligim ligjor për përhapje të informatave për mjedisin jetësor në përputhje me Ligjin për mbeturina, Ligjin për mbrojtjen e natyrës; Ligjin për cilësi të ajrit ambiental si dhe Ligjit për ujërat.

Publiku maqedonas, vetëdija e të cilit për rëndësinë e mjedisit jetësorpo shkon duke u rritur,

kërkon të jetë i informuar për mjedisin jetësor, për çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin dhe për masat që ndërmerren në drejtim të parandalimit, zbutjes dhe eliminimit të problemeve në mjedisin jetësor. Duke e marrë parasysh natyrën publike të atyre informatave, kërkesës së tillë duhet t'i jepet përgjigje jo vetëm me sigurimin e informatave relevante në kohë të saktë, por edhe me promovimin dhe interpretimin aktiv të tyre, ku qëllimi përfundimtar do të ishte të edukohet popullata dhe në atë të ndërtohet vetëdija për gjendjen përreth tyre, si dhe të inkurajohet të merr pjesë në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit jetësor. Për koordinim të të gjitha informatave relevante, duhet të zbatohet sistematizimi dhe standardizimi i atyre informatave, si dhe për të siguruar transparencën e nevojshme dhe arritjen e informatave deri te shfrytëzuesi i fundit, është themeluar Qendra Informative Maqedonase për Mjedis Jetësor në prill të vitit 1988 (QIMMJ).

MMJPH-ja është pikë qendrore për të dhëna ekologjike në Republikën e Maqedonisë. Prandaj, nevojiten metoda të ndryshme për shpërndarjen e informatave. MMJPH-ja ka obligime për njoftime ndaj trupave ndërnacional: EEA, UNECE, EUROSTAT, OBSH. Obligimet për informim, si ato nacionale ashtu edhe ato ndërnacionale i bën QIMMJ-a.

QIMMJ-a përpaket të instalojë një Maqedonase EIONET si instrument të përgjithshëm për këmbim të informatave me të gjitha institucionet, OJQ-të, palët e interesuara etj.

Puna e Qendrës Informative Maqedonase për Mjedis Jetësor realizohet nëpërmjet katër seksioneve:

- Seksioni për monitorim të cilësisë së ajrit ambiental

Seksioni për monitorim të cilësisë së ajrit ambiental menaxhon me Sistemi Automatik Monitorues Shtetëror për cilësi të ajrit ambiental (SAMShCA). SAMShCA përbëhet prej *17 pikave të monitorimit automatik* për cilësi të ajrit ambiental të instaluar në qytetet në vijim: 5 në Shkup, nga dy në Manastir, Veles dhe Komunën Ilinden dhe nga një në Kërçovë, Kumanovë, Koçani, Tetovë, Kavadarci dhe fsh. L Lazaropole. Në suazat e SAMShCA-s funksionojnë edhe 10 semplerë (grumbullues të mostrave) për përcjellje të grimcave të suspenduara me madhësi deri 10 mikrometra dhe laborator kalibrimi.

- Seksioni për kadastra dhe modelim
- Seksioni për analitikë dhe informim dhe
- Seksioni për teknologji informative

Qendra informative Maqedonase për mjedis jetësor në çdo dy vjet i përgatit, azhurnon dhe i plotëson Indikatorët Nacional për mjedis jetësor të miratuar.

QIMMJ-a në nivel dite dërgon informata të përgjithshme për ndotjen e ajrit nga sistemi automatik për monitorim të ndotjes së ajrit në Qendrën e qytetit, për lajmërim dhe alarmim në Shkup. QIMMJ-a, në bazë të të dhënave të përpunuara, përgatit edhe raporte mujore dhe vjetore. Raporte të printuara dërgohen deri te ERMSH dhe DPHM. Raportet zyrtare janë në dispozicion në Sektorin për komunikim me publikun (SKP) për palë të ndryshme të interesuara dhe në ueb faqen e MMJPH-së. Qendra informative Maqedonase për mjedis jetësor në bashkëpunim me Entin Shtetëror për Statistikë përgatit Statistika të mjedisit jetësor. QIMMJ-a, në përputhje me dispozitat e Ligjit për mjedis jetësor, ka për obligim të përpunojë Listë Nationale të indikatorëve. Indikatorët janë në dispozicion të publikut. Shpesh përgatiten raporte me kërkesë të OJQ-ve, nxënësve dhe studentëve, shkencëtarëve etj.

Prezantimi i të dhënave dhe informatave në lidhje me mjedisin jetësor bëhet nëpërmjet ueb faqes së MMJPH-së - www.moepp.gov.mk.

Në ueb faqe gjenden: Raporte (muajore, vjetore) nga të gjitha mediumet që përpunojnë në QIMMJ, Ngjarje/Sferata të cilat i organizon Ministria, Ligje / Akte nënligjore nga sfera e mjedisit jetësor, Lajme - Informata ditore për cilësinë e ajrit, Komunikata etj.

Është bërë analizë në ueb faqen e MMJPH-SË për periudhën prej 2014 deri 2016 (periudha e funksionimit të ueb faqes së re të MMJPH-së) dhe në vazhdim janë dhënë rezultatet për numrin e ngjarjeve të publikuara dhe komunikatave për qasje të publikut për periudhën e njëjtë¹⁷.

Tabela 3 Ngjarje të publikuara në ueb faqen e MMJPH-së

Viti	Numër i ngjarjeve të publikuara në ueb faqen e MMJPH-së	Shqyrtim i shkurtër (përzgjedhje) i ngjarjeve të publikuara
2014	40	<ul style="list-style-type: none"> Lëshim në përdorim të Sistemi për menaxhim me ujëra të zeza në Liqenin e Prespës Intensifikim të bashkëpunimit me Kinën në mbrojtjen e mjedisit jetësor Kuiz Ekologjik në Kavadarci Prezantim i tretë publik i Planit për menaxhim me pellgun e Bregallnicës KONFERENCË: Menaxhim me paketim dhe mbeturina të paketimeve – Si deri në përmbushjen e qëllimeve nacionale? Është përpiluar plani për menaxhim me pellgun e Lumit Strumicë
2015	144	<ul style="list-style-type: none"> Qeveria miratoi konkluzione dhe rekomandime në lidhje me ndotjen e ajrit REKOMANDIME të Ministrisë për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor në rast të tejkalimit të koncentrimit të PM10 grimcave prej 50 µg/m³ në pesë ditë të njëpasnjëshme MASAAFATSHKURTA në rast të tejkalimit të koncentrimit të PM10 grimcave prej 50 µg/m³ në pesë ditë të njëpasnjëshme Fuqizim i bashkëpunimit mes pushtetit lokal dhe atij qendror në ballafaqimin me ndotjen e ajrit Fillon faza implementuese e Projektit për menaxhim ndërkufitar me basenin e Drinit Ministri Izairi në mbledhjen nr. 76 të Komitetit për banim dhe menaxhim me truallin të UNECE
2016	18	<ul style="list-style-type: none"> Hapje e punëtorisë për Zbatim ndërkufitar të rregullativës ligjore për ujëra dhe zona të mbrojtura natyrore Ndërtim i një segmenti tjetër të rrjetit të kanalizimit sekondar në Saraj Mbledhje e Këshillit drejtues të projektit për ndërtim të stacionit për pastrim të ujërave të zeza në Koçani Prezantim të Raport fillestar për karakterizim të Liqenit të Prespës, Ohrit dhe Shkodrës Fillon projekti për fuqizim të kapaciteteve administrative për transponim dhe implementim të Direktivës së re për emisione industriale

¹⁷ **Burimi:** Arkivi në ueb faqen e MMJPH-së deri 11.03.2016

Tabela 4 Komunikata të publikuara në ueb faqen e MMJPH

Viti	Numër i komunikatave të publikuara në ueb faqen e MMJPH-së	Shqyrtim i shkurtër (përzgjedhje) i komunikatave të publikuara
2014	16	<ul style="list-style-type: none"> • Informatë lidhur me qeset për transport të mallrave • Komunikatë për publikun – Vendim për zbatim të vlerësimit strategjik për dokumentin e planifikimit – Strategjia nacionale për llojshmëri biologjike me plan aksionar • Informata për media – Aktivitete të Ministrit për takime, aktivitete dhe aksione, hapje dhe fillimi i punës së objekteve infrastrukturore, adresime në konferenca dhe takime të realizuara
2015	144	<ul style="list-style-type: none"> • Informata për medie - Aktivitete të Ministrit për takime, aktivitete dhe aksione, hapje me punë të objekteve infrastrukturore, adresime në konferenca dhe takime të realizuara, konferenca për gazetar • Informatë për foto konkurs në temë - efektet nga ndryshimet klimatike • Mbajtje të Debatit për shpallje të Malit Sharr për Park Nacional • Takim fillues të projektit “Stabilizim të emisioneve të gazrave të serrave nga komunikacioni rrugor nëpërmjet reduktimit të dyfishtë të konsumit të lëndës djegëse: zbatim rajonal i iniciativës globale për ekonomi të lëndës djegëse” • Vizitë në Konferencën e palëve të Konventës Kornizë e Kombeve të Bashkuara për ndryshime klimatike (SOR 21) • Ndarje e shpërblimeve për arritje më të larta të pjesëmarrësve në konkursin për fotografi “Vepro Tani” dhe gara për media “Luftë kundër ndryshimeve klimatike”
2016	14	<ul style="list-style-type: none"> • Informatë për foto konkurs në temë -efektet nga ndryshimet klimatike • Informatë për mbajtje të Debatit Publik për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor për projektin: Stacion për pastrim të ujërave të zeza në territorin e Komunës Kërçovë • Debat Publik për vlerësim strategjik të mjedisit jetësor nga realizimi i Strategjisë për mjedis jetësor dhe ndryshime klimatike (2014-2020) (draft) • Informim për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për menaxhim me mbeturina • Ftesë për debat publik 13.03.2015 • THIRRJE PUBLIKE për grumbullim të ofertave për ndarje të koncesionit për shfrytëzim të ujit për prodhim të energjisë elektrike prej 37 centraleve të vogla hidroelektrike në pellgjet e lumenjve: Vardar, Treska, Bregallnicë, Strumicë dhe Drini i Zi • Konkurs për shpërndarje të mjeteve për financim dhe realizim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve tjera nga sfera e mjedisit jetësor për vitin 2016 • Vendim për zbatim të vlerësimit strategjik

Në kontekst të demokracisë participuese, pjesëmarrjes së publikut, sektorit joqeveritar, organizatave civile për mjedis jetësor në drejtim të avancimit të mjedisit jetësor nevojiten përpjekje të konsiderueshme të komunikimit.

Në aspektin më të gjerë, qëllimi i komunikimit efektiv për mjedisin jetësor ndërmjet MMJPH-së si institucion udhëheqës shtetëror dhe qeveritar për mjedis jetësor dhe OJQ-ve (OC) për mjedis jetësor është të ndihmojë procesin për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe të përmirësojë gjendjen aktuale të mjedisit jetësor. Nevojat për komunikim lëvizin prej kuptimit të gjendjes së mjedisit jetësor

në shtet deri në transponimin e standardeve për mjedisin jetësor të BE-së. Shpjegim çka donë të thotë legjislacioni i ri, pranim të komenteve nga publiku, zbatim të legjislacionit, vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor, sigurim të mjeteve për investime në mjedisin jetësor, motivim të publikut të ndryshojë sjelljen e vet dhe shumë tjera.

Në përputhje me Strategjinë për komunikim në mjedisin jetësor gjatë vlerësimit të komunikimit në sektorin për mjedis jetësor, ekzistojnë dy lloje themelore të komunikimit: (1) komunikim joformal, që zhvillohet si rezultat i nevojës momentale për informata të caktuara, të domosdoshme për kryerjen e një detyre të caktuar; (2) komunikim strategjik, për çështjet e përgjithshme institucionale, projekte rrjedhëse, çështje strategjike etj.

Problemi më i identifikuar në përputhje me Strategjinë nga ana e pjesëmarrësve kryesorë në këtë komunikim është mungesa e informatave për aktivitetet që ndodhin në sferën e mjedisit jetësor. Udhëheqësit e sektorëve në MMJPH nuk e vlerësojnë se janë të informuar mjaftueshëm për projektet rrjedhëse, derisa palët tjera të interesuara horizontale deklarojnë se janë edhe më pak të njoftuara me aktivitetet e të tjerëve për çështjet nga sfera e mjedisit jetësor. Problem tjetër është mungesa e evidente e koordinimit në MMJPH-së, si dhe në vend në tërësi.

6.2 Mediet, lajme (artikuj) dhe mbrojtja e mjedisit jetësor

Puna e medieve në Republikën e Maqedonisë është rregulluar me Ligjin për Mediet (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/2013 dhe 13/2014) dhe Ligjin për audio shërbime dhe shërbime mediatike audiovizuale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/2013, 13/2014, 44/2014, 101/2014 dhe 132/2014).

Kjo analizë nuk ka për qëllim të komentojë ose të interpretojë zbatimin e të dy ligjeve dhe akteve nënligjore që rezultojnë nga ligjet e përmendura nga ana e medieve të analizuara, por ka për qëllim të përcaktojë numrin e lajmeve (artikujve) të publikuar dhe në një shkallë të caktuar t’i vlerësojë (klasifikojë) sipas temave, përmbajtjes dhe burimit të informatave në lajme (artikuj) lidhur me mjedisin jetësor, të publikuara në mediet elektronike, të shtypura dhe digjitale në Maqedoni.

Parakusht për storje cilësore për mjedisin jetësor është që titulli i përzgjedhur të përfshijë një grup specifikash që shërbejnë si shenja identifikimi:

- **Burime të informatave:** qasje te informatat (burim primar, sekondar), niveli i informimit të gazetarit, shfrytëzim i më shumë burimeve;
- **Autenticitet:** autenticitet i burimit prej nga merren informatat, kredibilitet i burimit;
- **Përmbajtje:** gjithëpërfshirje e temës me të dhëna të sakta, prezantime grafike, fotografi, jo tepër profesionale, që të mund secili t’i kuptojë;
- **Paanshmëri:** gatishmëri të diskutohet haptazi për problemet në mjedisin jetësor, posaçërisht për ato të cilat shkaktojnë probleme për shëndetin e njeriut;
- **Cilësia e titullit** – përafrim deri te lexuesi dhe tërheqje të vëmendjes më të madhe;
- **Aktualiteti i temës** - përcjellje e tendencave bashkëkohore në sferë
- Transmetim i plotë ose i pjesshëm i lajmit (artikullit) nga mediet tjera – rastet e **plagjiatit** nuk janë shqyrtuar nga aspekti i të drejtave autoriale, por si tregues për aktualitetin e temës te popullata dhe mundësia për rritjen e numrit të artikujve nga sfera e mjedisit jetësor të publikuara në medie.

Storjet për mjedis jetësor shpesh kanë edhe natyrë politike dhe ekonomike. Mediet paraqesin kanal të fuqishëm komunikimi nëpërmjet të cilave kompanitë, Qeveria dhe NjVL-të dhe organizatat për mjedis jetësor kanë ndikim mbi publikun, me qëllim të transmetimit të vërtetë të informatave të popullata e përgjithshme duhet që lajmi (titulli) të posedojë specifikat e lartpërmendura.

Derisa lajmet e mëdha rrjedhin nga kompanitë e mëdha, shkencëtarë të njohur, lajmet më atraktive më së shpeshti janë nga bashkësitë dhe individët të cilët kontribuojnë për avancimin ose ballafaqohen me problemin e mjedisit të shëndoshë jetësor.

6.2.1 Lajme (artikuj) të publikuara në medie që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe analizë të temave dhe sferave të mjedisit jetësor në artikujt e publikuar

Me qëllim të përgatitjes së analizës së gjendjes në sferën e gazetarisë hulumtuese ekologjike është bërë analizë e numrit të lajmeve në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor të publikuara në medie digjitale (ueb), të shtypura dhe elektronike.

Analiza përmban numër dhe tematikën e artikujve të publikuara që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor në mediet në Maqedoni në periudhën shkurt të vitit 2015 deri më mars të vitit 2016 (periudhë prej 1 viti). Duke pasur parasysh kufizimin kohor për këtë aktivitet dhe pamundësinë për përcjelljen e publikimeve të artikujve në periudhë më të gjatë kohore, u bë hulumtimi i (ueb) arkivave të medieve digjitale, të shtypura dhe elektronike.

U bë analizë e numrit dhe tematikat e artikujve të publikuar në mediet si vijon (listë e detajuar e medieve të hulumtuara është dhënë në Shtojcën nr. 3 të këtij raporti për analizë të gjendjes):

- 14 Shtëpi televizive nacionale dhe lokale (në gjuhën maqedonase dhe shqip).
- 7 medie të shtypura që publikohen në nivel nacional (në gjuhën maqedonase dhe shqipe), dhe
- 92 medie digjitale (në gjuhën maqedonase dhe shqipe).

Lidhur me tematikën e artikujve të publikuar që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor, të njëjtat janë ndarë në disa grupe me qëllim të përcaktimit kuantitativ të përfaqësimit të temave:

- Aktivitete të OJQ-vë (OC) për mbrojtjen e mjedisit jetësor;
- Aktivitete të NjVL-ve dhe MMJPH-së;
- Konferenca politike në temë mbrojtja e mjedisit jetësor dhe mediumet e mjedisit jetësor;
- Edukim ekologjik;
- Teknika dhe teknologji bashkëkohore për mbrojtjen e mjedisit jetësor;
- Ndryshime klimatike;
- Planifikim urban dhe hapësinor;
- Mbrojtja e ajrit;
- Mbrojtja e ujit (vëllim dhe trajtim të ujërave të zeza);
- Mbrojtja e ujërave (ujë për pije dhe menaxhim me ujëra);
- Menaxhim me mbeturina dhe
- Mbrojtja e resurseve natyrore dhe e biodiversitetit

Në analizë janë gjetur 1813 lajme (artikuj) që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor (artikujt e transmetuar tërësisht ose pjesërisht nga medie tjera nuk janë marrë parasysh).

Numri i lajmeve sipas llojit të medias janë si vijon:

1. Shtëpitë televizive nacionale dhe lokale (numër i medieve të analizuara: 14): 309 lajme,
2. Media të shtypit (numër i medieve të analizuara: 8) 278 lajme,
3. Media digjitale (ueb faqe) 1236 lajme.

Duke pasur parasysh se mbrojtja në mjedisin jetësor është sferë interdisiplinare, shumë prej lajmeve duhet të shpërndahen në më tepër se një grup (sferë tematike), pastaj në pjesën tjetër është dhënë konkluzion për përfaqësimin dhe mbulimin e sferave tematike nga ana e medieve sipas dominimit të tematikës në vet artikullin. Prezantim i përfaqësimit procentual të artikujve në medie sipas temave të lartpërmendura është dhënë në foton që vijon (Foto 18).




Foto 18 Prezantim i përfaqësimit procentual i artikujve në medie sipas temave të shqyrtuara

Më të pranishme janë lajmet (artikujt) për mbrojtje dhe cilësi të ajrit edhe atë në muajt e stinës së dimrit (nëntor 2015 – 219, dhjetor 2015 – 267 lajme, 293 lajme në shkurt të vitit 2016). Lajmet janë pothuaj njoftime ditore për vlerat e parametrave të monitoruar për materie ndotëse në ajër, tejkalimet e tyre, të bazuara në rezultate nga Sistemi Automatik Monitorues Shtetëror për cilësi të ajrit ambiental (SAMSHCA)¹⁸. Janë përcjellë me rekomandimet dhe masat për mbrojtje

¹⁸ <http://airquality.moepp.gov.mk/>

të popullatës në ditë kur tejkalohen vlerat e limiteve, komente për ndikimet e ajrit të ndotur mbi shëndetin e njeriut të bazuara në rekomandimet e organizatës shëndetësore botërore, institucioneve për shëndet publik dhe përfaqësuesve të shëndetësisë primare dhe sekondare si dhe përfaqësuesve të organizatave joqeveritare. Në atë kontekst janë shqyrtuar vlerat ditore të cilësisë së ajrit (materie ndotëse në ajër) në Shkup, Tetovë, Kërçovë dhe Manastir dhe lidhshmëria e industrisë me cilësinë e ajrit në qytete. Në pjesën më të madhe të artikujve informohet për aktivitetet e institucioneve kompetente lidhur me emisionet nga fabrika në Jegunovcë (Jugohrom Feroalloys ShPK) për të cilën ka krahasime të hollësishe për emision me ndikime mbi shëndetin e njeriut në bazë të raporteve vjetore të Institutit për Shëndet publik, njoftime për procedurat e organeve kompetente dhe procesin e marrjes së licencës së integruar ekologjike. Numër i madh artikujsh ka transmetuar deklaratat për masat e ndërmarra kundër ndotjes (emisione të substancave ndotëse në ajër) dhe për procesin e përmbushjes së kërkesave të MMJPH-së për Kontroll të integruar dhe parandalim të ndotjes nga fabrika në qarkun e uzinës së hekuranës së mëhershme të Shkupit – Makstill, por edhe për ndikimet nga puna e objekteve për prodhimtari të energjisë elektrike nga lëndët djegëse fosilore të ShA ELEM në Manastir dhe Kërçovë. Pjesë e artikujve janë stimuluar nga aktivitetet (protesta, konferenca dhe debate) dhe kërkesat e OJQ-vë (OC) kundër ndotjes së ajrit, iniciativa për monitorim të cilësisë së ajrit ambiental dhe kërkesa konkrete për masa për zgjidhjen e problemit me ndotësit e ajrit (burimet stacionare dhe mobile të emisioneve).

Gjatë analizës është konstatuar se numër i madh i artikujve nga ky grup (mbrojtje dhe cilësi të ajrit) janë transmetuar pjesërisht ose plotësisht nga mediet tjera duke mos përfshirë gjatë kësaj burime shtesë të informatave dhe duke aplikuar sensacionalizëm në titujt e vetë artikujve.

Ndryshimet klimatike dhe emisionet e gazrave të serrave nga industria, komunikacioni dhe transporti më së shpeshti nuk janë temë e shqyrtimit dhe krahasim me emisionet dhe koncentrimet e materieve ndotëse në ajër. Për arritjet e disa industrive për plotësim të standardeve që kërkohen për të marrë Licenca të Integruara Ekologjike dhe teknikat më të mira që janë në dispozicion (TMA) informohet në mënyrë afirmative, por mungojnë informata të detajuara për reduktimet dhe kursimet, si dhe mënyrat e arritjes së qëllimeve të përcaktuara.

Ndryshimet klimatike janë të pranishme në artikuj për aktivitete të organizatave joqeveritare për zbatim të projekteve (pjesërisht të përkrahura nga agjencitë donatore) për stimulim të vetëdijesimit publik (kuiza, foto konkurse etj), ose janë pjesë e rezultateve të prezantuara të projekteve për efikasitet energjetik në industri, raporte, plane dhe strategji për ballafaqim me ndryshimet klimatike, luftë kundër shkatërrimit të organeve kompetente në bashkëpunim me agjencitë donator dhe OC të cilat më së shpeshti janë burim i informatave për artikujt.

Tema e dytë më e pranishme nga sfera e mbrojtjes së mjedisit jetësor në artikujt e medieve është menaxhimi me mbeturina. Deponitë informale dhe mosekzistimi i kushteve për pastrim të mbeturinave dhe mungesa e kulturës ekologjike dhe sjellja në mjediset urbane dhe natyrë janë më të pranishme në mediet lokale elektronike dhe digjitale. Problemet me zhvendosjen e mbeturinave komunale dhe llojeve të tjera në disa qytete janë temë e rregullt e informimeve në artikujt në mediet lokale (qytetet Tetovë, Ohër, Strugë dhe etj). Megjithatë, duhet theksuar se menaxhimi me mbeturina në këto mjedise është temë edhe e aktiviteteve, aksioneve dhe pres konferencave të OJQ-vë (OC) dhe organeve kompetente, si dhe e punës dhe menaxhimit të Ndërmarrjeve Publike Komunale me çka vijmë deri te prezantimi më i madh lokal për gjendjen momentale në sferën e menaxhimit me

mbeturinat. Artikujt nga sfera e menaxhimit me mbeturinat në nivel lokal janë gjithashtu shpesh transmetohen (ndërmerren) pjesërisht ose tërësisht nga ana e medieve tjera (në pjesën më të madhe nga mediet digjitale).

Projektet për menaxhim të integruar me mbeturina, për teknika novative për reduktim të sasive të mbeturinave nëpërmjet ripërdorimit dhe riciklimit si dhe aktivitetet e kompanive të autorizuara për menaxhim me mbeturina nga paketimi janë gjithashtu të përfaqësuara dhe janë burim i informatave për artikujt. Rreziqet dhe mjetet financiare për menaxhim me mbeturinat e rrezikshme dhe mbeturinat historike nga kapacitetet e mëparshme industriale janë më pak të pranishme dhe më së shpeshti për këtë problematikë informohet gjatë prezantimit të rezultateve nga projektet e zbatuara të OC-ve, MMJPH-së, NjVL-ve dhe donatorët e huaj që paraqiten si burime.

Tema për mbrojtjen e ujërave (ujë për pije dhe menaxhim me ujëra) bashkë me temën për mbrojtjen e ujërave (grumbullim dhe trajtim i ujërave të zeza) është aktuale në medie me një propocion të përafërt me temën e menaxhimit me mbeturina. Artikujt që kanë të bëjnë me këto dy tema për mbrojtje të ujërave (qasja te uji për pije dhe menaxhim me ujëra dhe grumbullim e trajtim i ujërave të zeza) mund të përshkruhen si promovuese në drejtim të prezantimit të realizimit të projekteve infrastrukturore ose përgatitje të dokumentacionit teknik nga ana e institucioneve kompetente në nivel shtetëror, të NjVL-ve dhe agjencitë donatore. Komentet kritike rreth cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe cilësia e ujit për pije janë në numër të vogël dhe më së shpeshti transmetohen informata për shkarkime të ujërave të zeza mbi nivelin e lejuar dhe efektet nga ato tejkalime të niveleve të lejuara të substancave ndotëse dhe raportime të institucioneve kompetente (IShMJ-a, inspektorët e autorizuar për mjedis jetësor dhe ISHP) dhe OC-ve për mungesën ose nivelin e ulët të cilësisë së ujit për pije në mjediset urbane (Strugë dhe Gjevgjeli).

Artikujt për menaxhim me ujërat pjesërisht kanë të bëjnë me artikujt për mbrojtje të resurseve natyrore dhe biodiversitetit që janë transmetuar nga ana e medieve. Kësaj teme iu kanë përkushtuar numri më i madh i lajmeve që janë mbështetur me burime të informatave: intervista me përfaqësues të organizatave joqeveritare, institucione profesionale dhe arsimore ose detaje nga studime dhe hulumtime të shënuara për rëndësinë e resurseve natyrore dhe raretet dhe llojet e mbrojtura. Artikujt kanë të bëjnë me zonat e mbrojtura në Republikën e Maqedonisë dhe zhvillimin e dokumentacionit të planit dhe projektit për ndërtim të objekteve elektro energjetike, infrastrukturës komunale dhe rrugore, zhvillimin e ofertës turistike dhe urbanizimin (Projekte për ndërtim të pendëve Llukovo Pole dhe Ura e Boshkut, urbanizim dhe infrastrukturë rrugore në Parkun Nacional Galiciçë dhe në bregun e Liqenit të Ohrit).

Shkas dhe/ose burim janë edhe qëndrimet, vendimet dhe deklaratat e institucioneve ndërnacionale financiare për financim të projekteve, dhe institucioneve ndërnacionale dhe shoqatat për mbrojtjen e biodiversitetit dhe në përgjithësi mbrojtjen e mjedisit jetësor. Është vërejtur prani e vogël e artikujve për projekte për promovim dhe mbrojtje rrjedhëse të resurseve natyrore dhe zonat e mbrojtura ndryshe nga Parqet Nacionale të shpallura në Republikën e Maqedonisë.

Planifikimi urbanistik dhe hapësinor i rregullimit të hapësirës është përfshirë me numër të ulët artikujsh edhe në raste kur ka reaksione të qytetarëve ose organizatave civile për mënyrën e miratimit ose për vetë përmbajtjen e dokumentacionit urbanistik ose të planifikimit. Burime të informatave janë vetë përpiluesit dhe miratuesit e dokumentacionit të planifikimit dhe atij urbanistik nëpërmjet mekanizmave për përfshirje dhe konsultime me publikun dhe palët e prekura, shoqatat

civile për mbrojtje të mjedisit jetësor, shoqatat profesionale të arkitektëve dhe urbanistëve.

Medie të caktuara digjitale dhe të shtypura të cilat janë të specializuara në sfera konkrete periodikisht publikojnë artikuj autorial (shkrime) për teknika dhe teknologji bashkëkohore për mbrojtje të mjedisit jetësor (Porta 3, ueb faqja Build.mk dhe tjera) gjatë planifikimit dhe ndërtimit të objekteve, zgjidhje komunikacioni dhe transporti, planifikim hapësinor dhe urban në bazë të përvojave të aplikuara në nivel botëror, prodhimtari e energjisë prej burimeve të rigjenerueshme dhe ripërdorim dhe riciklim të disa llojeve të mbeturinave. Në përgjithësi gjatë analizës është konstatuar se ekzistojnë media, kryesisht ato digjitale por edhe të shtypura, që e trajtojnë temën e mbrojtjes së mjedisit jetësor nga perspektiva e tyre në detaje. Mediet më së shpeshti nuk vazhdojnë me analiza të mëtutjeshme të rezultateve nga aktivitetet të cilat kanë qenë lëndë e artikujve (Perspektiva Juridike: ueb faqe – Pravdiko, Akademik, përfitimet ekonomike dhe politike – Kapitall, BiznisInfo, Ekonomija 24, ndikimet e ndotjes mbi shëndetin e njerëzve - Shëndetësi24, mjetet motorike dhe mjedis jetësor - Dodajgas, etj.).


Artikujt me të cilat bëhet informimi për ngjarje promovuese, aktivitete dhe aksione të MMJPH-së, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me agjencitë donatore dhe organizatat joqeveritare japin informata për ngjarje të organizuara me rastin e ditës së Planetit Tokë, orës së Planetit tokë, ditës ndërnacionale të mjedisit jetësor, të biodiversitetit, ditës së drurit etj., të cilat më së shpeshti paralajmërohen dhe shënohen me videoklipe, sferata për ngritjen e vetëdijes publike dhe edukim ekologjik në formë të ligjëratave, aksione në institucionet arsimore, konkurse, kuize etj.

Aktivitetet dhe veprimtaria e organizatave joqeveritare kanë kontribut të madh në informimin e publikut dhe më së shpeshti paraqiten si burim i informatave në artikujt e të gjitha temave të analizuar për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Organizatat joqeveritare (OC) janë iniciatorët që e animojnë publikun nëpërmjet transmetimit të informatave për gjendjet momentale në mjedisin jetësor, ndotjen e medimeve të mjedisit jetësor dhe ndikimet e mundshme të projekteve të caktuara mbi mjedisin jetësor. Aktivitetet e OC për mbrojtje të mjedisit jetësor që nuk kanë të bëjnë me tejkalime të mundshme ose tejkalime reale serioze të emisioneve të materieve ndotëse ose ndikimet negative në zonat dhe llojet e mbrojtura dhe janë pjesë e aktiviteteve për edukim ekologjik, efektet nga ndryshimet klimatike, ngritja e vetëdijes publike për mbrojtje të mjedisit jetësor, shëndeti i njerëzve dhe rrezikimi i grupeve të lëndueshme nga mungesa e cilësisë së jetës dhe mosmundësia e qasjes në medime të pastra të mjedisit jetësor (ajër, ujë dhe tokë) janë më pak të përfaqësuara në medie.

Informimi për realizimin e aktiviteteve për mbrojtje të mjedisit jetësor (duke përjashtuar financimin e dokumentacionit teknik dhe ndërtimit të objekteve infrastrukturore për mbrojtje të mjedisit jetësor që trajtohen si mundësi për promovim nga ana e investitorëve), kontrolli i zbatimit, kontrolli inspektues dhe shpërndarja e mjeteve të dedikuara për investim në mjedisin jetësor nga ana e organeve kompetente shtetërore dhe lokale janë më pak të përfaqësuara. Gjithashtu më pak janë të përfaqësuar edhe artikujt për reagime politike në gjendjet momentale dhe (mungesë të) aktivitetet për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe planifikimit urbanistik, si dhe informata për propozim-ligje të parashtruara nga sfera e mbrojtjes së mjedisit jetësor. Përfaqësimi i artikujve nga prezantimet publike të Studimeve për vlerësim të ndikimeve të projekteve të caktuara mbi mjedisin jetësor dhe Raporteve për vlerësim strategjik të mjedisit jetësor sipas propozim-planeve, programeve dhe strategjive varet para se gjithash nga lokacioni në të cilin planifikohen aktivitetet, derisa komente (artikuj) për strategjitë nacionale për sfera të caktuara si p.sh. Strategji për zhvillim të energjetikës,

Strategji nacionale për efikasitet energjetik, Strategji nacional për llojshmëri biologjike me plan veprimi nuk janë të përfaqësuara mjaftueshëm.

Shkrimet dhe artikujt edukativ për mbrojtje të mjedisit jetësor, shëndetit të njerëzve dhe ballafaqimi me ndryshimet klimatike janë më pak të pranishme. Nevojitet përfaqësim më i madh i këshillave praktike nëpërmjet sferatave për informim dhe ngritje të vetëdijes publike te popullata. Shkrimet (artikujt) për kursimet dhe përfitimet nga menaxhimi i drejtë me mbeturina, transporti dhe komunikimi, rëndësia e mbrojtjes së biodiversitetit dhe ujërave e në përgjithësi të pasurive dhe resurseve natyrore, si dhe këshilla praktike për të drejtën e qasjes te informatat dhe udhëzime për mënyrë më të lehtë të qasjes te informatat e karakterit publik mund të kontribuojnë për aktualizim plotësues dhe pjesëmarrje në aktivitetet për zgjidhje të problemeve me mbrojtjen e mjedisit jetësor.



7. EDUKIM EKOLOGJIK

7.1 Integrimi i mjedisit jetësor në sistemin arsimor në Maqedoni

Shkaqet për vetëdijen e ulët ekologjike janë të shumta dhe komplekse, një prej shkaqeve është mënyra dhe shkalla e integritit të mjedisit jetësor në sistemin arsimor në Maqedoni.

Sipas sondazhit të realizuar në suazat e projektit “Zhvillim i gazetarisë hulumtuese ekologjike në Republikën e Maqedonisë” në pyetjen – Rezultat i cilës dukuri është niveli i ulët i vetëdijes për mbrojtje të mjedisit jetësor në Republikën e Maqedonisë?, 16.67% të të intervistuarve janë përgjigjur me përfaqësim të pamjaftueshëm të temave ekologjike në arsim.

Në këtë kapitull është dhënë një vështrim i shkurtër për integrimin e mjedisit jetësor në sistemin arsimor, cilët janë faktorët kryesorë për këtë integrim, si dhe identifikimi i përfaqësimit të mbrojtjes së mjedisit jetësor në të gjitha sferat e arsimit.

Ndonëse zhvillimi i arsimit ekologjik (AE) është proces relativisht i gjatë, definicioni i parë paraqitet në vitet e shtatëdhjeta të shekullit të kaluar (1969).

Sipas Sërbinovski (2004) edukimi ekologjik është proces aktiv zhvillimor i mësimin në të cilin individët dhe grupet përfitojnë dituri, kuptim, qëndrime dhe shkathtësi të domosdoshme për veprim të vendosur, të motivuar, përgjegjës dhe para se gjithash të përbashkët në drejtim të arritjes dhe mirëmbajtjes së baraspeshës dinamike në mjedisin jetësor.

Edukimi ekologjik është me rëndësi jetike për ngritjen e vetëdijes publike për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Në shtetet e Bashkimit Evropian, edukimi ekologjik merr hov të madh pas Konferencave të Stokholmit (1972), Beogradit (1975) dhe konferencës në Tbilisi (1977), sipas të cilave edukimi ekologjik është esencial.

Nocioni shpesh implikon edukim në sistemin arsimor, megjithatë nganjëherë i përfshin edhe përpjekjet për të edukuar publikun, si dhe palët tjera të prekura (organizatat civile, sektori joqeveritar dhe ngjashëm) nëpërmjet medieve të shtypura dhe elektronike, sferatave dhe ngjashëm.

Mbi cilësinë e mjedisit jetësor ndikim të madh ka edhe kultura e popullatës, si dhe shkalla e vetëdijes ekologjike. Niveli i vetëdijes ekologjike shumë varet jo vetëm nga arsimimi/edukata shtëpiake dhe kultura e jetës, por edhe nga përfaqësimi i të njëjtës në sistemin arsimor, për këtë arsye shkollat kanë ndikim të madh mbi rritjen e vetëdijes për përkujdesje për mjedisin jetësor.

Duke u nisur nga nevoja për integrim në Bashkimin Evropian, shteti jonë ndërmori një sërë aktivitete, të ndryshme për nga vëllimi dhe përmbajtja.

Njëri aktivitet është përfshirja e të ashtuquajturave eko-standarde në shkollat fillore, që rezultojnë nga qëllimet e Ligjit për arsimin fillor (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15) për avancimin e mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Eko-standarde të cilat duhet të integrohen në arsimin fillor nëpërmjet përmbajtjeve dhe lëndëve të ndryshme arsimore janë:

- Uji;
- Energjia;
- Mirëmbajtja e ndërtesës dhe mjedisi i shëndoshë në shkollë/kopshtin fëmijor;

- Oborri i rregulluar;
- Mbeturina;
- Biodiversiteti;
- Transporti;
- Shëndeti;
- Zhvillimi i qëndrueshëm

Shkalla e integritit në lëndët arsimore nuk është universale, por dallon për çdo shkollë fillore. Në fakt çdo SHF e përgatit programin e vet arsimor ekologjik.

Ministria për arsim dhe shkencë në bazë të konkluzioneve të Qeverisë (dhjetor 2009):

- Ngritje e shkallës së aktiviteteve ekologjike në kopshtet fëminore dhe shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm;
- Përfshirje e temave nga ekologjia dhe mjedisi jetësor në programe arsimore për lëndë përkatëse;
- Zhvillim të prodhimeve të reja mediale për pjesëmarrje të nxënësve në procesin e arsimit ekologjik.

ka përgatitur Program për “Integrim të edukimit ekologjik në sistemin arsimor maqedonas”.

Qëllimi kryesor i Programit është zbatim i suksesshëm i teorisë në praktikën ditore gjatë punës së institucioneve edukativo-arsimore me çka do të ndikohej në ngritjen e vetëdijes ekologjike të gjeneratave të sotme dhe të ardhshme, për zhvillim të qëndrueshëm ekologjik dhe financiar dhe kursime jo vetëm për kopshtet dhe shkollat, por edhe për të gjithë të përfshirët siç janë komunat, Ministria për arsim dhe publiku më i gjerë. Për realizim të suksesshëm të Programit që shpie deri te rezultate konkrete dhe të matshme nevojitet bashkëpunim dhe përfshirje të të gjitha institucioneve, organizatave joqeveritare, medieve dhe individëve që janë të inkuadruar në procesin edukativo-arsimor.

Nevoja për ngritjen e vetëdijes ekologjike është detektuar edhe Planin Strategjik të Ministrisë për arsim dhe shkencë (2015-2017).

Nevojitet stimulim i organizatave civile, OJQ-ve për bashkëpunim më aktiv me MMJPH-në, MTL-në dhe MASH-in gjatë përpunimit të projekteve për ngritje të vetëdijes ekologjike nëpërmjet edukimit për mbrojtje të mjedisit jetësor.

8. AKTIVITETE TË ORGANIZATAVE JOQEVERITARE DHE CIVILE PËR MJEDIS JETËSOR

8.1 Organizata joqeveritare dhe civile për mjedisin jetësor

Në drejtim të valorizimit të kontributit të sektorit civil në zhvillimin e shoqërisë, stimulimin e pluralizmit, tolerancës dhe zhvillimit të demokracisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë më 16 qershor të vitit 2012 e miratoi Strategjinë për bashkëpunim të Qeverisë me Sektorin civil me Planin Aksionar për zbatim në periudhën 2012-2017. Strategjia për bashkëpunim të Qeverisë me sektorin civil 2012-2017 është miratuar në përputhje me Strategjinë nacionale për integrim të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian ku si faktor i rëndësishëm në procesin e reformave në shtet theksohen shkalla e realizimit të bashkëpunimit dhe partneritetit ndërmjet Qeverisë dhe sektorit civil, si dhe përpjekja e Qeverisë për zhvillim të sektorit dhe fuqizim të besimit të ndërsjellë. Strategjia është dokument i rëndësishëm në të cilin janë përfshirë udhëzime për proceset e reformave që duhet të zbatohen në gjashtë vitet e ardhshme dhe qëllimet që duhet të arrihen në drejtim të promovimit, përkrahjes dhe avancimit të marrëdhënieve të partneritetit ndërmjet Qeverisë dhe Sektorit civil (shoqata dhe fondacione) nëpërmjet masave për fuqizim të bashkëpunimit të ndërsjellë. Më vitin 2011 Qeveria e Republikës së Maqedonisë përcaktoi Kodeks të praktikave pozitive për pjesëmarrje të sektorit civil në procesin e krijimit të politikave aplikimin e të cilës e përcjell Sekretariati i Përgjithshëm – njësi organizative për bashkëpunim me organizatat civile (në tekstin e mëtejme: Seksioni për bashkëpunim me OJQ-të). Çdo të dytin vit nga aplikimi i Kodeksit bëhet vlerësim i zbatimit të Kodeksit dhe jepen rekomandime për avancim të bashkëpunimit.

Sferat në vijim janë përcaktuar si qëllime prioritare për periudhën 2012-2017:

1. Sektor i zhvilluar dhe i qëndrueshëm civil
2. Pjesëmarrja në proceset e krijimit të politikave, miratimin e ligjeve dhe integrimin evropian
3. Zhvillimi ekonomik dhe kohezioni social
4. Aktivizmi civil dhe përkrahja nga komuniteti
5. Kornizë e fuqizuar institucionale dhe praktika për bashkëpunim.

Organizatave joqeveritare që punojnë në sferën e mjedisit jetësor janë shumë aktive në Maqedoni dhe ato mbulojnë segmentin më të madh individual të sektorit joqeveritar. Ekzistojnë rreth 70 deri 100 OJQ të regjistruara, por numri i atyre që janë aktive me siguri është më i ulët. Shumë prej këtyre OJQ-ve zbatojnë projekte të numërta nga sfera e mjedisit jetësor, zakonisht në nivel lokal dhe marrin mjete edhe nga burimet e vendit por edhe prej donatorëve të huaj. Disa prej OJQ-ve punojnë dhjetëra vite në sferën e mjedisit jetësor, si rezultat i kësaj kanë vendosur strukturë të mirë organizative, janë mirë të organizuar dhe aktiv. Në anën tjetër, ka shumë OJQ më të vogla, më pak të zhvilluara të cilat nuk kanë nivelin e duhur të organizimit.

